

LIGJI NDËRKOMBËTAR DHE NDIKIMI I TIJ NË ÇËSHTJE TË SIGURISË.

Raste Studimore: Shqipëria (1997), Kosova (1999), dhe Ukraina (2022)

Dok. Stela KARAJ

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në *“Shkenca Sociale dhe të Sjelljes”* Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Kristaq XHARO

Numri i fjalëve: 59.824

Tiranë, Qershor 2025

DEKLARATA E AUTORËSISË

Dëshmoj se përmbajtja e këtij punimi është vetëm krijimi im dhe nuk është dorëzuar më parë për vlerësim nga asnjë institucion tjetër akademik. Për më tepër, ajo nuk është botuar në tërësi, diku tjetër. Të gjitha kontributet e bëra nga individë të tjerë njihen siç duhet përmes citimit dhe referencës së duhur.

Me respekt

Stela Karaj

ABSTRAKT

Ky studim synon të shqyrtojë rolin dhe ndikimin e ligjit ndërkombëtar në mjedisin e sigurisë, duke u fokusuar në menaxhimin e krizave në vende të vogla përmes rasteve studimore të *Shqipërisë (1997)*, *Kosovës (1999)* dhe *Ukrainës (2022)*. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë dhe të analizojë rolin dhe rëndësinë e ligjit ndërkombëtar në menaxhimin dhe zbatimin e krizave në këto kontekste specifike.

Objekti i kërkimit përfshin një analizë të ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe zbatimin e ligjit ndërkombëtar në situata krize, duke vlerësuar efektivitetin e këtyre mekanizmave në trajtimin e emergjencave dhe pasojave të tyre. Studimi eksploron kontekstin historik të krizës së Shqipërisë në 1997 dhe ndërhyrjes në Kosovë në 1999, duke ofruar një perspektivë krahasuese me zhvillimet e fundit në Ukrainë.

Metodologjia e përdorur mbështetet në një kombinim të analizës së literaturës dhe studimeve të rasteve, duke u përqendruar në rolin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe konventave ndërkombëtare relevante në menaxhimin e krizave në vende të vogla. Nëpërmjet analizës së Operacionit “Alba” në Shqipëri, ndërhyrjeve ndërkombëtare në Kosovë dhe reagimit global ndaj krizës në Ukrainë, studimi shqyrton sfidat dhe sukseset në zbatimin e ligjit ndërkombëtar në situata komplekse të sigurisë.

Rezultatet kryesore të kërkimit tregojnë se ligji ndërkombëtar dhe roli i organizatave ndërkombëtare kanë një ndikim të rëndësishëm në efikasitetin dhe suksesin e operacioneve për menaxhimin e krizave në vendet e vogla. Analizat e rasteve specifike si Operacioni “Alba” në Shqipëri dhe ndërhyrjet e Këshillit të Sigurimit në Kosovë dhe Ukrainë ofrojnë një vështrim të thelluar mbi praktikatat dhe sfidat në zbatimin e ligjit ndërkombëtar në krizat aktuale.

Përfundimet kryesore të kërimit konkludojnë se pavarësisht sfidave të identifikuara, ligji ndërkombëtar mbetet një mjet kritik për të mbrojtur dhe promovuar stabilitetin dhe paqen në rajone të caktuara të botës.

Rekomandimet e studimit përfshijnë nevojën për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përforcimin e kapaciteteve vendase në menaxhimin e krizave, duke përdorur më mirë strukturat dhe instrumentet ekzistuese të ligjit ndërkombëtar.

Ky studim ofron një analizë të thelluar mbi rolin e ligjit ndërkombëtar në mjedisin e sigurisë, duke evidentuar praktikat ekzistuese, sfidat kryesore dhe mundësitë për përmirësimin e menaxhimit të krizave në nivel global.

Fjalet kyce: *ligji ndërkombëtar, menaxhimi i krizave, këshilli i sigurimit, ndërhyrjet ndërkombëtare, shtetet e vogla, stabiliteti dhe paqja.*

ABSTRACT

This doctoral research examines the role and normative significance of international law in the management and resolution of security crises, with a particular emphasis on its applicability in the context of small and vulnerable states. The study investigates the legal frameworks governing international interventions and the operationalization of international legal instruments in emergency situations. Through a critical analysis of three emblematic case studies—Albania (1997), Kosovo (1999), and the ongoing conflict in Ukraine—this research evaluates the effectiveness, limitations, and implications of international legal responses to complex crises.

Employing a qualitative methodology grounded in doctrinal legal analysis and comparative case study approaches, the research scrutinizes the implementation and compliance with international law, particularly focusing on the role of the United Nations Security Council and other relevant international legal mechanisms. The findings underscore the substantive influence of international law and international organizations in shaping crisis management outcomes, while simultaneously revealing structural and political constraints that undermine uniform application and effectiveness.

The study concludes that, notwithstanding persistent challenges such as politicization, enforcement deficits, and unequal power dynamics, international law remains an indispensable instrument for the maintenance of international peace and security. The research advocates for strengthened multilateral cooperation and the enhancement of national institutional capacities to ensure more consistent and effective deployment of international legal frameworks in crisis contexts.

Keywords: *international law, crisis management, Security Council, international interventions, small states, stability, and peace.*

DEDIKIM

Ky punim doktrate është një shprehje e thellë mirënjohjeje dhe dedikim për familjen time, e cila ka qenë burimi im i pandërprerë i forcës, mbështetjes dhe inkurajimit në çdo hap të këtij udhëtimi akademik. Një falënderim i veçantë i dedikohet profesorit udhëheqës, Prof. Dr. Kristaq Xharo.

LISTA E SHKURTIMEVE

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

UNSC - United Nations Security Council

KS - Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara

KKB -Karta e Kombeve të Bashkuara

R2P - Doktrina e Përgjegjësisë për të Mbrojtur (*Responsibility to Protect*)

NATO - North Atlantic Treaty Organization

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

LNH- Ligji Ndërkombëtar Humanitar

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

BA - Bashkimi Afrikan

BE - Bashkimi Evropian

Operacioni "Alba" - Operacioni i Shpëtimit i Forcave të NATO-s në Shqipëri

UNMIK- Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administratën e Kosovës

UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës

ICJ- Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

ICTY- Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi

ICC- Gjykata Ndërkombëtare Penale

ICISS- Komisioni Ndërkombëtar për Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror

OJQ- Organizatat Joqeveritare

KDNJ-Këshilli i të Drejtave të Njeriut i OKB-së

TWAIL- Third World Approaches to International Law

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË	I
ABSTRAKT	II
ABSTRACT	III
DEDIKIM	IV
LISTA E SHKURTIMEVE	V

KAPITULLI I: Hyrje

1.1. Hyrje.....	15
1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	18
1.3. Metodologjia e kërkimit.....	22
1.4. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....	24
1.5. Kufizimet e studimit.....	27
1.6. Struktura e disertacionit.....	30
1.7. Rëndësia akademike dhe kontributi shkencor i studimit.....	34

KAPITULLI II: Kuadri teorik dhe rishikimi i literaturës

Pjesa I: Ligji ndërkombëtar dhe ndërhyrjet ndërkombëtare

2.1. Hyrje.....	36
2.2. Evolucioni historik i ndërhyrjeve ndërkombëtare.....	39

2.3. Roli dhe aplikimi i ligjit ndërkombëtar në ndërhyrjet me karakter humanitar.....	43
2.4. Kritika ndaj efektivitetit dhe legjitimitetit të ligjit ndërkombëtar.....	46

Pjesa II: Teoritë mbi sovranitetin, ndërhyrjen dhe legjitimitetin ndërkombëtar

2.5. Sovraniteti: Evolucionit konceptual dhe sfidat bashkëkohore.....	50
2.6. Legaliteti vs. legjitimiteti në përdorimin e forcës.....	53
2.7. Doktrina R2P: Analizë kritike.....	57
2.8. Qasje teorike: Realizmi, Liberalizmi, Konstruktivizmi.....	63
2.9. Konkluzione	65

KAPITULLI III: Rast analize Shqipëria – Operacioni “Alba”

3.1. Hyrje.....	69
3.2. Konteksti i krizës, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm.....	74
3.3. Korniza ligjore ndërkombëtare.....	78
3.4. Dinamika, rezultatet dhe ndikimi.....	82
3.5. Ligji ndërkombëtar në kriza të brendshme.....	84
3.6. Roli i ligjit ndërkombëtar në legjitimimin e ndërhyrjes.....	86
3.7. Sovraniteti dhe Ligji Ndërkombëtar.....	91
3.8. Analizë kritike.....	96
3.9. Mësime të nxjerra.....	98
3.10. Konkluzione.....	101

KAPITULLI IV: Rast analize Kosovë 1999 – Ndërhyrja e NATO-s

4.1. Hyrje.....	105
4.2. Ndërhyrja dhe legjitimiteti.....	108
4.3. Konteksti i krizës.....	114
4.4. Roli i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.....	120
4.5. Të drejtat humanitare.....	124
4.6. Rezoluta 1244 dhe administrimi ndërkombëtar.....	128
4.7. Stabiliteti rajonal.....	130
4.8. OJQ-të dhe shoqëria civile pas konfliktit.....	133
4.9 Mësime të nxjerra.....	137
4.10. Konkluzione.....	139

KAPITULLI V: Rast analize Ukrainë – Lufta e vitit 2022

5.1. Hyrje.....	142
5.2. Ligji ndërkombëtar dhe lufta.....	149
5.3. Sovraniteti dhe ligji	154
5.4. Qëndrimet ndërkombëtare.....	159
5.5. Sfida dhe përmirësimi i ligjit.....	165
5.6. Ndikimet në sistemin ndërkombëtar.....	168
5.7. Mësime dhe rekomandime.....	172
5.8. Konkluzione.....	174

KAPITULLI VI: Analizë krahasuese

6.1. Hyrje.....	176
6.2. Konteksti gjeopolitik.....	180
6.3. Roli i Këshillit të Sigurimit.....	182
6.4. Aspektet e përbashkëta dhe dallimet.....	185
6.5. Efektiviteti i ndërhyrjeve.....	188
6.6. Sfidat e zbatimit.....	192
6.7. Roli i fuqive të mëdha dhe rajonale.....	198
6.8. Qasja e aktorëve multilateralë.....	201
6.9. Konkluzione.....	203

KAPITULLI VII: Konkluzione dhe rekomandime

7.1. Konkluzione.....	215
7.2. Rekomandime.....	220
7.3. Bibliografia.....	240

KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIMI TEORIK

1.1. Hyrje

Në një botë që përballet gjithnjë me sfida komplekse, përballimi i krizave rajonale është një nga aspektet më të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare. Duke marrë në konsideratë se krizat e shkaktuara nga faktorë politikë, ekonomikë, shoqërorë dhe të sigurisë kanë pasoja të mëdha në stabilitetin rajonal dhe global, ligji ndërkombëtar dhe Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara luajnë një rol të veçantë dhe thelbësor. Tema *“Ligji Ndërkombëtar dhe ndikimi i tij në çështje të sigurisë. Raste Studimore: Shqipëri, Kosovë, Ukrainës”* ofron një mundësi për të hulumtuar në thellësi mekanizmat, sukseset dhe sfidat e këtij sistemi global në menaxhimin e krizave në kontekste të ndryshme rajonale.

Zgjedhja e kësaj teme mendoj se është e rëndësishme për arsye që reflektojnë dinamikën ndërkombëtare të menaxhimit të krizave dhe rolin e veçantë të ligjit ndërkombëtar e në këtë kontekst edhe Këshillit të Sigurimit. Tema përfshin një analizë të ndërhyrjes ndërkombëtare në tre raste shumë të rëndësishme: *Shqipëria në vitin 1997, Kosova në vitin 1999 dhe Ukraina në vitin 2022*. Këto kriza përfaqësojnë skenarë të ndryshëm në të cilët u përfshinë aktorë të ndryshëm dhe qëllime të ndryshme, duke paraqitur mundësinë për të shqyrtuar ndikimin e ligjit ndërkombëtar dhe ndërhyrjes ndërkombëtare nga perspektiva juridike, politike dhe sociale.

Kriza në Shqipëri më 1997-ën pas shpërthimit të skemave piramidale solli jo vetëm destabilitet ekonomik dhe politik, por edhe një kërcënim për sigurinë rajonale. Ndërhyrja ndërkombëtare, përmes Operacionit “Alba” dhe mbështetjes nga organizatat

ndërkombëtare, ofroi një shembull të ndërhyrjes humanitare në një vend të vogël të Ballkanit, ku qëllimi ishte rivendosja e rendit publik dhe stabiliteti. Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1101, e cila krijoi bazën për këtë ndërhyrje, duke demonstruar se si një vendim i OKB-së mund të shërbejë si një mjet për të përmbushur mandatin e ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, rasti i Kosovës në vitin 1999 paraqet një sfidë të veçantë për ligjin ndërkombëtar dhe ndërhyrjen ndërkombëtare përmes NATO-s. Ndërhyrja ushtarake pa një rezolutë të qartë të Këshillit të Sigurimit shkaktoi debat të madh në lidhje me ligjshmërinë dhe legjitimitetin e aksionit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për të ndaluar represionin e popullsisë shqiptare nga regjimi serb. Ky rast paraqet një kontrast të fuqishëm me ndërhyrjen në Shqipëri dhe ngre pyetje të rëndësishme në lidhje me ndikimin e politikës në vendimet e Këshillit të Sigurimit dhe ndërhyrjet pa miratimin e tij formal.

Kriza në Ukrainë në vitin 2022 shënojnë një kthesë të re dhe shumë të rëndësishme për ligjin ndërkombëtar dhe sigurinë ndërkombëtare. Pushtimi rus i Ukrainës përbën një sfidë direkte ndaj rendit ndërkombëtar dhe shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst, roli i Këshillit të Sigurimit u shfaq i kufizuar, kryesisht për shkak të përdorimit të vetos nga një anëtar i përhershëm, Rusia. Ky rast thekson kufizimet strukturore dhe politike të Këshillit të Sigurimit në menaxhimin e krizave ku janë përfshirë fuqitë e mëdha. Një analizë e këtij rasti do të ndihmojë për të kuptuar më mirë kontradiktat e sistemit ndërkombëtar dhe dobësitë e tij në përballjen me konfliktet e mëdha gjeopolitike.

Tema e doktoraturës ofron një pasqyrë krahasuese të tri rasteve të ndryshme, të cilat ndihmojnë për të shqyrtuar dhe vlerësuar rolin e ligjit ndërkombëtar dhe Këshillit të Sigurimit në mbrojtjen e paqes dhe sigurisë. Ajo lejon që të thellohem në aspekte të tilla si legjitimiteti, efikasiteti, ndërhyrja humanitare, përdorimi i vetos, dhe ndërhyrjet shumëpalëshe dhe unilaterale. Një tjetër arsye përse kjo temë është e rëndësishme lidhet me kompleksitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare në epokën moderne dhe sfidën për të balancuar parimet e ligjit ndërkombëtar me realitetet politike.

Përmes këtij studimi, synohet të kontribuohet në literaturën ekzistuese duke ofruar një analizë të plotë dhe të hollësishme të rasteve të përzgjedhura, si dhe për të nxjerrë mësim dhe rekomandime për përmirësimin e mekanizmave ndërkombëtarë të menaxhimit të krizave. Tematika përfshin një qasje multidisiplinare që bashkon elementët juridikë, politikë dhe praktikë, duke synuar të ndihmojë në përmirësimin e sistemeve ekzistuese për zgjidhjen e konflikteve dhe ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare.

Një aspekt tjetër thelbësor që justifikon rëndësinë e kësaj teme është se ajo mundëson eksplorimin e tensionit midis interesave kombëtare dhe ndërkombëtare në procesin e menaxhimit të krizave. Rasti i Kosovës, për shembull, nxjerr në pah sesi ndërhyrjet ushtarake mund të jenë të motivuara nga nevoja për të mbrojtur të drejtat e njeriut, por gjithashtu reflekton tensionet politike dhe strategjike midis fuqive të mëdha. Ligji ndërkombëtar, në këtë kontekst, përballet me sfidën e ruajtjes së parimeve të tij të bazuara në sovranitet dhe mosndërhyrje, ndërsa Këshilli i Sigurimit përpiqet të ruajë paqen dhe stabilitetin përmes ndërhyrjeve, të cilat jo gjithmonë mund të jenë të njëzëshme ose të mbështetura nga të gjithë anëtarët e tij.

Në të njëjtën mënyrë, kriza e Ukrainës shtrën pyetjen për forcën dhe kufizimet e së drejtës ndërkombëtare në raport me veprimet e një fuqie të madhe. Duke pasur parasysh se përdorimi i vetos nga anëtarët e përhershëm shpesh paralizon Këshillin e Sigurimit në situata kritike, siç është rasti me Ukrainën, studimi ofron një mundësi për të analizuar propozimet dhe reformat e mundshme, për t'i bërë institucionet ndërkombëtare më të efektshme dhe më të përgjegjshme. Kjo përjasje mund të ndihmojë gjithashtu në përmirësimin e mekanizmave ekzistues për të garantuar që ndërhyrjet ndërkombëtare, kur janë të nevojshme, të jenë më koherente me të drejtën ndërkombëtare dhe të bazuara në parimet e barazisë dhe drejtësisë.

Për më tepër, shqyrtimi i këtyre rasteve ndihmon për të theksuar rolin transformues që Këshilli i Sigurimit dhe ligji ndërkombëtar kanë pasur dhe mund të kenë ende në kohë ndryshimesh të shpejta gjeopolitike. Shqyrtimi i këtyre rasteve nga një këndvështrim krahasues i mundëson studiuesit të identifikojë tendenca të reja, boshllëqe, si dhe të vlerësojë nëse dhe si këto instrumente ndërkombëtare mund të përshtaten për të përballuar krizat e ardhshme. Në këtë mënyrë, kjo temë jo vetëm që është relevante për kuptimin teorik dhe praktik të menaxhimit të krizave, por gjithashtu kontribuon në përmirësimin e sistemeve aktuale të qeverisjes ndërkombëtare dhe ruajtjes së stabilitetit global.

1.2. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë dhe të vlerësojë rolin e ligjit ndërkombëtar dhe të Këshillit të Sigurimit në përballimin e krizave rajonale, duke u përqendruar në tre raste të ndryshme: *Shqipërinë (1997)*, *Kosovën (1999)* dhe *Ukrainën (2022)*. Studimi synon të eksplorojë në thellësi mekanizmat e përdorur për të menaxhuar këto kriza, ndikimin e ligjit ndërkombëtar, legjitimitetin dhe efektivitetin e ndërhyrjeve ndërkombëtare, si dhe për të identifikuar sfidat dhe boshllëqet që kanë ndikuar në procesin e menaxhimit të krizave. Përmes një analize të këtyre tre rasteve, synohet të shpjegohen dhe të vihen në pah dinamikat ndërkombëtare që influencojnë menaxhimin e krizave, si dhe të vlerësohet roli i strukturave globale, me fokus të veçantë te Këshilli i Sigurimit.

Një nga objektivat e rëndësishme të këtij studimi është të shqyrtojë mënyrën se si Këshilli i Sigurimit ka vepruar në kontekste të ndryshme dhe si vendimet dhe veprimet e tij janë pasqyruar në stabilizimin ose komplikimin e situatave të krizës. Në rastin e Shqipërisë, objektivi është të vlerësohet ndërhyrja ndërkombëtare e udhëhequr nga OKB-ja dhe Operacioni “Alba”, për të parë se si një ndërhyrje e miratuar nga Këshilli i Sigurimit ka ndikuar në stabilizimin e një shteti të vogël ballkanik. Për Kosovën, studimi synon të shqyrtojë rolin e NATO-s dhe mungesën e një rezolute të drejtpërdrejtë nga Këshilli i Sigurimit, për të kuptuar sfidat që lidhen me legjitimitetin dhe ndërhyrjen humanitare. Ndërsa në rastin e Ukrainës, objektivi kryesor është të eksplorojnë sfidat që paraqiten nga përdorimi i vetos dhe kufizimet që kjo sjell në funksionimin e Këshillit të Sigurimit.

Një tjetër objektiv i rëndësishëm është të hulumtohet ndikimi i ligjit ndërkombëtar në

ndërtimin e kornizave normative për ndërhyrjet ndërkombëtare, duke përfshirë çështje si: *sovrانيتeti, ndërhyrja humanitare, dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut*. Kjo analizë do të ndihmojë për të kuptuar se si ligji ndërkombëtar mund të përshtatet dhe të forcohet për t'iu përgjigjur më mirë krizave rajonale në të ardhmen. Për më tepër, studimi synon të bëjë një krahasim ndërmjet rasteve për të nxjerrë mësim të vlefshme dhe për të ofruar rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të Këshillit të Sigurimit dhe të sistemit ndërkombëtar të menaxhimit të krizave. Në këtë mënyrë, ai synon të kontribuojë në literaturën ekzistuese dhe të ndihmojë në zhvillimin e politikave më të forta dhe më të qëndrueshme për menaxhimin e konflikteve.

Një tjetër objektivi kyç i këtij studimi është të analizojë *faktorët politikë dhe strukturorë* që ndikojnë në rolin dhe efektivitetin e Këshillit të Sigurimit në krizën e Ukrainës, përfshirë përdorimin e vetos nga anëtarët e përhershëm. Kjo do të mundësojë një vlerësim të ndikimit të interesave kombëtare të fuqive të mëdha në funksionimin e një institucioni që synon të jetë një garantues i paqes dhe sigurisë globale. Përmes këtij studimi, synohet të kuptohet se si dhe pse ky mekanizëm shpesh mund të paralizohet në situata kritike dhe si mund të përmirësohet për të ruajtur legjitimitetin dhe autoritetin e tij në përballjen me kriza të mëdha gjeopolitike.

Gjithashtu, studimi ka për qëllim të shqyrtojë dhe të krahasojë ndikimin e ndërhyrjeve të aprovuara dhe të paprovuara nga Këshilli i Sigurimit në këto tri raste. Kjo përfshin shqyrtimin e implikimeve të ndërhyrjeve unilaterale dhe multilaterale për qëndrueshmërinë afatgjatë të rajoneve të prekura. Në këtë kontekst, përmes një qasjeje të thelluar, do të eksplorohehen ndikimet e ndërhyrjeve në stabilitetin e brendshëm të shteteve

të përfshira, në përmbajtjen e konfliktit dhe në respektimin e të drejtave të njeriut. Analiza e thelluar do të ndihmojë për të përcaktuar praktikatat më të mira dhe gabimet që duhet të shmangen në të ardhmen për të përmirësuar ndërhyrjet ndërkombëtare në krizë.

1.3. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Qasja e studimit. Ky studim bazohet në një qasje cilësore dhe krahasimore, që synon të analizojë ndikimin e ligjit ndërkombëtar dhe të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS-KB) në menaxhimin e krizave rajonale. Përmes një studimi të thelluar të tri rasteve specifike – *Shqipëria, Kosova dhe Ukraina* – synohet të nxirren përfundime mbi efektivitetin dhe sfidat e ndërhyrjeve ndërkombëtare në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare. Duke u fokusuar në analizën krahasuese të tri rasteve të veçanta, qasja cilësore siguron një shpjegim të detajuar të kontekstit politik, juridik dhe ndërkombëtar që ka ndikuar në secilën ndërhyrje. Përmes një analize të thelluar dhe interpretative, do të shqyrtohet sesi ndërhyrjet janë përcjellë nga institucionet ndërkombëtare dhe çfarë mësimesh mund të nxirren për të ardhmen.

Përzgjedhja e rasteve të studimit. Tri rastet e studimit (*Shqipëria, Kosova dhe Ukraina*), janë përzgjedhur për të ilustruar analiza të ndryshme të krizave rajonale, ku ndërhyrja ndërkombëtare dhe vendimet e Këshillit të Sigurimit kanë pasur ndikime të ndryshme. Shqipëria përfaqëson një rast ndërhyrjeje të organizuar nën mbikëqyrjen ndërkombëtare “Operacioni “Alba”, ndërsa Kosova dhe Ukraina paraqesin raste me ndërhyrje më komplekse dhe të diskutueshme sa i përket ligjit ndërkombëtar dhe legjitimitetit. Përzgjedhja e *Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës* si raste studimore është bërë duke marrë parasysh rëndësinë historike dhe implikimet që kanë pasur në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare. Shqipëria paraqet një rast ndërhyrjeje për stabilizimin e një vendi të vogël pas një krize të brendshme të thellë. Ndërhyrja në Kosovë është një shembull i sfidave të legjitimitetit ndërkombëtar për ndërhyrjet ushtarake pa një rezolutë të qartë të Këshillit të Sigurimit. Ukraina përfaqëson sfidën më të fundit të

trajtimit të konflikteve gjeopolitike dhe përdorimit të vetos në KS nga një anëtar i përhershëm. Ky kombinim ofron një analizë të thelluar dhe krahasimore.

Burimet e të dhënave. Ky studim do të mbështetet në një kombinim të burimeve primare dhe sekondare për të siguruar një analizë gjithëpërfshirëse. Burimet primare përfshijnë dokumentet e Kombeve të Bashkuara, rezolutat dhe raportet e organizatave ndërkombëtare që lidhen me ndërhyrjet e përzgjedhura. Nga ana tjetër, burimet sekondare përfshijnë literaturën akademike nga autorë dhe studiues të ndryshëm që kanë trajtuar çështje të ngjashme, për të siguruar një perspektivë të thelluar teorike dhe historike.

Metodat për mbledhjen e të dhënave. Metodat e mbledhjes së të dhënave përfshijnë analizën dokumentare, duke përfshirë rezolutat, raportet dhe dokumentet zyrtare të Kombeve të Bashkuara, si dhe materialet nga organizatat ndërkombëtare që kanë kontribuar në menaxhimin e krizave në këto raste. Kjo metodë do të përdoret për të siguruar një pasqyrë të plotë të proceseve të vendimmarrjes dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e krizave. Gjithashtu, rishikimi i literaturës akademike do të sigurojë një kuadër teorik të fortë për të vlerësuar ndërhyrjet nga një këndvështrim analitik.

Analiza dokumentare. Përdorimi i dokumenteve dhe raporteve të Këshillit të Sigurimit, dokumenteve ndërkombëtare dhe materialeve të tjera të disponueshme publikisht, për të mbledhur të dhëna mbi ndërhyrjet e përzgjedhura.

Rishikimi i literaturës. Përdorimi i një qasjeje të strukturuar për të rishikuar literaturën ekzistuese mbi temën e ligjit ndërkombëtar dhe ndërhyrjet e Këshillit të Sigurimit, duke

përfshirë teoritë e legjitimitetit, sovranitetit dhe ndërhyrjes.

Metodat e analizës së të dhënave. Analiza e të dhënave do të bëhet duke përdorur një qasje tematike, që do të identifikojë dhe analizojë temat kryesore të lidhura me ndërhyrjet ndërkombëtare dhe rolin e Këshillit të Sigurimit. Kjo do të përfshijë legjitimitetin e ndërhyrjeve, sfidat e sovranitetit dhe ndikimin e vendimeve të KS. Gjithashtu, një analizë krahasuese do të përdoret për të vlerësuar dallimet dhe ngjashmëritë midis tri rasteve të studiuara, duke nxjerrë në pah faktorët që kanë ndikuar në suksesin ose dështimin e ndërhyrjeve.

Analiza tematike. Identifikimi dhe analizimi i temave kryesore që lidhen me ndërhyrjet ndërkombëtare dhe rolin e Këshillit të Sigurimit. Kjo përfshin analiza mbi ligjshmërinë, legjitimitetin, sfidat dhe rezultatet e ndërhyrjeve.

Krahasimi ndërmjet rasteve. Krahasimi i tri rasteve për të nxjerrë në pah faktorët që ndikojnë në suksesin ose dështimin e ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe për të vlerësuar ndikimin e vendimeve të KS në secilin rast.

Analiza e diskutimeve dhe debatit ligjor. Vlerësimi i diskutimeve ligjore që lidhen me ndërhyrjet në secilin rast, duke marrë në konsideratë aspekte si vetoja e përdorur nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, ndikimi i të drejtës humanitare dhe sfidat e sovranitetit.

Argumentimi i qasjes metodologjike. Zgjedhja e qasjes cilësore dhe krahasuese është bërë

për shkak të kompleksitetit të rasteve të studiuara dhe nevojës për të analizuar ndikimin e ligjit ndërkombëtar dhe të Këshillit të Sigurimit nga një perspektivë të thelluar dhe të kontekstualizuar. Ndryshe nga qasjet kuantitative, të cilat shpesh nuk i trajtojnë në mënyrë të plotë çështjet e legjitimitetit dhe ligjshmërisë në ndërhyrje, kjo qasje lejon një vështrim të thelluar të dinamikave komplekse që lidhen me ndërhyrjet ndërkombëtare.

Qasja cilësore dhe krahasuese është zgjedhur për të siguruar një kuptim të thelluar dhe të detajuar të dinamikave komplekse të ndërhyrjeve ndërkombëtare në tri raste të ndryshme. Kjo qasje lejon një analizë të plotë të aspekteve politike, juridike dhe të drejtës ndërkombëtare që lidhen me ndërhyrjet e përzgjedhura. Duke trajtuar legjitimitetin dhe sfidat ligjore nga një perspektivë kontekstuale, ky studim synon të ofrojë njohuri të vlefshme për sfidat dhe mundësitë e përmirësimit të ndërhyrjeve ndërkombëtare.

Kufizimet e metodologjisë. Kufizimet e kësaj metodologjie përfshijnë mbështetjen kryesisht në burime dokumentare dhe literatura ekzistuese, si dhe vështirësinë për të marrë perspektiva të drejtpërdrejta nga aktorët e përfshirë në raste të tilla. Megjithatë, përpjekjet do të përqendrohen në sigurimin e një analize të plotë dhe të ndershme të të dhënave të disponueshme. Ndër kufizimet kryesore të kësaj metodologjie është mbështetja kryesisht në burimet dokumentare dhe literaturën ekzistuese, e cila mund të mos ofrojë gjithmonë një perspektivë të përditësuar mbi ndërhyrjet e përzgjedhura. Gjithashtu, mund të ketë vështirësi për të siguruar qasje në të dhëna të drejtpërdrejta nga aktorët e përfshirë në menaxhimin e krizave. Megjithatë, përpjekjet do të përqendrohen në sigurimin e një analize të plotë dhe të ndershme përmes shqyrtimit të një spektri të gjerë të burimeve.

1.4. PYETJET KËRKIMORE DHE HIPOTEZAT

Pyetja kërkimore kryesore: *Cili është roli i ligjit ndërkombëtar në përballimin e krizave rajonale dhe si ndikojnë faktorët politikë dhe strukture në efektivitetin e këtyre mekanizmave në kontekste të ndryshme, si Shqipëria (1997), Kosova (1999) dhe Ukraina (2022)?*

Hipoteza kryesore: *Roli i ligjit ndërkombëtar në përballimin e krizave rajonale është i ndikuar në mënyrë domethënëse dhe të ndërruar nga faktorët politikë, interesat e fuqive të mëdha dhe konteksti specifik rajonal, që kontribuojnë në krijimin e një terreni për mangësi efikasiteti apo legjitimitet të debatueshëm të ndërhyrjeve ndërkombëtare.*

Pyetje kërkimore ndihmëse 1: *Si ka ndikuar vendimi i Këshillit të Sigurimit për të miratuar Operacionin “Alba” në stabilizimin e krizës në Shqipëri (1997) dhe çfarë tregon ky rast për legjitimitetin dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të aprovuara ndërkombëtarisht?*

Hipoteza ndihmëse 1: *Ndërrhyrja ndërkombëtare në Shqipëri më 1997 përmes Operacionit “Alba”, e miratuar nga Këshilli i Sigurimit, ilustron një rast të suksesit të ndërhyrjeve shumëpalëshe, duke demonstruar se ndërhyrjet me bazë ligjore dhe mbështetje të qartë ndërkombëtare mund të kontribuojnë në stabilitetin e vendeve në krizë.*

Pyetje kërkimore ndihmëse 2: *Cilat janë implikimet e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë (1999) pa një rezolutë të qartë nga Këshilli i Sigurimit dhe çfarë pasoja ka kjo për*

legjitimitetin e ndërhyrjeve humanitare në bazë të së drejtës ndërkombëtare?

Hipoteza ndihmëse 2: *Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë pa një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së tregon tensionin midis të drejtës për ndërhyrje humanitare dhe parimit të sovranitetit, duke ngritur pyetje për legjitimitetin e ndërhyrjeve të tilla dhe duke reflektuar mbi nevojën për reformimin e mekanizmave ndërkombëtarë për ndërhyrje.*

Pyetje kërkimore ndihmëse 3: *Si ka ndikuar përdorimi i vetos nga Rusia efektivitetin e Këshillit të Sigurimit në krizën e Ukrainës (2022) dhe cilat janë implikimet për të ardhmen e sigurisë ndërkombëtare dhe funksionimin e Këshillit?*

Hipoteza ndihmëse 3: *Përdorimi i vetos nga Rusia në lidhje me krizën e Ukrainës ka theksuar kufizimet strukturore të Këshillit të Sigurimit, duke treguar se interesat e fuqive të mëdha shpesh paralizojnë efikasitetin e këtij mekanizmi në trajtimin e krizave ku përfshihen fuqitë e mëdha, gjë që e bën të nevojshme reformimin e tij për një menaxhim më të drejtë dhe efektiv të krizave.*

1.5. KUFIZIMET E STUDIMIT

Rishikimi i literaturës ekzistuese mbi temën “*Ligji Ndërkombëtar dhe ndikimi i tij në çështje të sigurisë. Raste Studimore: Shqipëri, Kosovë, Ukrainës*”, nxjerr në pah disa mangësi që krijojnë hapësira për kërkime të mëtejshme. Së pari, ndërkohë që ka një volum të pasur të literaturës që trajton rolin e KS-së dhe ndërhyrjet ndërkombëtare, shumë prej studimeve fokusohen në analizën e rasteve individuale pa thelluar ndikimet e ndërhyrjeve mbi stabilitetin afatgjatë dhe mbi ndërveprimin midis aktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë.

Për shembull, ndërsa ndërhyrja e NATO-s në Kosovë është studiuar gjerësisht, mbetet një boshllëk në kuptimin e plotë të efektivitetit të strategjive të pas-ndërhyrjes për pajtimin dhe ndërtimin e institucioneve që përfshijnë komunitetet lokale. Kjo tregon se kërkime të mëtejshme mund të përqendrohen në vlerësimin afatgjatë të ndërhyrjeve dhe në analizën e mekanizmave për të garantuar një tranzicion të qëndrueshëm drejt stabilitetit.

Një tjetër kufizim në literaturën ekzistuese është mungesa e analizave krahasuese të ndikimit të ligjit ndërkombëtar në kontekste të ndryshme gjeopolitike, siç janë *Shqipëria, Kosova dhe Ukraina*. Studimet ekzistuese shpesh kanë një qasje të izoluar dhe nuk ofrojnë një analizë gjithëpërfshirëse të dinamikave specifike të këtyre rasteve, përfshirë ndërveprimin kompleks të fuqive të mëdha dhe interesave të ndryshme të aktorëve rajonalë. Ky studim synon të ofrojë kontribut në drejtim duke bërë një krahasim të thelluar të rasteve studimore për të kuptuar më mirë si funksionon ligji ndërkombëtar dhe roli i KS-së në stabilizimin e rajoneve pas krizave. Kjo mund të ndihmojë në krijimin e një kuadri më të qartë për reformimin e praktikave ndërkombëtare dhe për të ndërtuar

mekanizma më efektive për parandalimin e konflikteve në të ardhmen.

Një tjetër kufizim që kërkon vëmendje të mëtejshme është kuptimi i dinamikave midis ligjit ndërkombëtar dhe sovranitetit shtetëror në kontekstin e ndërhyrjeve të autorizuara dhe të paautorizuara nga Këshilli i Sigurimit. Ndërsa literatura ekzistuese përqendrohet kryesisht në sfidat ligjore dhe normat e ndërhyrjeve, mbetet e paqartë se si mund të krijohen modele të reja për të harmonizuar këto dy koncepte në raste të krizave emergjente. Për shembull, ndërhyrjet e paautorizuara, si ajo e NATO-s në Kosovë, ngrejnë pyetje komplekse mbi legjitimitetin moral dhe ligjshmërinë, duke treguar nevojën për analiza më të thelluara mbi fleksibilitetin dhe kufizimet e ligjit ndërkombëtar në situata të veçanta.

Një kufizim shtesë i këtij studimi lidhet me pamundësinë për të realizuar intervista të drejtpërdrejta me ekspertë të fushës së të drejtës ndërkombëtare, diplomacisë dhe sigurisë. Kjo mungesë është kryesisht e diktuar nga faktorë të tillë si kufizimet kohore, aksesueshmëria e kufizuar ndaj aktorëve institucionalë relevantë, si dhe vështirësitë logjistike për organizimin e intervistave me profesionistë me përvojë në misione ndërkombëtare apo në strukturat e Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë që përfshirja e perspektivave empirike do të kishte pasuruar ndjeshëm analizën, sidomos në lidhje me vlerësimet mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe aplikimin praktik të instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare, studimi e kompenson këtë mungesë përmes një analize të thelluar të literaturës sekondare dhe burimeve dokumentare relevante. Në të ardhmen, realizimi i intervistave me ekspertë të fushës do të përbënte një vlerë të shtuar për avancimin e kërkimeve në këtë drejtim, duke ofruar një kuadër më praktik dhe të orientuar drejt

politikëbërjes për menaxhimin e krizave dhe ndërtimin e paqes në rajone të brishta.

Për më tepër, mendoj se ka një mungesë të qasjes ndërdisiplinore në literaturën ekzistuese që lidh ndikimin e ligjit ndërkombëtar dhe ndërhyrjeve me faktorë socio-ekonomikë, kulturorë dhe historikë të vendeve të prekura. Ky studim synon të kontribuojë në këtë aspekt duke përdorur një qasje gjithëpërfshirëse që do të ndihmojë në analizimin e ndërveprimit të ligjit ndërkombëtar me faktorët e brendshëm që ndikojnë në rindërtimin dhe stabilitetin pas krizave. Kjo do të mundësojë një kuptim më të plotë të sfidave dhe mundësive që ekzistojnë për të forcuar stabilitetin rajonal përmes përdorimit të suksesshëm të instrumenteve ndërkombëtare të drejtësisë dhe paqes.

1.6. PËRMBLEDHJA DHE STRUKTURA E STUDIMIT

Struktura e studimit për temën "*Roli i ligjit ndërkombëtar në çështje të sigurisë. Raste studimore: Shqipëri, Kosovë, Ukrainë*" do të ndjekë një qasje të organizuar që pasqyron qëllimin, objektivat dhe rëndësinë e studimit, duke adresuar në mënyrë sistematike pyetjet kërkimore. Struktura e propozuar do të jetë si më poshtë:

Hyrja. Hyrja do të vendosë kornizën për gjithë studimin duke prezantuar rëndësinë dhe sfidat që hasen në ndërhyrjet ndërkombëtare dhe rolin që ligji ndërkombëtar dhe Këshilli i Sigurimit luajnë në përballimin e krizave rajonale. Do të shpjegohen arsyet për përzgjedhjen e tri rasteve specifike të studimit – *Shqipëria (1997)*, *Kosova (1999)* dhe *Ukraina (2022)* – dhe ndikimi që këto raste kanë në të kuptuarit e ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe sigurisë globale. Hyrja gjithashtu do të përfshijë një përmbledhje të qëllimit, objektivave, pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të studimit, duke e pozicionuar atë në kontekstin e literaturës dhe sfidave bashkëkohore.

Kuadri teorik dhe rishikimi i literaturës. Ky kapitull do të përqendrohet në teoritë kryesore të ligjit ndërkombëtar, ndërhyrjes ndërkombëtare dhe rolit të Këshillit të Sigurimit në menaxhimin e krizave. Ai do të shqyrtojë perspektivat normative dhe kritike mbi ndërhyrjet humanitare, sovranitetin dhe legjitimitetin e ndërhyrjeve, si dhe debatet mbi efektivitetin dhe reformat e mundshme të Këshillit të Sigurimit. Rishikimi i literaturës do të sigurojë bazën për analizën që do të bëhet në kapitujt pasues, duke lidhur teorinë me kontekstin praktik të rasteve të studiuara.

Rasti i Shqipërisë (1997). Ky kapitull do të paraqesë sfondin e krizës së vitit 1997 në

Shqipëri, duke përfshirë shpërthimin e krizës ekonomike dhe sociale dhe ndërhyrjen e mëvonshme ndërkombëtare përmes Operacionit “Alba”. Analiza do të përqendrohet në rolin e Këshillit të Sigurimit në miratimin e kësaj ndërhyrjeje dhe në ndikimin e saj mbi stabilitetin dhe rindërtimin e Shqipërisë. Në këtë pjesë do të shqyrtohet gjithashtu efikasiteti dhe legjitimiteti i ndërhyrjes, duke u përqendruar në arritjet dhe sfidat që u hasën gjatë procesit.

Rasti i Kosovës (1999). Ky kapitull do të ofrojë një analizë të krizës në Kosovë dhe ndërhyrjes ndërkombëtare nga NATO, duke marrë parasysh mungesën e një rezolute të qartë të Këshillit të Sigurimit. Do të trajtohen çështjet e legjitimitetit dhe ligjshmërisë së ndërhyrjes, si dhe debati mbi të drejtën për ndërhyrje humanitare në mbrojtje të popullsisë civile. Analiza do të përfshijë ndikimin e kësaj ndërhyrjeje në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në zhvillimin e mëtejshëm të normave të ndërhyrjes humanitare.

Rasti i Ukrainës (2022). Ky kapitull do të eksplorojë krizën e Ukrainës dhe ndërhyrjet ndërkombëtare që lidhen me të, me fokus në përdorimin e vetos nga Rusia dhe ndikimin e kësaj situatë në funksionimin dhe efektivitetin e Këshillit të Sigurimit. Do të analizohet se si përdorimi i vetos kufizon mundësitë për ndërhyrje dhe përkeqëson konfliktet ndërkombëtare. Ky kapitull do të shqyrtojë gjithashtu sfidat për ligjin ndërkombëtar dhe sistemin e sigurisë globale që shfaqen në kontekstin e konflikteve të përfshira nga fuqitë e mëdha.

Diskutim krahasues dhe analizë e përgjithshme. Në këtë kapitull, do të kryhet një analizë krahasuese e tri rasteve, duke nxjerrë në pah faktorët e përbashkët dhe dallimet që kanë

ndikuar në mënyrën se si ndërhyrjet ndërkombëtare janë realizuar dhe janë perceptuar. Do të trajtohet roli i ligjit ndërkombëtar dhe Këshillit të Sigurimit në secilin rast dhe do të bëhet një vlerësim i efikasitetit dhe mësimave të nxjerra për ndërhyrjet e ardhshme.

Rekomandime dhe përfundime. Ky kapitull do të përfshijë rekomandime për përmirësimin e rolit të ligjit ndërkombëtar dhe të Këshillit të Sigurimit në menaxhimin e krizave. Përfundimet do të përmbledhin gjetjet kryesore të studimit dhe do të nënvizojnë rëndësinë e analizës për përmirësimin e mekanizmave ndërkombëtarë dhe reformën e institucioneve për ruajtjen e paqes dhe sigurisë globale.

1.7. RËNDËSIA DHE KONTRIBUTI I STUDIMIT

Studimi mbi rolin e ligjit ndërkombëtar dhe të Këshillit të Sigurimit në përballimin e krizave rajonale duke analizuar rastet e *Shqipërisë (1997)*, *Kosovës (1999)* dhe *Ukrainës (2022)* mendoj se merr rëndësi për disa arsye. Në një kohë kur konfliktet rajonale dhe ndërkombëtare po bëhen gjithnjë e më të komplikuar dhe ndërhyrjet ndërkombëtare përballen me sfida komplekse ligjore dhe politike, kjo temë adreson një nevojë kritike për të kuptuar më mirë mekanizmat që merren me menaxhimin e krizave. Për më tepër, duke analizuar këto raste, studimi synon të kontribuojë në literaturën ekzistuese në fushën e së drejtës ndërkombëtare, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikave të sigurisë, duke ofruar një qasje të thelluar, krahasuese dhe analitike mbi mënyrën se si funksionojnë këto mekanizma në situata të ndryshme.

Rëndësia e këtij studimi qëndron gjithashtu në thellimin e kuptimit të sfidave që hasen gjatë zbatimit të ligjit ndërkombëtar dhe në funksionimin e Këshillit të Sigurimit për të menaxhuar dhe parandaluar konfliktet. Rastet e përzgjedhura – *Shqipëria, Kosova dhe Ukraina* – janë të veçanta jo vetëm për shkak të konteksteve të ndryshme historike dhe gjeopolitike, por edhe për shkak të mënyrës se si ato pasqyrojnë dështimet, sukseset dhe kompleksitetin e veprimeve ndërkombëtare. Studimi do të ndihmojë në identifikimin e praktikave më të mira dhe të boshllëqeve që kanë ndikuar në efikasitetin e ndërhyrjeve ndërkombëtare, duke siguruar një bazë solide për përmirësimin e politikave dhe procedurave që ndihmojnë në parandalimin dhe menaxhimin e krizave.

Kontributi i këtij studimi mendoj se mund të vlerësohet në: Së pari, ai ofron një vlerësim

të thelluar dhe të bazuar në fakte të rolit që Këshilli i Sigurimit ka luajtur në ndërhyrjet ndërkombëtare në këto tri raste. Ky kontribut është i rëndësishëm për të kuptuar se si faktorët politikë, si p.sh. përdorimi i vetos nga anëtarët e përhershëm, mund të ndikojnë në efektivitetin e ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në rajone të caktuara. Kjo analizë do të mundësojë gjithashtu një kuptim më të thellë të mekanizmave dhe procedurave të brendshme të Këshillit të Sigurimit, si dhe të faktorëve që ndihmojnë ose pengojnë funksionimin e tij.

Së dyti, studimi ofron një perspektivë të krahasuar të ndërhyrjeve të aprovuara dhe të paprovuara nga Këshilli i Sigurimit, duke trajtuar implikimet e ligjshmërisë dhe legjitimitetit të këtyre veprimeve. Rasti i ndërhyrjes në Kosovë nga NATO, pa një rezolutë të qartë të Këshillit të Sigurimit, është një shembull që ngre pyetje të rëndësishme në lidhje me tensionet midis sovranitetit dhe të drejtave të njeriut. Kjo analizë mendon se ndihmon për të kuptuar më mirë sfidat që lidhen me ndërhyrjet humanitare dhe për të përcaktuar se në cilat rrethana ndërhyrjet ndërkombëtare mund të justifikohen ligjërisht dhe politikisht.

Së treti, përmes shqyrtimit të krizës në Ukrainë, studimi nxjerr në pah sfidat e mëdha të përdorimit të vetos nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, një çështje që përbën një pengesë të madhe për vendimmarrjen efektive në menaxhimin e konflikteve globale. Kjo çështje është e rëndësishme për të kuptuar se si mund të reformohet Këshilli i Sigurimit për të qenë më i përgjegjshëm dhe më i përshtatshëm për të trajtuar kërcënimet bashkëkohore për sigurinë ndërkombëtare.

Studimi ka për qëllim të kontribuojë në debatin mbi nevojën për reforma të institucioneve ndërkombëtare dhe për të forcuar kuadrin ligjor ndërkombëtar për menaxhimin e krizave. Përmes analizës së rasteve specifike, studimi ofron një bazë të vlefshme për propozimin e rekomandimeve që mund të ndihmojnë në përmirësimin e menaxhimit të krizave dhe në forcimin e ligjit ndërkombëtar si një mjet për garantimin e paqes dhe sigurisë rajonale e globale. Për më tepër, studimi ka rëndësi për zhvillimin e një qasjeje të plotë dhe sistematike ndaj krizave që përfshijnë ndërhyrje ndërkombëtare, duke krijuar një bazë për diskutimin mbi reformat e mundshme të mekanizmave ndërkombëtarë të sigurisë.

Në një botë ku konfliktet gjeopolitike shpesh sfidojnë parimet dhe praktikat ekzistuese, një analizë e hollësishme e rasteve të *Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës*, do të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit për nevojën për një bashkëpunim më të fortë ndërkombëtar. Studimi mund të shërbejë si një udhëzues për politikëbërësit, organizatat ndërkombëtare dhe komunitetin akademik për të përmirësuar ndërhyrjet dhe për të gjetur mënyra më efektive për të ruajtur paqen dhe sigurinë globale.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është lidhja e tij me debatin mbi legjitimitetin dhe normat e ndërhyrjeve ndërkombëtare. Duke analizuar mënyrën sesi janë justifikuar dhe zbatuar ndërhyrjet në rastet e studiuara, ai ndihmon për të kuptuar se në çfarë mase ligji ndërkombëtar ndikon dhe përcakton rregullat e përfshirjes në situata të krizës. Ky fokus është veçanërisht i rëndësishëm në një epokë ku ekziston një tension midis respektimit të sovranitetit kombëtar dhe detyrimit për të ndërhyrë në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Studimi eksploron kufijtë dhe mundësitë e ndërhyrjeve humanitare, duke ofruar një perspektivë më të balancuar për politikën ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare.

Në fund, rëndësia e këtij studimi qëndron në analizën e ndikimit të ndërhyrjeve ndërkombëtare në stabilitetin e brendshëm dhe të ardhmen e vendeve të përfshira. Përmes një vështrimi krahasues dhe gjithëpërfshirës, ai kontribuon në diskutimin mbi pasojat afatgjata të ndërhyrjeve për stabilitetin, rimëkëmbjen dhe transformimin politik të vendeve në krizë. Duke u fokusuar në *Shqipërinë, Kosovën dhe Ukrainën*, studimi ofron një shembull të qartë të ndikimeve të ndryshme që mund të kenë ndërhyrjet ndërkombëtare, në varësi të rrethanave politike, juridike dhe gjeostrategjike. Kjo qasje ndihmon në kuptimin më të mirë të aspekteve që ndikojnë në suksesin ose dështimin e ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe për të përcaktuar mësimet e nxjerra për menaxhimin e krizave të ardhshme.

KAPITULLI II: KUADRI TEORIK DHE RISHIKIMI I LITERATURËS

Pjesa I: Rishikimi i literaturës mbi ligjin ndërkombëtar dhe ndërhyrjet paqeruajtëse

2.1. Hyrje

Kapitulli i dytë i këtij disertacioni synon të vendosë themelet teorike dhe konceptuale mbi të cilat mbështetet analiza e mëtejshme lidhur me ndikimin e ligjit ndërkombëtar në mjedisin e sigurisë. Në një kohë kur rendi ndërkombëtar përballet me kriza të ndërlikuara dhe konflikte të zgjatura, si në Ukrainë, Kosovë apo në situata të brishta si ajo e Shqipërisë pas kolapsit institucional të vitit 1997, kuptimi i rolit të ligjit ndërkombëtar kërkon një qasje të thelluar dhe shumëdisiplinore. Ky kapitull përqendrohet në eksplorimin e zhvillimeve teorike dhe të literaturës shkencore që kanë trajtuar ndërhyrjet ndërkombëtare, përgjegjësinë për të mbrojtur (R2P), sovranitetin, dhe legjitimitetin e përdorimit të forcës në mjedisin bashkëkohor të sigurisë.

Objektivi kryesor i këtij kapitulli është të analizojë mënyrën se si ligji ndërkombëtar kuptohet, zbatohet dhe sfidohet në kontekstin e krizave dhe ndërhyrjeve, duke ndriçuar mospërputhjet ndërmjet legalitetit dhe legjitimitetit, ndërmjet sovranitetit tradicional dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut. Në këtë kuadër, kapitulli ofron një rishikim kritik të literaturës, duke shqyrtuar burimet akademike dhe institucionale mbi rolin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, përdorimin e vetos, normat e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe transformimet në praktikën e ndërhyrjeve pas Luftës së Ftohtë.

Kapitulli ndahet në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë fokusohet në rishikimin e literaturës lidhur me ndërhyrjet ndërkombëtare dhe funksionin e ligjit ndërkombëtar në kornizën e

Kartës së Kombeve të Bashkuara, veçanërisht *nenet 39–51* që rregullojnë ndërhyrjet në raste kërcënimesh ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Kjo pjesë shqyrton mënyrën se si është interpretuar dhe aplikuar kjo kornizë ligjore në raste specifike, si ndërhyrja në Kosovë pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit apo ndërhyrja në Libi më 2011.

Pjesa e dytë e kapitullit trajton qasjet teorike kryesore që ndihmojnë në kuptimin e marrëdhënieve ndërmjet ligjit ndërkombëtar dhe çështjeve të sigurisë. Realizmi, siç përfaqësohet nga Hans Morgenthau, thekson interesin vetjak të shteteve dhe mosfunksionimin e rregullave ligjore në një sistem anarkik ndërkombëtar (Morgenthau, 1948). Në të kundërt, liberalizmi institucionalist, përfaqësuar nga Robert Keohane dhe Joseph Nye, argumenton se institucionet ndërkombëtare dhe normat kanë fuqi për të moderuar sjelljen e shteteve dhe për të garantuar sigurinë kolektive (Keohane & Nye, 2012). Konstruktivizmi, me autorë si Martha Finnemore, vë në qendër rolin e normave, identiteteve dhe perceptimeve në legjitimimin e ndërhyrjeve dhe në ndryshimin e sjelljes ndërkombëtare (Finnemore, 2003). Ndërkohë, qasjet kritike si TWAIL (Third World Approaches to International Law), përfaqësuar nga Anghie, kritikojnë përdorimin selektiv të ligjit ndërkombëtar dhe ndërhyrjet si forma të reja të hegjemonisë dhe neokolonializmit (Anghie, 2005).

Përmes këtij kapitulli synohet të krijohet një kuadër analitik gjithëpërfshirës, që mundëson më tej një vlerësim të thelluar të rasteve studimore në kapitujt vijues – *Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës* – si tre kontekste ku ligji ndërkombëtar është testuar në mënyra të ndryshme dhe ka pasur ndikime të dallueshme mbi mjedisin e sigurisë dhe legjitimitetin ndërkombëtar.

2.2. Evolucion i ndërhyrjeve ndërkombëtare

Ndërhyrjet ndërkombëtare kanë qenë ndër mjetet më të debatueshme në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare, duke u pozicionuar në pikëprerjen midis sovranitetit shtetëror, ruajtjes së paqes ndërkombëtare dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut. Në rrjedhën e historisë, koncepti i ndërhyrjes ka kaluar nga një mjet i fuqive të mëdha për të mbrojtur interesat e tyre politike dhe ekonomike, në një nocion më të zhvilluar që përfshin ndërhyrjen për arsye humanitare (Ayoob, 2002). Veçanërisht pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ndërhyrja humanitare mori një kuptim të ri, duke u mbështetur gjithnjë e më shumë në korniza normative dhe institucione shumëpalëshe si Kombet e Bashkuara. Ky evolucion i ndërhyrjeve tregon për një tension të vazhdueshëm midis legalitetit formal dhe legjitimitetit moral në veprimet ndërkombëtare (Talentino, 2005).

Në periudhën para shekullit XX, ndërhyrjet ndërkombëtare ishin kryesisht të motivuara nga interesa politike dhe gjeostrategjike. Fuqitë koloniale përdornin ndërhyrjen si një instrument për të ruajtur rendin, për të mbrojtur qytetarët e tyre jashtë vendit ose për të përmbysur qeveri që konsideroheshin të rrezikshme për interesat e tyre. Chesterman (2002) thekson se ndërhyrjet e tilla rrallë justifikoheshin me nevojën për të mbrojtur popullsitë vendase dhe shpesh përdornin ligjërime të paternalizmit moral për të maskuar motivet reale. Kjo lloj ndërhyrjeje politike përforcoi ideologjinë e sovranitetit si një mjet mbrojtjeje për shtetet e dobëta, të cilat shpesh ishin viktime të ndërhyrjes selektive nga fuqitë e mëdha.

Ndërhyrja për qëllime humanitare, në dallim nga ajo politike, u konceptua si një akt ndërkombëtar për të parandaluar ose ndaluar vuajtje masive, shpesh të lidhura me krime

kundër njerëzimit, gjenocid ose shkelje sistematike të të drejtave të njeriut. Në shekullin XX, koncepti filloi të formalizohej në debate teorike dhe ligjore, megjithëse mbeti shumë i diskutueshëm. Orford (2003) argumenton se ndërhyrja humanitare nuk është një zhvillim neutral, por një projekt normativ i ndërtuar mbi kontekste specifike historike dhe politike. Ajo tregon se ndërhyrja shpesh shërben si një mekanizëm për të ri-konfiguruar marrëdhëniet ndërmjet fuqive globale dhe periferive të tyre, duke mbuluar përfitime politike pas një fasade humanitare.

Pas Luftës së Ftohtë, ndërhyrjet ndërkombëtare, sidomos ato të karakterit humanitar, morën një vrull të ri si pasojë e ndryshimeve në rendin ndërkombëtar dhe dobësimit të barrierave ideologjike. Me rënien e sistemit bipolar, u krijua një hapësirë më e madhe për veprim shumëpalësh dhe për angazhime ndërkombëtare të bazuara mbi standarde të përbashkëta të të drejtave të njeriut. Sipas Roberts dhe Zaum (2008), perioda pas vitit 1990 u karakterizua nga një përqendrim më i madh në përgjegjësinë kolektive të bashkësisë ndërkombëtare për të ndërhyrë në kriza humanitare, siç ndodhi në Somalinë, Ruandën, Bosnjën dhe më pas në Kosovë. Në këtë kontekst, Kombet e Bashkuara dhe veçanërisht Këshilli i Sigurimit u vendosën në qendër të vendimmarrjes ndërkombëtare, edhe pse shpesh me tensione midis anëtarëve të përhershëm mbi ligjshmërinë dhe nevojën për ndërhyrje.

Rasti i ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë më 1999 paraqet një moment kyç ku kuptimi i ndërhyrjes humanitare u zgjerua, por edhe u problematizua. Ndërhyrja u bë pa autorizim formal nga Këshilli i Sigurimit, duke ngritur pyetje rreth përplasjes midis legalitetit (*mungesës së autorizimit*) dhe legjitimitetit (*nevojës për të ndaluar pastrimin etnik*). Ky rast u bë simbol i dilemës moderne të ndërhyrjes: a është më e rëndësishme të respektohet rreptësisht ligji ndërkombëtar, apo të veprohet për të shpëtuar jetë njerëzore kur

institucionet formale dështojnë të marrin masa? Roberts dhe Zaum (2008) theksojnë se ndërhyrja në Kosovë nxori në pah nevojën për riformulimin e ligjit ndërkombëtar përballë realiteteve humanitare.

Zhvillimi i konceptit të ndërhyrjes u pasua nga konceptualizimi i doktrinës "*Responsibility to Protect*" (R2P), i cili u miratua në Samitin Botëror të OKB-së në vitin 2005. Ky zhvillim pasqyron përpjekjen për të sistemuar ndërhyrjen humanitare në një kornizë normative dhe juridike që njeh përgjegjësinë e shteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare për të parandaluar dhe ndalur krime masive (Peters, 2011). Megjithatë, edhe pas këtij formalizimi, zbatimi i doktrinës R2P ka qenë i pabarabartë dhe i kushtëzuar nga kalkulimet politike të aktorëve të mëdhenj ndërkombëtarë, siç dëshmohet në dështimet për të vepruar në Siri apo për të parandaluar përshkallëzimin e krizës në Ukrainë. Për më tepër, koncepti i ndërhyrjes humanitare nuk ka qenë imun ndaj keqpërdorimeve. Siç thekson Orford (2003), ndërhyrja ka qenë përdorur ndonjëherë për të justifikuar veprime të njëanshme të bazuara më shumë në interesa strategjike sesa në shqetësime reale për të drejtat e njeriut. Prandaj, legjitimiteti i ndërhyrjes shpesh varet jo vetëm nga motivimi zyrtar, por edhe nga perceptimi i gjerë ndërkombëtar dhe lokal, si dhe nga rezultatet e arritura në terren.

Në përfundim, zhvillimi historik i ndërhyrjeve ndërkombëtare pasqyron një transformim të thellë nga një mjet i dominimit politik në një koncept më të sofistikuar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Megjithatë, ky transformim mbetet i paplotë dhe i pasigurt, pasi ndërhyrjet humanitare vazhdojnë të përballen me dilema ligjore, politike dhe morale. Qasja ndërkombëtare ndaj ndërhyrjes mbetet e fragmentuar dhe e ndikuar nga fuqia relative e aktorëve ndërkombëtarë, duke reflektuar tensionin e vazhdueshëm midis parimeve të ligjit ndërkombëtar dhe realpolitikës globale.

2.3. Roli dhe aplikimi i ligjit ndërkombëtar në ndërhyrjet me karakter humanitar

Ligji ndërkombëtar ka një funksion kyç në ruajtjen e paqes dhe sigurisë globale, veçanërisht nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara (OKB). Që prej themelimit të saj më 1945, OKB-ja është bërë institucioni kryesor ndërkombëtar për menaxhimin e konflikteve dhe autorizimin e përdorimit të forcës. Kompetencat që burojnë nga Karta e OKB-së, sidomos ato të përfshira në nenet 39–51, përcaktojnë qartazi kur dhe si mund të përdoret forca nga shtetet anëtare apo organizatat ndërkombëtare (Simma et al., 2024, Vol. 1, p. 112). Megjithatë, zbatimi i këtyre dispozitave nuk është gjithmonë konsistent, pasi praktikat ndërkombëtare janë formësuar nga interesat politike dhe gjeostrategjike të aktorëve kryesorë. Raste si ndërhyrja në Kosovë (1999), ndërhyrja në Libi (2011), mungesa e veprimit në Siri dhe invazioni rus në Ukrainë dëshmojnë për tensionet ndërmjet ligjit, politikës dhe legjitimitetit ndërkombëtar.

Karta e OKB-së përfaqëson bazën juridike për të drejtën ndërkombëtare të sigurisë kolektive. Neni 39 i Kartës autorizon Këshillin e Sigurimit për të identifikuar çdo kërcënim ndaj paqes, shkelje të paqes ose akt agresioni, dhe të rekomandojë ose të vendosë masa që do të merren për të ruajtur apo rivendosur paqen. Nëse kërcënimi është serioz, Këshilli mund të autorizojë masa joushtarake (*neni 41*), si embargo, sanksione ekonomike apo ndalim i udhëtimeve, ose masa ushtarake (*neni 42*), përfshirë përdorimin e forcës. *Neni 51*, garanton të drejtën e vetëmbrojtjes individuale ose kolektive në rast sulmi të armatosur, deri në momentin kur Këshilli i Sigurimit të ketë marrë masa të duhura për ruajtjen e paqes (United Nations, n.d.). Ky nen ka shërbyer si justifikim nga shtete të ndryshme për të ndërmarrë veprime të njëanshme, veçanërisht në kontekste ku veprimi i Këshillit ka qenë i bllokuar nga vetoja e përhershme e anëtarëve të tij (Weiss, 2016). Përkundër kësaj strukture ligjore, tensionet politike midis anëtarëve të përhershëm të

Këshillit (SHBA, Rusia, Kina, Franca, Britania e Madhe) kanë krijuar një sistem ku ndërhyrja legjitime shpesh nuk është e mundur nga pikëpamja formale, por ndodh përmes rrugëve alternative, ndonjëherë jashtë kuadrit ligjor të Kartës.

Rasti i Kosovës (1999): legjitimitet pa legalitet. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 mbetet një nga rastet më të debatueshme për përdorimin e forcës pa autorizim të qartë nga Këshilli i Sigurimit. Masakrat ndaj shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe dhe dështimi i diplomacisë për të ndaluar krizën çuan në ndërhyrje ushtarake të udhëhequr nga NATO, pa një rezolutë të miratuar nga Këshilli i Sigurimit për shkak të kundërshtimit të Rusisë (Malone, 2004). Ndërhyrja në Kosovë nuk përmbushi standardet e legalitetit formal, por shumë shtete e justifikuan atë në emër të legjitimitetit moral dhe humanitar, për të shmangur një katastrofë të mundshme gjenocidale. Chesterman (2002) argumenton se kjo krijoi një precedent të rrezikshëm ku shtetet e fuqishme veprojnë jashtë sistemit ligjor, duke minuar normat e Kartës së OKB-së, edhe nëse qëllimi është humanitar. Nga ana tjetër, Orford (2003) thekson se Kosova u bë pikënisja për evolucionin e doktrinë *"Responsibility to Protect" (R2P)*, një përpjekje për të sistemuar ndërhyrjen humanitare brenda kornizës normative të ligjit ndërkombëtar.

Rasti i Libisë (2011): një ndërhyrje me autorizim të plotë. Ndryshe nga Kosova, ndërhyrja në Libi në vitin 2011 u mbështet në *Rezolutën 1973* të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila autorizonte *"të gjitha mjetet e nevojshme"* për të mbrojtur civilët libianë nga forcat e Muammar Gaddafit (UNSC, 2011). Kjo ndërhyrje u konsiderua si zbatimi i parë i plotë i doktrinë R2P dhe një triumf i bashkëpunimit ndërkombëtar në mbrojtje të të drejtave të njeriut (Bellamy, 2015). Megjithatë, zhvillimet pas rrëzimit të Gaddafit e minuan këtë perceptim. Fuqitë perëndimore u akuzuan për tejkalim të mandatit, pasi qëllimi fillestar – *mbrojtja e civilëve* – u transformua në një mision për ndryshim regjimi. Nga ky moment,

Kina dhe Rusia u treguan më rezistente ndaj çdo forme autorizimi të ngjashëm, duke u bazuar në argumentin se rezolutat mund të manipulohen për qëllime të fshehta politike (Kuperman, 2016).

Rasti i Sirisë: paralizë për shkak të vetos. Në Siri, kriza e shpërthyer më 2011 dhe pasojat e saj humanitare dramatike nuk u ndoqën nga një ndërhyrje ndërkombëtare e ngjashme me atë në Libi. Këshilli i Sigurimit nuk arriti të miratonte ndonjë rezolutë për përdorimin e forcës për shkak të vetos së përsëritur të Rusisë dhe Kinës (Khallaf, 2016). Në këtë rast, dispozitat e Kartës së OKB-së nuk mund të aktivizoheshin përballë bllokadës politike, duke dëshmuar dobësinë strukturore të sistemit të sigurisë kolektive (Luck, 2016). Ndërkohë, përdorimi i armëve kimike në Siri dhe dështimi për të ndalur masakrat nxori në pah nevojën për reforma në Këshillin e Sigurimit, për të shmangur paralizat e vendimmarrjes në raste emergjente. Weiss (2016) thekson se rasti i Sirisë përbën një dështim të shumëfishtë të sistemit ndërkombëtar për të ndërhyrë në mbrojtje të popullatave të pambrojtura.

Rasti i Ukrainës: Një shkelje e drejtpërdrejtë e kartës së OKB-së. Ndryshe nga rastet e mëparshme, pushtimi i Ukrainës nga Rusia në vitin 2014 (Krimea) dhe më pas në vitin 2022 përfaqëson një shkelje të hapur të Kartës së OKB-së, në veçanti të *nenit 2(4)* që ndalon përdorimin e forcës kundër integritetit territorial të një shteti tjetër. Rusia e justifikoi ndërhyrjen me pretendime për vetëmbrojtje kolektive dhe për mbrojtjen e minoriteteve ruse, por këto pretendime u refuzuan gjerësisht nga bashkësia ndërkombëtare (UNSC, 2014). Për më tepër, si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit, Rusia ka përdorur veton për të bllokuar çdo rezolutë që dënon ose ndalon veprimet e saj në Ukrainë. Ky rast nxjerr në pah një paradoks të thellë: sistemi ligjor

ndërkombëtar është i varur nga aktorët që mund ta keqpërdorin atë për të mbrojtur shkeljet e veta (Kirgis, 2015).

Rastet e analizuar tregojnë se ligji ndërkombëtar kufizohet jo vetëm nga normat e tij, por edhe nga realitetet politike dhe fuqia e aktorëve globalë. Ai shpesh shërben më shumë si mjet legjitimimi sesa si instrument parandalimi, duke qenë efektiv vetëm kur ka konsensus ndërkombëtar (Koskenniemi, 2005). Raste si Kosova dhe Libia tregojnë potencialin e tij për mbrojtje civile, ndërsa Siria dhe Ukraina theksojnë dobësinë kur përplasat me interesat e fuqive të mëdha. Kjo nënvizon nevojën për reformim institucional, veçanërisht të Këshillit të Sigurimit.

Ligji ndërkombëtar, dhe në veçanti Karta e OKB-së, ka një funksion të qartë dhe të rëndësishëm në garantimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Por përmbushja e këtij funksioni varet nga vullneti politik i shteteve dhe fuqia e institucioneve për ta zbatuar atë. Rastet e *Kosovës*, *Libisë*, *Sirisë* dhe *Ukrainës* ofrojnë shembuj të ndryshëm të ndërveprimit midis ligjit, politikës dhe legjitimitetit. Ndërkohë që ligji ndërkombëtar vazhdon të shërbejë si kornizë për veprim kolektiv, kapaciteti i tij për të imponuar rregullin në një sistem ndërkombëtar të anarkik mbetet i kufizuar. Prandaj, sfida kryesore për të ardhmen është forcimi i institucioneve dhe procedurave që e bëjnë zbatimin e ligjit ndërkombëtar më të drejtë, të barabartë dhe të parashikueshëm (Brand, & Centre d'études pratiques de la négociation internationale Genève, 2003).

2.4. Kritika ndaj efektivitetit dhe legjitimitetit të ligjit ndërkombëtar

Ligji ndërkombëtar, si një sistem normativ për qeverisjen e marrëdhënieve ndërmjet shteteve, është ndërtuar mbi idenë e ruajtjes së paqes, rendit dhe drejtësisë globale. Megjithatë, efektiviteti dhe legjitimiteti i tij janë vazhdimisht në pikëpyetje, veçanërisht

në kontekstin e krizave bashkëkohore si Siria, Krimea, Ukraina apo Palestina. Një nga sfidat më të mëdha të këtij rendi ligjor ndërkombëtar është përdorimi i vetos nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, që shpesh bllokoi marrjen e vendimeve efektive në momente kritike. Për më tepër, pavarësisht zhvillimeve teorike dhe institucionale që synojnë rritjen e funksionalitetit të ligjit ndërkombëtar, tensioni ndërmjet normës dhe realpolitikës vazhdon të jetë i pranishëm, duke prodhuar një hendek midis aspiratës për një rend ligjor global dhe kufizimeve të tij praktike.

Një nga kritikët kryesorë ndaj sistemit të sigurisë kolektive të OKB-së është *përdorimi i vetos nga pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit*. Ky mekanizëm, i menduar për të ruajtur konsensusin e fuqive të mëdha, është kthyer në një mjet bllokimi për çështje që prekin interesat e tyre. Raste si Siria dhe Ukraina tregojnë qartë këtë dështim, ku Rusia ka përdorur veton mbi 15 herë për të bllokuar veprimet kundër saj (Security Council Report, 2022). Sipas Chesterman (2021), kjo praktikë jo vetëm që minon autoritetin e Këshillit, por rrezikon edhe rendin ndërkombëtar duke krijuar standarde të dyfishta.

Nëse ligji ndërkombëtar do të jetë realisht funksional, ai duhet të jetë i zbatueshëm dhe i barabartë për të gjithë. Kjo kërkon institucione të afta për të reaguar në kohë dhe për të imponuar sanksione ndaj shkelësve të normave. Bellamy (2015) thekson se koncepti i *Responsibility to Protect (R2P)*, i cili u formulua pas krizës së Kosovës dhe u aplikua në Libi, ishte një përpjekje për të rritur efektivitetin e rendit ligjor ndërkombëtar duke i dhënë bashkësisë ndërkombëtare një mjet për të ndërhyrë në raste të krimeve masive. Megjithatë, rasti i Libisë, ku ndërhyrja u interpretua si ndryshim regjimi dhe jo mbrojtje e civilëve, çoi në humbjen e besimit në këtë doktrinë dhe bllokimin e saj në raste të mëvonshme si Siria. Në artikullin e saj në *European Journal of International Law*,

Jennifer Welsh (2019), një nga autoret kryesore të konceptit R2P, vëren se mungesa e një mekanizmi të detyrueshëm për zbatimin e përgjegjësisë për të mbrojtur e ka kthyer këtë doktrinë në një mjet retorik, më shumë sesa një instrument operativ. Për të shmangur këtë, Welsh rekomandon një ristrukturim të sistemit të vendimmarrjes së Këshillit të Sigurimit, përfshirë kufizime të mundshme të të drejtës së vetos në rastet e krimeve të rënda.

Një çështje kyçe është tensioni midis legalitetit formal dhe legjitimitetit moral në ndërhyrjet ndërkombëtare. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë (1999), e bërë pa miratimin e KS-së, konsiderohet shpesh legjitime por jo ligjore (Wheeler, 2000). E njëjta dilemë shfaqet në Ukrainë, ku vetos ruse ka penguar veprime në OKB, duke detyruar Perëndimin të përdorë mjete jashtë institucioneve formale. Michael Doyle (2022) propozon konceptin e *“legalitetit të përbashkët”*, ku legjitimiteti ndërkombëtar mbështetet në konsensus dhe zbatim të unifikuar të normave, për të kapërcyer fragmentimin e rendit ndërkombëtar.

Një nga sfidat kryesore për ligjin ndërkombëtar është përplasja midis normave ligjore dhe interesave gjeopolitike të fuqive të mëdha. Rasti i Krimesë (2014) dhe agresioni rus ndaj Ukrainës (2022) ilustrojnë shkelje të qarta të parimeve të integritetit territorial dhe mosndërhyrjes. Edhe pse komuniteti ndërkombëtar reagoi me dënime dhe sanksione, mungesa e një mekanizmi efektiv ndëshkues brenda Këshillit të Sigurimit e lë ligjin ndërkombëtar të cenueshëm përballë agresionit (Boon, 2022). Klabbers (2023) thekson se në rendin botëror post-liberal, ligji ndërkombëtar ndikohet thellësisht nga marrëdhëniet e pushtetit, duke u përdorur nga fuqitë e mëdha më tepër si instrument justifikues sesa si normë detyruese, çka prodhon një *“hipokrizi të institucionalizuar”*.

Një sfidë kryesore për ligjin ndërkombëtar është përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë në konfliktet moderne, ku juridiksioni tradicional shpesh nuk mjafton. Gjykata Penale

Ndërkombëtare (ICC) ka tentuar të mbulojë këtë boshllëk, por është përballur me kufizime juridike dhe politike, përfshirë mungesën e bashkëpunimit dhe akuza për selektivitet (Simmons, 2023). Kritika të tjera theksojnë zbatimin selektiv të ligjit ndërkombëtar, ku vendet në zhvillim e perceptojnë rendin ndërkombëtar si mjet të Perëndimit për ruajtjen e interesave të tij, siç shihet në ndërhyrjen pa mandat në Irak (2003) dhe mosveprimin në Gaza (Srikanth, 2015). Martti Koskeniemi (2020) argumenton se ligji ndërkombëtar është i ndërtuar mbi ambiguitete të qëllimshme, duke e bërë atë të manovrueshëm nga aktorët dominues, dhe propozon një qasje më kritike dhe transparente për një rend ligjor më të drejtë.

Kritikat ndaj efektivitetit dhe legjitimitetit të ligjit ndërkombëtar janë thelbësore për të kuptuar vështirësitë që ka ky sistem për të funksionuar në mënyrë të barabartë dhe efektive. Vetoja në Këshillin e Sigurimit, selektiviteti në zbatim, përplasja me interesat gjeopolitike dhe dobësitë institucionale janë faktorë që kufizojnë fuqinë reale të ligjit. Megjithatë, ekzistenca e këtyre kritikave nuk e përjashton rëndësinë e ligjit ndërkombëtar si një standard universal i sjelljes. Përkundrazi, ato duhet të shërbejnë si nxitje për reformim dhe forcim të mekanizmave ekzistues, në mënyrë që ligji ndërkombëtar të mos mbetet vetëm një ideal normativ, por një mjet praktik për drejtësi dhe paqe.

Pjesa II: Analiza e teorive kryesore mbi legjitimitetin, sovranitetin dhe ndërhyrjen humanitare

2.5. Sovraniteti: Evolucioni konceptual dhe sfidat bashkëkohore

Koncepti i sovranitetit ka qenë ndër gurët themeltarë të sistemit ndërkombëtar që nga Paqja e Vestfalisë më 1648, duke u konsideruar për shekuj me radhë si themeli i marrëdhënieve ndërmjet shteteve. Tradicionalisht, sovraniteti përfaqësonte të drejtën ekskluzive të shtetit për të ushtruar autoritet të plotë brenda kufijve të vet territorialë, pa ndërhyrje të jashtme. Megjithatë, në epokën bashkëkohore, kjo ide është përballur me sfida të shumta, sidomos përballë zhvillimeve të të drejtave të njeriut, ndërhyrjes humanitare dhe transformimeve në strukturën e rendit ndërkombëtar. Nga një parim i paprekshëm, sovraniteti po shihet gjithnjë e më shumë si një koncept i kushtëzuar nga përgjegjësitë që shtetet kanë ndaj popullsive të tyre. Ky ndryshim përbën tensionin qendror të kohëve moderne: *sovraniteti si mbrojtje kundër ndërhyrjes vs. sovraniteti si përgjegjësi për të garantuar dinjitetin dhe jetën njerëzore* (Behera, 2020).

Nga Vestfalia tek ndërhyrja në emër të të drejtave të njeriut. Origjina e konceptit modern të sovranitetit gjendet në Paqen e Vestfalisë, e cila përmbylli luftërat fetare të shekullit të XVII dhe sanksionoi parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve (Havercroft, 2012). Ky traktatë legjitimoi organizimin e botës si një bashkësi shtetesh të pavarura, secili me autoritet të plotë mbi territorin dhe popullsinë e vet. Për një kohë të gjatë, kjo qasje përjashtonte çdo formë të ndërhyrjes nga jashtë, duke e konsideruar atë një shkelje të drejtës sovrane të shtetit. Sidoqoftë, ky model absolut u vu në pikëpyetje pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht me themelimin e Kombeve të Bashkuara dhe miratimin e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) (Donnelly, 2003). Ideja

se ekzistojnë norma ndërkombëtare që tejkalojnë sovranitetin tradicional – *si ndalimi i gjenocidit, torturës apo diskriminimit sistematik* – filloi të fitojë terren. Në këtë kontekst, ndërhyrja në emër të të drejtave të njeriut nuk është më e konsideruar automatikisht si cenim i sovranitetit, por si një përpjekje për të rikthyer legjitimitetin e brendshëm të shtetit. Evolucion i kulmoi me zhvillimin e doktrinë *“Responsibility to Protect” (R2P)*, e cila formalizon idenë se sovraniteti përfshin përgjegjësinë e një shteti për të mbrojtur popullsinë e vet nga krimet më të rënda (Orford, 2003). Nëse shteti dështon, bashkësia ndërkombëtare ka të drejtën, madje edhe detyrimin, të ndërhyjë (Evans & Sahnoun, 2002).

Pavarësisht këtyre zhvillimeve normative, shumë shtete – *sidomos ato me qëndrime realiste ndaj rendit ndërkombëtar* – vazhdojnë të mbrojnë sovranitetin si një mjet për të kundërshtuar ndërhyrjet e jashtme. Rasti i Rusisë në Ukrainë ilustron më së miri këtë tension. Në pushtimin e Krimesë më 2014 dhe në ofensivën ushtarake të vitit 2022, Rusia ka përdorur retorikën e mbrojtjes së sovranitetit të vet kombëtar dhe të vetëmbrojtjes kolektive për të justifikuar veprimet e saj agresive, ndërkohë që ka shkelur sovranitetin dhe integritetin territorial të një shteti tjetër të pavarur (Boon, 2023). Në analizën e tij, Krasner (2001) e përshkruan këtë lloj përdorimi të konceptit si *“hipokrizi e organizuar”*, ku shtetet përdorin diskursin e sovranitetit për të justifikuar sjelljen e tyre, ndërkohë që e shpërfillin atë kur nuk u përshtatet interesave të tyre. Për Krasner, sovraniteti nuk është një normë absolute, por një konstrukt fleksibël që ndryshon sipas rrethanave dhe pozicionit të fuqisë në sistemin ndërkombëtar. Nga ana tjetër, autorë si Anghie (2005) kritikojnë vetë mënyrën se si është ndërtuar doktrina e sovranitetit në të drejtën ndërkombëtare, duke argumentuar se ajo ka qenë gjithmonë një instrument i fuqive perëndimore për të legjitimuar dominimin ndaj pjesës tjetër të botës. Sipas tij, ndërhyrjet

në emër të të drejtave të njeriut nuk janë domosdoshmërisht akte të çlirimtarëve, por vazhdimësi e kolonializmit me mjete të tjera.

Në epokën globale, ku sfidat si ndryshimet klimatike, pandemitë dhe terrorizmi nuk njohin kufij, sovraniteti po kuptohet si përgjegjësi e ndërsjellë, jo si autoritet absolut. Krasner (1999) dhe Held (2004) argumentojnë se një sovranitet i reformuar, që lejon ndërhyrje në raste emergjente dhe respekton të drejtat e njeriut, është më i përshtatshëm për botën e sotme. Philpott (2001) shton se ndryshime të mëdha në sovranitet ndodhin pas tronditjeve globale, dhe periudha pas 2001-shit mund të jetë e tillë për shkak të sfidave transnacionale.

Një aspekt i rëndësishëm i debatit mbi sovranitetin është tensioni midis legjitimitetit të ndërhyrjes dhe interesit kombëtar të shteteve. Në shumë raste, ndërhyrja justifikohet si mbrojtje e të drejtave të njeriut, por në të vërtetë ndikohet nga llogaritje strategjike. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë (1999), ndonëse pa miratim nga Këshilli i Sigurimit, u konsiderua legjitime nga vendet perëndimore. Në të kundërt, krizat në Ruandë dhe Siri nuk u ndoqën nga ndërhyrje për shkak të mungesës së interesit strategjik të fuqive të mëdha. Ky selektivitet, siç thekson Welsh (2019), dëmtton besimin në ndërhyrjet humanitare dhe tregon mungesën e një standardi universal në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Evolucioni i konceptit të sovranitetit nga një normë absolute në një nocion të kushtëzuar pasqyron dinamikat e ndryshimit të rendit ndërkombëtar. Nga Vestfalia tek ndërhyrja humanitare, nga Paqja si mosndërhyrje tek përgjegjësia për të mbrojtur, koncepti i sovranitetit mbetet në qendër të debateve më të nxehta mbi drejtësinë, fuqinë dhe legjitimitetin global. Rasti i Ukrainës dhe retorika e Rusisë konfirmojnë se sovraniteti

mbetet një instrument politik dhe juridik në duart e aktorëve të fuqishëm. Prandaj, sfida për rendin ndërkombëtar të së drejtës qëndron në ndërtimin e një kuptimi më të qëndrueshëm, universal dhe të balancuar të sovranitetit – një sovranitet që nuk izolon, por që bashkëpunon për të siguruar jetën dhe dinjitetin njerëzor.

2.6. Legaliteti vs. legjitimiteti në përdorimin e forcës

Përdorimi i forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare mbetet një nga çështjet më të debatueshme në të drejtën dhe teorinë ndërkombëtare. Ndërkohë që legaliteti përcaktohet nga normat e shkruara dhe kornizat institucionale, veçanërisht nga Karta e Kombeve të Bashkuara, legjitimiteti është më fluid dhe shpesh mbështetet në vlerësimet morale, politike dhe normative të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo dallesë bëhet e dukshme në kontekstin e ndërhyrjes humanitare, ku shpeshherë legaliteti mungon për shkak të bllokimeve institucionale, por legjitimiteti moral kërkon veprim të menjëhershëm për të parandaluar krime masive (Wood, n.d.). Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999, pa një autorizim formal nga Këshilli i Sigurimit, përbën një nga shembujt më të rëndësishëm të kësaj përplasjeje ndërmjet legalitetit dhe legjitimitetit në përdorimin e forcës. Sipas *nenit 2(4)* të Kartës së Kombeve të Bashkuara, ndalohet përdorimi i forcës nga shtetet anëtare përveç në rastin e vetëmbrojtjes (*neni 51*) ose me autorizimin e Këshillit të Sigurimit në përputhje me Kapitullin VII të Kartës. Ky kornizim përbën bazën ligjore të sistemit të sigurisë kolektive të pas Luftës së Dytë Botërore dhe synon të kufizojë arbitraritetin në përdorimin e forcës (Gray, 2018). Megjithatë, ky sistem ka dështuar herë pas here të funksionojë në mënyrë efektive për shkak të dinamikës së fuqisë në Këshillin e Sigurimit, veçanërisht përdorimit të vetos nga anëtarët e përhershëm. Si rezultat, aktorët

ndërkombëtarë kanë ndërmarrë veprime që bien ndesh me legalitetin formal, por që janë justifikuar me legjitimitet moral dhe humanitar.

Legjitimiteti i ndërhyrjes humanitare lidhet me perceptimin se një veprim ndërkombëtar, edhe kur është ligjërisht i diskutueshëm, mund të jetë moralisht i drejtë në rastet e krimeve të rënda ndaj civilëve. Habermas (1999) e përshkruan ndërhyrjen në Kosovë si një akt *“në kufirin midis legalitetit dhe moralitetit”*, ndërsa Wheeler (2000) thekson detyrën morale për *“shpëtimin e të huajve”* kur shteti dështon të mbrojë qytetarët e vet. Këto ide u formalizuan nga Raporti i ICISS (2001) me doktrinën *“Responsibility to Protect”* (R2P), që vendos përgjegjësinë te bashkësia ndërkombëtare për të vepruar kur shteti nuk e përmbush këtë rol. Ndërhyrja duhet të mbështetet në kritere të qarta si legjitimiteti, qëllimi i drejtë, proporcionaliteti dhe përdorimi i forcës si opsion i fundit (ICISS, 2001).

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë (1999) u krye pa autorizim të Këshillit të Sigurimit, për shkak të vetos së paralajmëruar nga Rusia dhe Kina. NATO e justifikoi atë si një nevojë për të ndaluar pastrimin etnik dhe një katastrofë humanitare, duke privilegjuar legjitimitetin moral mbi legalitetin formal (Newman & Visoka, 2024). Debati mbetet i ndarë: Franck (2002) e sheh si një precedent të rrezikshëm për veprime të njëanshme, ndërsa Tesón (2005) e mbron si të moralshëm pavarësisht mungesës së lejes formale. Pattison (2010) sugjeron se legjitimiteti duhet të vlerësohet nga rezultatet humanitare, jo vetëm nga autorizimet institucionale.

Pas vitit 2001, doktrina R2P institucionalizoi ndërhyrjen humanitare brenda kornizës së së drejtës ndërkombëtare, duke i dhënë Këshillit të Sigurimit rol qendror në autorizimin e saj. Kjo theksoi rëndësinë e legalitetit, por shpesh ka sjellë bllokime në veprim, si në

rastet e Sirisë dhe Etiopisë. Bellamy (2015) thekson se, pavarësisht këtij zhvillimi, legjitimiteti i ndërhyrjes mbetet subjektiv dhe i ndikuar nga politika, duke theksuar nevojën për kritere të standardizuara që të garantojnë një vendimmarrje më objektive.

Rastet e mëvonshme kanë komplikuar më tej dallimin mes legalitetit dhe legjitimitetit. Në Ukrainë, ndërhyrja e Rusisë është një shkelje e qartë e legalitetit ndërkombëtar, por është justifikuar nga Rusia si një akt legjitim për të mbrojtur minoritetet ruse – *një narrative që përfaqëson një abuzim të konceptit të legjitimitetit* (Dodds et al., 2023). Në anën tjetër, në Gazë dhe Siri, mungesa e ndërhyrjes ka çuar në dështim të përgjegjësisë për të mbrojtur, duke nxjerrë në pah dobësinë e sistemit aktual për të vepruar në mungesë konsensusi në Këshillin e Sigurimit (Welsh, 2019). Sipas Chesterman (2019), kjo situatë dëshmon se legjitimiteti nuk mund të jetë më një mjet për të justifikuar ndërhyrjet selektive, por duhet të jetë pjesë e një procesi institucional dhe transparent, në mënyrë që të ruhet koherenca e ligjit ndërkombëtar.

Një nga sfidat më të mëdha është ndërtimi i një modeli të tillë ku ndërhyrja humanitare të jetë njëkohësisht legale dhe legjitime. Propozime për kufizimin e të drejtës së vetos në rastet e gjenocidit, si nisma franceze dhe kanadeze në OKB, janë hapa drejt efektivizimit të sistemit ligjor dhe forcimit të legjitimitetit institucional. Grant dhe Keohane (2005) sugjerojnë një kuadër të *“ligjshmërisë me përfaqësim demokratik”* në institucionet ndërkombëtare, ku vendimmarrja nuk bazohet vetëm në interesat e fuqive të mëdha, por në përfaqësimin e gjerë të komunitetit ndërkombëtar dhe shoqërisë civile.

Dilema midis legalitetit dhe legjitimitetit në përdorimin e forcës reflekton tensionet thelbësore të rendit ndërkombëtar. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, e papërputhshme me

normat formale, por moralisht e justifikueshme përbën një pikë kthese në këtë debat. Që nga ajo kohë, konceptet e ndërhyrjes humanitare dhe R2P kanë kërkuar të ndërtojnë një urë midis legalitetit dhe legjitimitetit, por ende përballen me sfida të mëdha praktike dhe normative (Singh, 2024). Për të ruajtur koherencën e të drejtës ndërkombëtare dhe për të garantuar mbrojtjen efektive të civilëve, është e nevojshme të rikonceptohet mënyra si funksionojnë autoritetet ligjore dhe morali ndërkombëtar, në mënyrë që të mos përjashtojnë njëra-tjetrën, por të punojnë së bashku drejt një rendi më të drejtë dhe më efikas.

2.7. Doktrina R2P: Analizë kritike

Në epokën pas Luftës së Ftohtë, përballja me krimet masive ndaj civilëve dhe dështimi i bashkësisë ndërkombëtare për të parandaluar gjenocidet në Ruandë (1994) dhe Bosnjë (1995) e orientoi debatin ndërkombëtar drejt konceptit të përgjegjësisë për të mbrojtur popullsitë. Kështu u zhvillua doktrina e *Responsibility to Protect (R2P)*, e cila synon të kalojë nga e drejta për të ndërhyrë tek përgjegjësia për të mbrojtur (Kuperman, 2009). Kjo doktrinë përfshin përkufizimin e saj, kriteret themelore për zbatimin dhe analizën e rasteve të aplikimit (ose mungesës së tij), përfshirë Shqipërinë (1997), Kosovën (1999), Libinë (2011), si dhe dështimet në Siri dhe Ukrainë (Musarurwa & Kaye, 2016). *R2P (Responsibility to Protect)* u formalizua për herë të parë nga Komisioni Ndërkombëtar për Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror (ICISS) në vitin 2001 si një përgjigje ndaj dështimeve të bashkësisë ndërkombëtare për të parandaluar gjenocidet dhe krimet masive ndaj civilëve në vitet '90. Kjo doktrinë u përqafua zyrtarisht në Samitin Botëror të Kombeve të Bashkuara në vitin 2005, duke u kthyer në një normë të rëndësishme të rendit ndërkombëtar bashkëkohor (Thakur, 2016).

Në thelb të saj qëndrojnë tre shtylla kryesore që ripërcaktojnë marrëdhënien ndërmjet sovranitetit dhe të drejtave të njeriut: *së pari*, shtetet mbajnë përgjegjësinë parësore për të mbrojtur popullsinë e tyre nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe pastrimi etnik; *së dyti*, bashkësia ndërkombëtare ka detyrimin të ndihmojë shtetet në përmbushjen e kësaj përgjegjësie; dhe *së treti*, nëse një shtet dështon të mbrojë qytetarët e vet, bashkësia ndërkombëtare ka të drejtën dhe përgjegjësinë të ndërhyjë, duke filluar nga mjetet diplomatike e deri te përdorimi i forcës, me miratimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ky evolucion normativ përfaqëson një transformim të rëndësishëm nga koncepti tradicional i mosndërhyrjes, drejt një përgjegjësie të përbashkët për mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit njerëzor. Në këtë mënyrë, R2P përpiket të harmonizojë tensionin midis sovranitetit shtetëror dhe ndërhyrjes humanitare, duke ofruar një kuadër ligjor dhe moral për veprim ndërkombëtar (Evans, 2008; Bellamy, 2009).

Kriteret për zbatimin e R2P. Sipas raportit të Komisionit Ndërkombëtar për Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror (ICISS, 2001) dhe literaturës pasuese, për të qenë e pranueshme dhe efektive, zbatimi i doktrinës “*Responsibility to Protect*” (R2P) kërkon përmbushjen e një sërë kriteresh thelbësore. *Së pari*, shkalla e krimit duhet të jetë e tillë që të justifikojë ndërhyrjen, ajo duhet të ndodhë vetëm në prani të krimeve masive si gjenocidi, krimet kundër njerëzimit apo pastrimi etnik. *Së dyti*, qëllimi legjitim i ndërhyrjes duhet të jetë mbrojtja e civilëve, jo ndjekja e interesave politike apo gjeostrategjike të aktorëve ndërkombëtarë. *Së treti*, ndërhyrja duhet të përfaqësojë mjetin e fundit, pasi të jenë shteruar të gjitha opsionet jo-ushtarake dhe diplomatike. Po ashtu, duhet të respektohet proporcionaliteti dhe probabiliteti i suksesit, duke garantuar që ndërhyrja nuk do të përkeqësojë më tej situatën. *Së fundmi*, ndërhyrja duhet të ketë autorizim ndërkombëtar legjitim, idealisht nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, për të

shmangur veprime të njëanshme (Bellamy, 2015). Megjithëse këto kritere përfaqësojnë një standard të rëndësishëm etik dhe juridik, në praktikë ato janë interpretuar në mënyrë të ndryshme nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, shpesh në varësi të interesave politike, duke nxjerrë në pah sfidat për koherencën dhe universalitetin e zbatimit të R2P.

R2P në praktikë: rastet e analizës. a) Shqipëria, 1997 – R2P para R2P? Ndërhyrja ndërkombëtare në Shqipëri në vitin 1997 pas kolapsit të rendit publik dhe krizës së piramidave është një rast interesant i ndërhyrjes humanitare në mungesë të një doktrine të formalizuar si R2P. Misioni i udhëhequr nga Italia Operacioni "Alba" kishte si qëllim stabilizimin e vendit, evakuimin e qytetarëve të huaj dhe ruajtjen e një ambienti të sigurt për zgjedhjet. Megjithëse nuk u përdorën terminologjitë e R2P-së, disa elementë përputhen me parimet e saj: legjitimiteti ndërkombëtar (*rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1101*) dhe përpjekja për të ndalur shpërthimin e dhunës masive. Siç thekson Welsh (2019), raste si Shqipëria janë prova se konceptet qendrore të R2P ishin në zhvillim edhe përpara se të institucionalizoheshin.

Kosova, 1999 – legjitimiteti pa legalitet. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë shpesh konsiderohet një prototip i ndërhyrjes humanitare, por pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit. Krizat humanitare, dëbimi i mbi 800,000 shqiptarëve dhe pastrimi etnik i dokumentuar e bënë ndërhyrjen moralisht të justifikueshme për shumë aktorë perëndimorë. Megjithatë, mungesa e miratimit nga KS e bëri atë juridikisht të diskutueshme (Wheeler, 2000). Kosova është konsideruar nga Bellamy (2009) si katalizatori që shtyu komunitetin ndërkombëtar drejt ndërtimit të një kuadri formal si R2P. Ai vëren se ndërhyrja, megjithëse në kufijtë e legalitetit, krijoi një precedent të fortë për ndërhyrje me motiv humanitar.

Libia, 2011 – suksemi fillestar dhe dështimi në menaxhim. Ndërhyrja në Libi (2011) është rasti i vetëm ku doktrina R2P u zbatua formalisht, përmes Rezolutës 1973 të Këshillit të Sigurimit, që autorizoi forcën për mbrojtjen e civilëve nga regjimi i Gaddafit (Dunne & Gifkins, 2012). Ndërhyrja fillimisht u cilësua si sukses, por përshkallëzimi në ndërrim regjimi dhe mungesa e planit pas konfliktit çuan në humbjen e besimit nga shtete si Rusia e Kina, duke dobësuar zbatimin e R2P në kriza të mëvonshme, si Siria (Hehir, 2013).

Siria – parandalim i dështuar. Kriza në Siri, e cila filloi më 2011, ka prodhuar një ndër situatat më të rënda humanitare të shekullit XXI, me përdorimin e armëve kimike dhe dhunën masive ndaj civilëve. Megjithatë, për shkak të vetos së Rusisë dhe Kinës, Këshilli i Sigurimit ka qenë i paralizuar, duke pamundësuar ndonjë formë ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë. Sipas Art (2018), Siria përfaqëson një *dështim strukturor të R2P*, pasi legjitimiteti moral nuk ka mundur të përkthehet në veprim të organizuar për shkak të bllokadës institucionale. Ai thekson se mungesa e zbatimit të R2P në Siri ka minuar besueshmërinë e saj si normë ndërkombëtare.

Ukraina – Legjitimiteti i rremë dhe instrumentalizimi i R2P. Në pushtimin e Ukrainës më 2014 dhe përsëri më 2022, Rusia e ka përdorur retorikën e R2P për të justifikuar veprimet e saj, duke pretenduar se po mbron minoritetin rus në Donbas nga “gjenocidi” (Boon, 2022). Kjo përfaqëson një abuzim të konceptit të R2P, që ka shqetësuar analistët ndërkombëtarë për rrezikun e delegjitimitit të doktrinës. Në analizën e saj në *Journal of global security studies*, Welsh (2019) thekson se përdorimi i rremë i R2P nga Rusia e ka transformuar këtë doktrinë nga një normë mbrojtëse në një instrument të retorikës strategjike, duke rritur nevojën për standardizimin e kriterëve dhe transparencën në zbatim.

Nëse doktrina “*Responsibility to Protect*” (R2P) synon të funksionojë si një normë universale dhe e besueshme në të drejtën ndërkombëtare, ajo duhet të jetë e qëndrueshme, koherente dhe e zbatueshme në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjitha rastet. Kjo nënkupton *së pari*, kufizimin e të drejtës së vetos nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit në rastet e krimeve masive, për të shmangur bllokimin e veprimit kolektiv për arsye politike. *Së dyti*, kërkohet forcimi i kapaciteteve parandaluese, përmes diplomacisë së hershme, ndërmjetësimit dhe mbështetjes ndërkombëtare ndaj shteteve që përballen me kriza të mundshme. *Së treti*, është thelbësore ndërtimi i mekanizmave të përgjegjshmërisë, që të sigurohet se ndërhyrjet nuk devijojnë nga qëllimi i tyre humanitar dhe nuk shndërrohen në mjete për përmbysje regjimesh apo avancim interesash të caktuara (Thakur, 2016). Në literaturën më të fundit, autorë si Paris (2021) dhe Chandler (2020) theksojnë se për të mbijetuar si një doktrinë funksionale dhe e pranueshme, R2P duhet të lidhet më ngushtë me drejtësinë tranzicionale, ndërtimin e paqes dhe përfshirjen aktive të aktorëve lokalë, duke e vendosur mbrojtjen e jetës njerëzore në një kontekst më të gjerë të pajtimit, zhvillimit dhe legjitimitetit shoqëror.

R2P ka përfaqësuar një përparim të rëndësishëm në të drejtën dhe etikën ndërkombëtare, duke e zhvendosur fokusin nga ndërhyrja drejt përgjegjësisë. Megjithatë, aplikimi në praktikë ka qenë i pabarabartë dhe i ndikuar nga faktorë politikë. Rasti i Shqipërisë tregon për ekzistencën e parimeve të R2P përpara institucionalizimit; Kosova nxiti zhvillimin e doktrinës; Libia tregoi mundësinë dhe rrezikun e saj; Siria dhe Ukraina zbuluan kufizimet e saj të thella. Për të ruajtur funksionalitetin dhe integritetin, R2P duhet të riformulohet jo vetëm si mjet ndërhyrjeje, por si një pjesë e një arkitekture më të gjerë për mbrojtjen e jetës njerëzore dhe dinjitetit në nivel global.

2.8. Qasje teorike: Realizmi, Liberalizmi, Konstruktivizmi

Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare, teoritë ofrojnë lente të ndryshme për të interpretuar sjelljen e aktorëve, funksionin e institucioneve dhe zhvillimin e normave globale. Mjedisi i sigurisë është ndër më kompleksit, ku ndërthuren faktorë juridikë, politikë, ushtarakë dhe kulturorë. Duke analizuar rolin dhe ndikimin e ligjit ndërkombëtar përmes katër qasjeve të rëndësishme teorike — *realizmit, liberalizmit, konstruktivizmit dhe qasjeve kritike* — kuptojmë më thellë se si konceptualizohen ndërhyrjet ndërkombëtare, sovraniteti, dhe përgjegjësia për të mbrojtur në rastet konkrete të Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës.

Realizmi, si një nga teoritë më të vjetra dhe ndikueshme, e koncepton sistemin ndërkombëtar si anarkik, ku shtetet veprojnë në mënyrë racionale për të maksimizuar sigurinë dhe interesat e tyre kombëtare. Sipas Morgenthau (1948), ligji ndërkombëtar ka rol dytësor përballë politikës së fuqisë, pasi shtetet janë më të prirura t'i përshtatin rregullat ndërkombëtare në funksion të interesave të tyre. Në këtë kuptim, ndërhyrja e NATO-s në Kosovë më 1999 mund të shihet si një vendim strategjik i Perëndimit për të ruajtur ndikimin në Ballkan dhe për të parandaluar një destabilizim rajonal, më shumë sesa një akt humanitar. Kriza në Kosovë u zhvillua në një mjedis anarkik të krijuar pas shpërbërjes së Jugosllavisë, ku mungesa e një autoriteti shtetëror legjitim dhe funksional krijoi pasiguri ekstreme midis komuniteteve etnike. Në këtë kontekst, sipas Barry Posen (1993), komunitetet etnike operuan në kushtet e një "*dileme të sigurisë*", ku secila palë interpretonte masat mbrojtëse të palës tjetër si përgatitje për sulm, duke përshpejtuar kështu një cikël të ndërsjellë frike dhe reagimi. Ky boshllëk institucional prodhoi një ambient ku frika dhe vetëmbrojtja u transformuan në veprime të dhunshme dhe spastrime etnike, kryesisht ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Nga këndvështrimi realist, ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 interpretohet më tepër si një veprim i udhëhequr nga interesa strategjike dhe gjeopolitike të Perëndimit, sesa si një akt i motivuar thjesht nga parimet humanitare. Kjo ndërhyrje ndodhi jashtë kornizës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për shkak të kundërshtimeve dhe kërcënimeve për veto nga Rusia dhe Kina, çka nxori në pah kufizimet e mekanizmave shumëpalësh në përballje me interesat e fuqive të mëdha. Siç theksojnë Jackson dhe Sørensen: *“nëse fuqitë e mëdha nuk bien dakord për një veprim, atëherë ndoshta ai nuk duhet ndërmarrë, sepse mund të shkaktojë një konflikt mes tyre”* (Jackson & Sørensen, 2013, f. 192). Ky vlerësim tregon qartë se fuqia politike shpesh prevalon ndaj rendit ligjor ndërkombëtar, duke dëshmuar një tendencë drejt unilateralizmit kur interesat strategjike të aktorëve të fuqishëm ndihen të kërcënuara.

Po ashtu, qëndrimi i Rusisë në lidhje me Ukrainën, veçanërisht pushtimi i Krimesë më 2014 dhe agresioni i vitit 2022, mund të interpretohet si përpjekje për të ruajtur sferën e vet të influencës, duke shpërfillur të drejtën ndërkombëtare për integritet territorial (Bebler, 2015). John Mearsheimer, një nga figurat më të njohura të realizmit ofensiv, argumenton se zgjerimi i NATO-s dhe kërcënimi ndaj interesave strategjike të Rusisë në afërsi të kufijve të saj janë shkaktarët kryesorë për pushtimin e Ukrainës. Sipas tij, në një sistem anarkik ndërkombëtar, shtetet janë të detyruara të veprojnë në mënyrë racionale për të mbijetuar dhe për të ruajtur balancën e fuqisë (Mearsheimer, 2001). Mearsheimer ka shkruar se *“Ukraina është një interes jetik për Rusinë, por jo për SHBA-në,”* dhe se Perëndimi gaboi duke e shtyrë Ukrainën drejt Perëndimit (Mearsheimer, 2014).

Historiani dhe studiuesi i Evropës Qendrore dhe Lindore, Timothy Snyder, në një intervistë me Bill Kristol (2023), paraqet një analizë të thellë të luftës në Ukrainë që tejkalon një interpretim klasik të fuqisë ushtarake ose interesave gjeopolitike, dhe futet

në qasjet ideacionalo-politike dhe morale-strategjike të konfliktit. Ai e përkufizon luftën në Ukrainë si shumë më tepër se një konflikt për territor. Sipas tij, kjo luftë përfaqëson një përballje themelore mes një regjimi autoritar që manipulon të vërtetën (Rusia) dhe një shteti që përpiqet të mbijetojë si një demokraci funksionale dhe sovrane. Sipas Timothy Snyder (2023), lufta në Ukrainë duhet kuptuar si një përballje fundamentale për demokracinë, ku në thelb shtrohet pyetja nëse populli ukrainas do të jetë i lirë të vendosë vetë për të ardhmen e tij, apo nëse kjo e drejtë do t'u mohohet nga një fuqi e jashtme që kërkon të imponojë vullnetin e vet.

Nga perspektiva realistë, ndërhyrja ndërkombëtare në Shqipëri në vitin 1997 nuk ishte kryesisht një akt humanitar, por një veprim i orientuar nga interesat strategjike të fuqive evropiane për të ruajtur stabilitetin rajonal dhe për të parandaluar ndikimet negative në kufijtë e Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, Operacioni Alba synoi kontrollin e paqëndrueshmërisë në Ballkan dhe mbrojtjen e kufijve evropianë, duke reflektuar imperativin e sigurisë në një sistem anarkik ndërkombëtar, siç argumenton Waltz (1979). Gjithashtu, Krasner thekson se fuqitë e mëdha shpesh veprojnë jashtë kornizave shumëpalëshe kur interesat e tyre kombëtare janë në lojë (Krasner, 1999). Ky rast përforcon qasjen realiste duke evidentuar dominimin e interesave strategjike mbi normat humanitare në politikën ndërkombëtare.

Pra, realizmi e vë theksin te vetëpërmbajtja dhe fuqia ushtarake, duke mos i atribuar shumë besim normave juridike për ruajtjen e paqes. Ligji ndërkombëtar është, në këtë optikë, një produkt i kompromisit midis fuqive dhe shpesh shërben për të legjitimuar interesa të mëparshme të shteteve. Në kundërvënje me realizmin, liberalizmi nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, organizatave ndërkombëtare dhe normave që

burojnë nga të drejtat e njeriut. Autorë si Keohane dhe Nye (1977) theksojnë ndërvlarësinë ndërmjet shteteve dhe rritjen e rolit të institucioneve si OKB, BE apo NATO në moderimin e sjelljes së shteteve. Në këtë kuadër, ndërhyrja në Kosovë mund të interpretohet si një akt i bazuar në normat e përgjegjësisë për të mbrojtur, ku dështimi i shtetit serb për të mbrojtur popullsinë shqiptare u pa si legjitimim për ndërhyrje. Edhe në Shqipëri, përpjekja e organizatave ndërkombëtare për të rikthyer rendin dhe për të mbështetur zhvillimin institucional pas krizës së 1997 përfaqëson një aplikim të modelit liberal të sigurisë përmes ndihmës dhe bashkëpunimit shumëpalësh. Në rastin e Ukrainës, reagimi i gjerë ndërkombëtar, përfshirë sanksionet dhe mbështetjen ushtarake nga BE dhe SHBA, ilustron funksionin e institucioneve liberale për të ruajtur rendin ndërkombëtar dhe të drejtën ndërkombëtare. Liberalizmi pranon që ligji ndërkombëtar ka rëndësi praktike në sjelljen e shteteve, sepse kontribuon në krijimin e një rendi më stabil dhe më të parashikueshëm (King, 2005).

Konstruktivizmi shkon përtej interesave materiale dhe fokusohet në rëndësinë e normave, identiteteve dhe perceptimeve në formësimin e realitetit ndërkombëtar. Sipas Finnemore (2003), ndërhyrjet ndërkombëtare nuk janë vetëm rezultat i kalkulimeve strategjike, por edhe i pritshmërive dhe legjitimitetit që normat ndërkombëtare i japin veprimit. Konstruktivizmi ndihmon në shpjegimin e ndryshimeve në perceptimin ndërkombëtar të ndërhyrjes humanitare. Rasti i Kosovës ishte i rëndësishëm për krijimin e doktrinës së *R2P (Responsibility to Protect)*, pasi ndërhyrja e NATO-s, ndonëse pa autorizim të OKB-së, u perceptua gjerësisht si legjitime dhe nxiti transformimin e diskursit ndërkombëtar mbi sovranitetin dhe të drejtat e njeriut. Po ashtu, ndërhyrja në Shqipëri në 1997 ishte një formë reagimi ndaj kolapsit të rendit, por u legjitimua si ndihmë për një shtet të brishtë që përballej me anarki. Në rastin e Ukrainës, konstruktivistët do të theksonin se vetë

mënyra se si bashkësia ndërkombëtare e percepton agresionin rus (*si shkelje flagrante e normave të integritetit territorial*), ka ndikuar në formësimin e reagimit perëndimor. Po ashtu, pretendimet e Rusisë për "*mbrojtje të minoriteteve*" dhe përdorimi i gjuhës së R2P nga Kremli për të justifikuar pushtimin, sipas konstruktivistëve, janë përpjekje për të fituar legjitimitet përmes instrumentalizimit të diskursit normativ (Kuhrt, 2015).

Qasjet kritike ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ligjit ndërkombëtar, *përfshirë qasjet e botës së tretë për të drejtën ndërkombëtare (TWAIL)*, e sfidojnë legjitimitetin e rendit aktual duke e konsideruar atë si të ndërtuar mbi themele kolonialiste dhe eurocentrike. Sipas Anghie (2005), ndërhyrjet ndërkombëtare shpesh janë justifikuar nëpërmjet gjuhës së drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, por në thelb kanë shërbyer për ruajtjen e dominimit të fuqive perëndimore mbi pjesën tjetër të botës. Nga kjo perspektivë, ndërhyrja në Kosovë shihet jo thjesht si një përpjekje për të mbrojtur shqiptarët e Kosovës, por edhe si një përforcim i hegjemonisë perëndimore në Ballkan. Po ashtu, ndërhyrja në Shqipëri më 1997 mund të shihet si një akt që ruajti interesat strategjikë të Italisë dhe BE-së, më shumë sesa një ndërhyrje me natyrë neutrale.

Në rastin e Ukrainës, Rusia ka përdorur një retorikë të ngjashme me atë të qasjeve kritike, duke e paraqitur veten si kundërshtarë e hegjemonisë së NATO-s dhe si përfaqësuese e një rendi alternativ ndërkombëtar (Mankoff, 2022). Megjithatë, shumë analistë kritikë theksojnë se Rusia vetë po përdor gjuhën anti-hegjemonike për të justifikuar sjellje të ngjashme me atë që kritikon. TWAIL dhe teoritë postkoloniale theksojnë se ndërhyrjet nuk mund të kuptohen vetëm përmes retorikës humanitare apo institucionaliste, por duhen analizuar në kontekstin e strukturave të pabarazisë globale, të cilat mbeten të

ngulitura në sistemin ndërkombëtar dhe ligjin ndërkombëtar si i tillë (Seneviratne & Thilakarathna, 2020).

Rëndësia e një qasjeje teorike të ndërthurur. Rastet e Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës tregojnë se asnjë teori nuk është në gjendje të shpjegojë në mënyrë të vetme kompleksitetin e ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe ndikimin e ligjit ndërkombëtar në mjedisin e sigurisë. Realizmi ndihmon në kuptimin e kalkulimeve të fuqisë dhe interesit. Liberalizmi vë theksin në rëndësinë e institucioneve dhe normave bashkëpunuese. Konstruktivizmi ndriçon mënyrën se si perceptohen normat dhe identitetet, ndërsa qasjet kritike çojnë vëmendjen te strukturat e padrejtësisë dhe dominimit. Ndërthurja e këtyre lenteve teorike është thelbësore për një analizë gjithëpërfshirëse dhe kritike të të drejtës ndërkombëtare dhe mjedisit të sigurisë, sidomos në kontekste të brishta dhe të ndjeshme si Ballkani dhe Europa Lindore. Kjo qasje shumëdimensionale ndihmon jo vetëm në analizën e rasteve, por edhe në hartimin e politikave më efektive dhe më legjitime për menaxhimin e krizave ndërkombëtare.

Konkluzionet

Kapitulli i dytë i punimit ofron një analizë të thelluar të ligjit ndërkombëtar dhe ndërhyrjeve ndërkombëtare, si dhe teorive mbi sovranitetin, ndërhyrjen dhe legjitimitetin në kontekstin e përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky kapitull ka shërbyer si një kuadër teorik për të kuptuar sfidat dhe evoluimin e praktikave të ndërhyrjeve ndërkombëtare në periudha të ndryshme historike.

Në pjesën e parë, u diskutua evolucioni i ndërhyrjeve ndërkombëtare, i cili ka kaluar nga një përdorim i kufizuar dhe selektiv i forcës në shekujt e kaluar, në një angazhim më të gjerë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe stabilitetin ndërkombëtar. Ligji ndërkombëtar ka evoluuar gjithashtu për të përfshirë koncepte të reja, si ndërhyrjet humanitare dhe mbrojtja e civilëve, që janë bërë pjesë e rëndësishme e politikave ndërkombëtare të ndërhyrjes.

Në këtë kontekst, është e qartë se ligji ndërkombëtar luan një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e ndërhyrjeve ndërkombëtare, veçanërisht në situata që kërkojnë mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit të individëve nga abuzimet. Megjithatë, ka kritika të rëndësishme që kanë të bëjnë me efektivitetin dhe legjitimitetin e këtyre ndërhyrjeve. Disa argumentojnë se ndërhyrjet, përkundër që janë të bazuara në parime të ligjit ndërkombëtar, shpesh janë të motivuara nga interesa politike dhe gjeopolitike, duke vënë në dyshim angazhimin për të drejtat e njeriut dhe paqen globale.

Në pjesën e dytë, u shqyrtuan teoritë mbi sovranitetin, ndërhyrjen dhe legjitimitetin ndërkombëtar, duke u fokusuar në tensionin mes sovranitetit të shteteve dhe nevojës për ndërhyrje ndërkombëtare, veçanërisht në raste kur shtetet dështojnë në mbrojtjen e popujve të tyre ose shkelin të drejtat e njeriut. Teoritë kryesore, si realizmi, liberalizmi dhe konstruktivizmi, ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi përdorimin e forcës ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërmjet ligjit dhe politikës.

Realizmi thekson interesat shtetërore dhe rendin ndërkombëtar të krijuar nga fuqitë më të mëdha, ndërsa liberalizmi fokusohet në rëndësinë e institucioneve ndërkombëtare dhe bashkëpunimit multilateral. Konstruktivizmi, nga ana tjetër, sugjeron se normat dhe identitetet ndërkombëtare formojnë sjelljen e shteteve dhe aktorëve të tjerë, duke nxjerrë në pah dimensionin ideologjik dhe kulturor të ndërhyrjeve ndërkombëtare.

Doktrina e *"Përgjegjësisë për Mbrojtje"* (R2P) ka qenë një qasje e re që synon të balancojë sovranitetin e shtetit dhe mbrojtjen e individëve nga krimet më të rënda ndërkombëtare. Megjithatë, ka pasur kritika për interpretimin dhe përdorimin e kësaj doktrine, veçanërisht kur ajo është përdorur për të justifikuar ndërhyrjet që mund të kenë motive të tjera politike.

KAPITULLI III. Rast analize Shqipëria – Operacioni “Alba”

3.1. Hyrje

Kriza e vitit 1997 në Shqipëri përbën një nga rastet më domethënëse të ndërhyrjes ndërkombëtare në Europën Juglindore pas Luftës së Ftohtë, e cila u realizua në përputhje me parimet e ligjit ndërkombëtar dhe mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS). Shqipëria, në atë periudhë, u përball me një kolaps të shtetit ligjor dhe të strukturave të sigurisë për shkak të falimentimit të skemave piramidale, që shkaktuan pakënaqësi masive, dhunë të armatosur dhe një anarki të përgjithshme (Jarvis, 2000). Kjo analizë shqyrton rëndësinë e operacionit “Alba” në dy plane: *(1) ndikimin në kontekstin e brendshëm për Shqipërinë dhe (2) rëndësinë në planin ndërkombëtar për rolin që luan ligji ndërkombëtar dhe mekanizmat shumëpalësh në ndërhyrjet për menaxhimin e krizave.*

Operacioni “Alba”, i udhëhequr nga Italia dhe me përfshirjen e 11 shteteve të tjera evropiane, ishte një ndërhyrje shumëpalëshe jo nën kapakun klasik të paqeruajtjes së Kombeve të Bashkuara, por e autorizuar nga Këshilli i Sigurimit përmes *Rezolutës 1101 (1997)*. Në planin e brendshëm, ndërhyrja kishte rëndësi kritike për ruajtjen e rendit publik dhe sigurimin e ndihmës humanitare. Me rënien e shtetit dhe me policinë e shpërbërë, Shqipëria u përball me mungesë totale të kontrollit të territorit, shpërndarje të armëve dhe përplasje të armatosura që kërcënonin integritetin e vetë shtetit (Everts, 2020).

Operacioni “Alba” përfshiu rreth 7,000 trupa ndërkombëtare dhe pati një mandat të qartë: krijimin e kushteve të sigurisë për ndihmë humanitare dhe mbajtjen e zgjedhjeve të

parakohshme në verën e vitit 1997 (Koktsidis & ten Dam, 2008). Roli i këtij operacioni ishte vendimtar për ndalimin e përshkallëzimit të dhunës, rivendosjen e një forme minimale stabiliteti institucional dhe përkrahjen e tranzicionit demokratik (Gheciu, 2005). Ndërhyrja ishte gjithashtu një formë legjitime e asistencës ndaj një vendi që kërkoj ndihmë ndërkombëtare, duke përmbushur parimin e sovranitetit të kufizuar me konsensus.

Operacioni “Alba” ilustron një rast të veçantë të ndërhyrjes ndërkombëtare që harmonizon dy dimensione të rëndësishme të ligjit ndërkombëtar: *sovranitetin shtetëror dhe përgjegjësinë ndërkombëtare për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Rezoluta 1101 e KS-së* u miratua në përputhje me Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, që i jep Këshillit të Sigurimit autoritet për të marrë masa në rast kërcënimi të paqes (United Nations, 1997). Për më tepër, fakti që ndërhyrja ishte e përkohshme, me një mandat të kufizuar dhe me kërkesë nga vetë autoritetet shqiptare, forcoi aspektin e legalitetit në bazë të parimit të respektimit të sovranitetit dhe pëlqimit të shtetit pritës (Chesterman, 2002). Ky kombinim i pëlqimit të shtetit dhe autorizimit nga Këshilli i Sigurimit krijoi një bazë të fortë ligjore që shmangu kritikën për shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe e diferencoi këtë ndërhyrje nga ndërhyrje të njëanshme apo jolegjitime.

Rëndësia e operacionit “Alba” në planin ndërkombëtar qëndron në faktin që ai tregoi funksionimin efektiv të sistemit të sigurisë kolektive të parashikuar nga Karta e OKB-së. Këshilli i Sigurimit, megjithëse nuk dërgoi forca paqeruajtëse klasike të OKB-së, përdori instrumentin e autorizimit të një koalicioni të përkohshëm të vendeve anëtare për të vepruar në mënyrë të koordinuar. Ky model u ripërdor në raste të mëvonshme si Kosova

(1999) dhe Libia (2011) (Thakur, 2016). Operacioni “Alba” mund të konsiderohet si një formë ndërhyrjeje humanitare, edhe pse nuk u shpall si e tillë, pasi kishte për qëllim mbrojtjen e popullsisë nga pasojat e rendit të shkatërruar dhe garantimin e ndihmës humanitare. Për më tepër, ai krijoi një precedent për rastet ku ndërhyrjet e drejtuara nga shtete të treta mund të marrin legjitimitet përmes mekanizmave të OKB-së, duke ruajtur ekuilibrin midis sovranitetit dhe përgjegjësisë ndërkombëtare (Bellamy, 2008).

Operacioni “Alba” pati gjithashtu një efekt të dukshëm në rajon. Stabilizimi i Shqipërisë ishte jetik për sigurinë e Ballkanit Perëndimor, i cili në atë periudhë po përjetonte konflikte të rënda në Bosnjë dhe më vonë në Kosovë. Destabilizimi i Shqipërisë do të kishte krijuar pasoja zinxhir në rajon, përfshirë rritjen e trafikeve ilegale, flukseve të refugjatëve dhe konflikteve etnike (Kritsiotis, 2000). Ndërhyrja e koordinuar dhe jo e njëanshme dërgoi gjithashtu një mesazh të rëndësishëm për mekanizmat ndërkombëtarë të sigurisë: se ekzistonte vullnet politik për të parandaluar përshkallëzimin e krizave edhe jashtë skenarëve klasikë të luftës, duke përdorur mjetet e ligjit ndërkombëtar dhe bashkëpunimit shumëpalësh. Operacioni “Alba” është një shembull i hershëm i zbatimit praktik të parimeve që më vonë u përfshinë në konceptin e *Responsibility to Protect* (R2P), që u formalizua pas Samitit të Kombeve të Bashkuara në vitin 2005 (Evans & Sahnoun, 2002).

Rasti i Shqipërisë në vitin 1997 tregon se ndërhyrjet ndërkombëtare të legjitimuara përmes Këshillit të Sigurimit mund të jenë efektive edhe në mungesë të një konflikti të hapur civil ose luftërash ndërkombëtare. Ndihma në ndërtimin e strukturave bazë të rendit dhe krijimi i një klime për zgjedhje të lira është një formë proaktive e paqeruajtjes që

duhet të promovohet edhe në kontekste të tjera të ngjashme. Kjo qasje ilustron që ligji ndërkombëtar nuk është vetëm një mekanizëm ndëshkues, por një mjet për parandalim, ndërtim paqeje dhe mbrojtje të rendit global.

Operacioni “Alba” përforcoi gjithashtu idenë se ndërhyrja e huaj, kur është e koordinuar dhe e mbështetur nga mekanizmat ndërkombëtarë, nuk përbën shkelje të sovranitetit, por një formë të bashkëpunimit për ndihmë emergjente. Shqipëria, më pas, zhvilloi marrëdhënie të forta me organizatat ndërkombëtare dhe avancoi në drejtim të anëtarësimit në NATO dhe BE, duke treguar se ndërhyrja nuk dëmtoi, por përkundrazi forcoi integritetin dhe aspiratat e saj ndërkombëtare ((Phillips & Peci, 2018).

Operacioni “Alba” është një shembull praktik i efektivitetit të ligjit ndërkombëtar dhe mekanizmave shumëpalësh në ndërhyrjet për menaxhimin e krizave. Ai tregoi se me pëlqimin e shtetit pritës dhe me autorizimin nga Këshilli i Sigurimit, ndërhyrjet ndërkombëtare mund të jenë legjitime, efektive dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Në planin e brendshëm, operacioni riktheu stabilitetin dhe i hapi rrugën reformave demokratike në Shqipëri. Në planin ndërkombëtar, ai krijoi një precedent pozitiv për ndërhyrje të përkohshme, të koordinuara dhe të bazuara në solidaritetin ndërkombëtar. Rasti i Shqipërisë më 1997 mbetet një pikë referimi për analizën e ndërhyrjeve të ardhshme në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

3.2. Konteksti i krizës, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm

Në vitin 1997, Shqipëria u përball me një kolaps ekonomik të paprecedentë të shkaktuar

nga rënia e skemave piramidale, që përfshinte humbje masive të kursimeve të qytetarëve. Kjo situatë rezultoi në protesta masive, trazira dhe shpërbërje të institucioneve shtetërore, duke e lënë vendin pa një qeverisje të qëndrueshme. Kjo krizë kërkonte një ndërhyrje të menjëhershme për të shmangur përshkallëzimin e situatës në një konflikt të gjerë civil. Ndërhyrja ndërkombëtare përmes Operacionit “Alba”, i udhëhequr nga Italia dhe e mbështetur nga një koalicion ndërkombëtar, u realizua nën një mandat të Kombeve të Bashkuara, duke treguar rolin e rëndësishëm të KS-së në autorizimin e ndërhyrjeve për qëllime stabilizimi. *Rezoluta 1101* e Këshillit të Sigurimit e miratuar më 28 mars 1997 autorizoi vendosjen e një force shumëkombëshe për të krijuar një mjedis të sigurt për ndihmën humanitare dhe për të kontribuar në rivendosjen e rendit publik (United Nations Security Council, 1997). Ky veprim i Këshillit të Sigurimit ilustron rëndësinë e legjitimitetit të ndërhyrjeve ndërkombëtare nën dritën e të drejtës ndërkombëtare, duke siguruar që veprimet ndërkombëtare të mbështeten në baza të qarta juridike dhe mandat ndërkombëtar.

Në kuadër të ligjit ndërkombëtar, ndërhyrja në Shqipëri përfaqëson një model të ndërhyrjeve humanitare në kriza të brendshme, ku bashkësia ndërkombëtare synon të ndihmojë një vend në kaos. Sipas Del Boca (1997), Operacioni “Alba” kishte një qëllim humanitar të qartë, duke parandaluar përkeqësimin e situatës së popullsisë civile dhe duke krijuar një stabilitet minimal për zgjidhjen e krizës. Ndërhyrja ishte e përkohshme dhe me mandate të përcaktuara për të shmangur perceptimin e okupimit ndërkombëtar. Caplan (2005) thekson rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe koordinimit me aktorët lokalë për suksesin e operacionit. Ndërsa Këshilli i Sigurimit siguroi legjitimitetin ndërkombëtar, veprimet e koordinuara shumëpalëshe ishin kyçe për stabilizimin e

situatës.

Ndërhyrja në Shqipëri pati gjithashtu implikime të rëndësishme për stabilitetin rajonal. Ballkani në atë periudhë ishte një rajon i ndjeshëm për shkak të konflikteve në ish-Jugosllavi dhe situatave të tjera të tensionuara. Operacioni “Alba” shërbeu si një shembull për përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të parandaluar përhapjen e krizës në vendet fqinje dhe për të siguruar që trazirat të mos përkeqësonin situatën e brendshme në vendet e tjera të rajonit. Judah (2009) argumenton se ndërhyrja ishte e nevojshme për të garantuar stabilitetin rajonal dhe për të treguar aftësinë e komunitetit ndërkombëtar për të vepruar në situata krize në një rajon me sfida të ndërlikuara politike.

Analiza e ndërhyrjes në Shqipëri dhe rolit të KS-së ofron disa mësimet të rëndësishme për menaxhimin e krizave rajonale. *Së pari*, legjitimiteti ndërkombëtar dhe korniza ligjore janë të domosdoshme për të siguruar që ndërhyrjet të jenë të mbështetura në mënyrë të drejtë dhe efektive. *Së dyti*, ndërhyrjet ndërkombëtare duhet të jenë të mirëkoordinuara dhe të kufizuara në kohë për të shmangur krijimin e varësisë ose tensioneve të reja në vendet e ndikuara. Megjithatë, përpjekjet ndërkombëtare duhet të shoqërohen me angazhim të brendshëm për reforma dhe rindërtim të institucioneve vendase për të garantuar qëndrueshmërinë (Marchio, 2000).

Pra, Operacioni “Alba” në Shqipëri përfaqëson një shembull të rëndësishëm të rolit të ligjit ndërkombëtar dhe të Këshillit të Sigurimit në menaxhimin e krizave rajonale. Përmes ndërhyrjes së autorizuar ndërkombëtarisht, Shqipëria përfitoi një mundësi për të rikthyer rendin dhe për të adresuar krizën e saj më të thellë. Ky rast studimor thekson rëndësinë e një qasjeje të koordinuar dhe të mbështetur në korniza ligjore për të siguruar

që ndërhyrjet ndërkombëtare të jenë efektive dhe të qëndrueshme.

Kriza e vitit 1997 në Shqipëri përfaqëson një nga periudhat më të vështira pas rënies së regjimit komunist, shkaktuar nga kolapsi i skemave piramidale që shkaktuan humbjen e kursimeve të shumë qytetarëve. Pasojat përfshinë destabilizim politik e social, kolaps të rendit dhe një vakum të sigurisë. Pettifer dhe Vickers (2007) e përshkruajnë krizën si një kolaps institucional që çoi në humbjen e autoritetit shtetëror dhe nevojën për ndërhyrje ndërkombëtare për të parandaluar luftën civile. Kriza rrjedh nga një kombinim faktorësh të brendshëm si korrupsioni, keq menaxhimi ekonomik dhe institucione të dobëta, si dhe ndikime rajonale dhe ndërkombëtare që përkeqësuan situatën.

Në këtë kontekst, Operacioni “Alba” u zhvillua si një mision shumëkombësh i udhëhequr nga Italia për të rivendosur rendin në Shqipëri. *Rezoluta 1101 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1997)* krijoi bazën ligjore për këtë ndërhyrje, duke autorizuar një forcë ndërkombëtare për të krijuar kushtet e nevojshme për shpërndarjen e ndihmave humanitare dhe stabilizimin e situatës. Për Shqipërinë, ky operacion shënoi një kthesë në përballjen me krizat dhe një shembull për menaxhimin e krizave përmes një qasjeje ndërkombëtare (Tripodi, 2002).

Në vitet 1990, ekonomia shqiptare ishte në një periudhë të tranzicionit të ashpër nga një sistem komunist në një treg të lirë. Skemat piramidale u bënë një nga mjetet kryesore për shqiptarët për të investuar kursimet e tyre në një treg të pamaturuar dhe të dobët. Jarvis (2000) përshkruan mënyrën sesi skemat piramidale, të stimuluar nga mungesa e rregullimit financiar dhe një sistem bankar të dobët, tërhoqën shumicën e popullsisë drejt

rrezikut të pasigurt financiar. Kolapsi i këtyre skemave në fillim të vitit 1997 rezultoi në humbje të konsiderueshme për rreth dy të tretat e popullsisë dhe shpërthimin e protestave masive.

Pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria nuk arriti të krijonte institucione të qëndrueshme shtetërore. Fischer (2007) thekson se qeveria e Sali Berishës dështoi të menaxhonte krizën, duke shkaktuar përshkallëzim të dhunës dhe rrëzim të autoriteteve në shumë zona. Forcat e sigurisë u shpërbënë dhe u krijua një vakum pushteti që favorizoi shpërndarjen e armëve. Klima politike ishte shumë e polarizuar, ku Partia Demokratike dhe Socialiste ishin në konflikt të fortë, ndërsa Vickers (2008) vëren se opozita dhe grupet e armatosura përdorën krizën për të shtuar presionin ndaj qeverisë.

Në vitet '90, rajoni i Ballkanit ishte i përfshirë në tensione etnike dhe konflikte të armatosura që ndikuan edhe Shqipërinë, sidomos për shkak të luftës në Bosnjë (1992-1995) dhe krizës në Kosovë, duke krijuar një ambient të pasigurt rajonal (Gowan & Korski, 2011). Glenny (1999) nënvizon se mungesa e stabilitetit në Ballkan rriti shqetësimet për pasiguri edhe në Shqipëri. Komuniteti ndërkombëtar nënvlerësoi krizën shqiptare deri në 1997, kur pas përkeqësimit të situatës, BE dhe OSBE ndërhyjnë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën për Operacionin “Alba”, një mision shumëkombësh i udhëhequr nga Italia për stabilizimin dhe ndihmën humanitare (UNSC, 1997).

Qeveria e presidentit Berisha ishte aktori kryesor i brendshëm, por ajo dështoi të trajtonte në mënyrë efektive krizën. Në vend që të qetësonte situatën, politikat e qeverisë, veçanërisht refuzimi për të rimbursuar humbjet e popullsisë, përshkallëzuan tensionet. Qeveria gjithashtu u akuzua për mbështetjen e skemave piramidale, çka minoi besimin e

publikut (Ministry of Defence, 1997).

Partia Socialiste e Shqipërisë, e udhëhequr nga Fatos Nano dhe Rexhep Meidani, luajti një rol të rëndësishëm gjatë krizës. Opozita mobilizoi një pjesë të popullsisë kundër qeverisë dhe kërkoi rrëzimin e saj. Shumë grupe të armatosura që vepronin në zona të ndryshme të Shqipërisë u identifikuan me opozitën dhe shpesh herë këto grupe kontrolluan pjesë të vendit jashtë kontrollit të qeverisë (Chiclet, 1998).

Operacioni “Alba”, i udhëhequr nga Italia me miratimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, përfshiu rreth 7,000 trupa nga 11 vende të ndryshme. Roli i këtyre forcave ishte rivendosja e rendit dhe sigurimi i mbrojtjes për ndihmat humanitare. Del Boca (2001) e cilëson këtë ndërhyrje si një rast suksesi të bashkëpunimit ndërkombëtar në një krizë humanitare në një vend të vogël. Faktorët e brendshëm si kolapsi ekonomik, polarizimi politik dhe dobësia institucionale, së bashku me ndikimet e jashtme nga konfliktet rajonale dhe mungesa fillestare e reagimit ndërkombëtar, kontribuan në shpërthimin e krizës së vitit 1997 në Shqipëri. Aktorët kryesorë përfshinin qeverinë dhe opozitën shqiptare, ndërsa forcat ndërkombëtare dhe organizatat rajonale u detyruan të ndërhyjnë për të shmangur një përshkallëzim të mëtejshëm të dhunës (Del Boca, 2001).

3.3. Korniza ligjore ndërkombëtare

Menaxhimi i krizës së vitit 1997 në Shqipëri u zhvillua në një kontekst të ndërlikuar të marrëdhënieve ndërkombëtare, ku faktorë politikë, strategjikë dhe humanitarë ndërthureshin. Korniza ligjore dhe politike për ndërhyrjen ndërkombëtare u bazua kryesisht në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS-OKB-së) dhe

në bashkëpunimin midis shteteve të interesuara, të cilat vepronin për të rivendosur rendin dhe për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të krizës në Ballkan (Thanasi & Riotto, 2017).

Korniza ndërkombëtare për menaxhimin e krizës në Shqipëri u bazua në disa konventa dhe rezoluta kyçe. *Rezoluta Nr. 1101* e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1997) autorizoi operacionin “Alba” sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, duke lejuar përdorimin e forcës për rivendosjen e rendit dhe sigurimin e ndihmave humanitare (United Nations, 1997). Ky operacion tregoi bashkëpunimin ndërkombëtar për ndërhyrje humanitare dhe stabilizuese. Gjithashtu, Marrëveshjet e Helsinkit (1975) dhe angazhimet e BE-së dhe OSBE-së nënvizuan rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut dhe stabilitetit rajonal (Encyclopaedia Britannica, n.d.). Orford (2011) thekson se ndërhyrjet ndërkombëtare shpesh kombinojnë ligjin humanitar dhe të drejtën për të drejtat e njeriut, si në rastin e “Alba”-s.

Ndërsa kriza u përshkallëzua me shpejtësi, destabilizimi i Shqipërisë krijoi një situatë humanitare të rëndë dhe kërcënim të rëndësishëm për stabilitetin rajonal në Ballkan, që tashmë ishte i ndjeshëm për shkak të luftërave në Bosnjë dhe tensioneve në Kosovë (Binder, 2017). Del Boca (2001) thekson se ndërkombëtarët ishin të shqetësuar se kaosi në Shqipëri mund të shpërndahej përtej kufijve të saj, duke përkeqësuar situatën në një rajon të përçarë. Si rezultat, Komuniteti Ndërkombëtar e pa të nevojshme të veprojë me urgjencë për të shmangur një përshkallëzim të mëtejshëm të dhunës dhe për të rivendosur stabilitetin.

Shqipëria kishte një rëndësi strategjike për Italinë dhe Bashkimin Evropian. Për Italinë, e cila ishte më pranë gjeografikisht dhe ishte e përballur me një fluks të madh refugjatësh, stabiliteti i Shqipërisë ishte një prioritet kombëtar. Ugolini (2002) tregon se interesat italiane për të ndërhyrë shtriheshin përtej çështjeve humanitare dhe përfshinin edhe ndalimin e valës së emigracionit të paligjshëm dhe ruajtjen e sigurisë në Mesdhe.

Një ndërhyrje ushtarake e cila mund të garantonte sigurinë dhe rendin në Shqipëri kërkonte një bazë të fortë ligjore. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara u bë aktori kryesor për legjitimimin e ndërhyrjes përmes Rezolutës 1101 të miratuar më 28 mars 1997. Kjo rezolutë i dha OKB-së mandatin për të mbështetur një ndërhyrje shumëkombëshe me qëllim stabilizimin e vendit dhe garantimin e shpërndarjes së ndihmave humanitare (United Nations Security Council, 1997). Ky ishte një element kyç për të mbështetur ndërhyrjen nga ana ligjore dhe për të siguruar bashkëpunimin e komunitetit ndërkombëtar.

Italia ishte shteti më aktiv në menaxhimin e krizës shqiptare, duke marrë kryesimin e Operacionit “Alba”. Italia kishte interesa të shumta në ruajtjen e stabilitetit në Shqipëri, duke përfshirë parandalimin e emigracionit masiv dhe përballjen me pasigurinë në rajon. Lucarelli (2000) përshkruan se përveç arsyeve humanitare, Italia kërkonte të mbronte interesat e saj strategjike në Mesdhe dhe të forconte pozitat e saj si një aktor kyç në Ballkan. Italia organizoi një forcë shumëkombëshe prej rreth 7,000 trupash nga 11 vende të ndryshme, të cilat u dërguan për të mbështetur rivendosjen e rendit.

OSBE luajti një rol thelbësor në monitorimin e situatës dhe organizimin e zgjedhjeve të

reja pas krizës. Ajo kontribuoi në përpjekjet për demokratizimin dhe mbështetjen e institucioneve shqiptare për të ndihmuar në rikthimin e stabilitetit. Organizata kishte një mandat për të promovuar dialogun politik midis partive shqiptare dhe për të mbështetur proceset demokratike (Ağır & Gürsoy, 2019).

Ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës megjithëse nuk luajtën një rol udhëheqës në operacionin, ato mbështetën fuqimisht ndërhyrjen shumëkombëshe përmes OSBE-së dhe Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Për SHBA-në, Shqipëria përbënte një pikë strategjike në ruajtjen e sigurisë në Evropën Juglindore. Mbështetja ndaj operacionit ishte në përputhje me interesat e saj për stabilitet rajonal dhe forcimin e institucioneve demokratike në vendet e Ballkanit (United Nations Security Council, 1997).

Pavarësisht bashkëpunimit në Operacionin “Alba”, Italia dhe Greqia kishin tensione të heshtura për shkak të qëndrimeve të ndryshme mbi rolin e Shqipërisë dhe çështjen e minoritetit grek (Cela et al., 2008). Italia ishte udhëheqëse ushtarake e operacionit, ndërsa Franca dhe Gjermania u angazhuan më shumë në mbështetje për rindërtimin dhe stabilizimin afatgjatë, duke ofruar ndihma humanitare dhe ushtruar presion diplomatik për reforma në Shqipëri (Wagstaff, 2000).

Pra, ndërhyrja ndërkombëtare në Shqipëri në vitin 1997 u zhvillua në një mjedis kompleks politik dhe strategjik, ku faktorë të ndryshëm – *humanitarë, strategjikë dhe ligjorë* – ndërlidheshin për të përcaktuar urgjencën dhe dinamikën e krizës. Italia udhëhoqi operacionin me mbështetjen e gjerë të komunitetit ndërkombëtar, ndërsa Këshilli i Sigurimit i OKB-së ofroi bazën ligjore për ndërhyrjen. Aktorët si OSBE-ja dhe Bashkimi

Evropian kontribuan në menaxhimin e krizës përmes angazhimit diplomatik dhe monitorimit të zgjedhjeve të reja, duke sjellë një ndërhyrje shumëpalëshe me rezultate pozitive për stabilizimin e vendit(United Nations, 2007).

3.4. Dinamika, rezultatet dhe ndikimi

Operacioni “Alba” doli të jetë një sukses në aspektin e stabilizimit të situatës në Shqipëri. Brenda një periudhe të shkurtër kohore, forcat ndërkombëtare arritën të sigurojnë portet dhe infrastrukturën e nevojshme për shpërndarjen e ndihmave humanitare dhe të rivendosin rendin publik në disa qytete kyçe. Bellamy and Williams (2010) e konsiderojnë këtë ndërhyrje një shembull të mirë të diplomacisë preventive dhe ndërhyrjeve të shpejta për parandalimin e konflikteve më të mëdha, duke përmendur faktin se ndërhyrja e koordinuar ndërkombëtare shpëtoi Shqipërinë nga një përkeqësim i mëtejshëm i krizës.

Nga ana tjetër, operacioni nxori në pah sfidat me të cilat përballen forcat ndërkombëtare në situata të tilla, përfshirë mungesën e bashkërendimit mes aktorëve dhe vështirësitë logjistike në terren. Megjithatë, Luck (2006) argumenton se bashkëpunimi i ngushtë mes Kombeve të Bashkuara, OSBE-së dhe Bashkimit Evropian tregoi rëndësinë e angazhimit ndërkombëtar për të siguruar një tranzicion paqësor dhe për të parandaluar kthimin e Shqipërisë në kaos.

Rezultatet e operacionit “Alba” kishin një ndikim afatgjatë për Shqipërinë, duke ndihmuar në rikthimin e institucioneve shtetërore dhe në krijimin e kushteve për reforma më të thella politike dhe ekonomike. Falk (2000) nënvizon rëndësinë e këtij operacioni si

një shembull i suksesshëm i menaxhimit të krizave në një vend të vogël, duke demonstruar se ndërhyrjet shumëpalëshe mund të jenë të suksesshme kur ato janë të mirëkoordinuara dhe kanë mbështetje të gjerë ndërkombëtare.

Pra, Operacioni “Alba” në Shqipëri është një shembull domethënës i mënyrës sesi ligji ndërkombëtar mund të mobilizohet për të adresuar krizat në një vend të vogël. Përmes një ndërhyrje të udhëhequr nga Italia dhe e mbështetur nga Kombet e Bashkuara, Shqipëria arriti të stabilizohej pas një periudhe të rëndë krizash. Korniza ligjore dhe politike që u përdor në këtë rast tregon rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në menaxhimin e krizave, duke mbështetur vendet në nevojë përmes strukturave të mirë organizuara ligjore dhe diplomatike (Marchio, 2000).

Ndërhyrja ndërkombëtare në Shqipëri gjatë krizës së vitit 1997, e njohur si Operacioni “Alba”, u zhvillua në një periudhë kaotike për vendin, ku strukturat e sigurisë ishin shpërbërë dhe rendi publik ishte zhdukur plotësisht. Ky operacion, i udhëhequr nga Italia dhe i përkrahur nga një koalicion shumëkombësh, kishte për qëllim stabilizimin e vendit dhe mbështetjen për organizimin e zgjedhjeve të reja. Analiza e dinamikës së këtij operacioni, forcave të angazhuara dhe ndikimeve afatgjata tregon një proces kompleks të menaxhimit të krizës me rezultate të rëndësishme për stabilizimin e Shqipërisë (Kostakos, & Bourantonis, 1998).

Operacioni “Alba” zgjati rreth katër muaj, nga prilli deri në gusht të vitit 1997. *Rezoluta 1101 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (28 mars 1997)* i dha bazën ligjore ndërhyrjes ndërkombëtare, duke autorizuar një forcë shumëkombëshe për të rivendosur

rendin dhe sigurinë në Shqipëri. Në total, operacioni përfshiu rreth 7,000 trupa, kryesisht nga Italia, por gjithashtu nga Franca, Spanja, Turqia, Greqia, Rumania dhe disa vende të tjera. Italia ishte lideri i operacionit, duke dërguar pjesën më të madhe të trupave dhe duke koordinuar aktivitetet operacionale (United Nations Security Council, 1997).

Operacioni “Alba” kishte përparësi të rivendoste sigurinë në qytetet kryesore të Shqipërisë, ku kaosi dhe dhuna kishin shpërthyer në mënyrë të pandalshme. Forcat ndërkombëtare arritën të siguronin ndihmat humanitare dhe të ndalonin më tej përhapjen e dhunës në veri të vendit, ku disa grupe të armatosura kishin krijuar zona të vetëqeverisura (Kubicek, 1998).

Një nga sfidat më të mëdha që përballuan forcat ndërkombëtare ishte mungesa e plotë e institucioneve të sigurisë të Shqipërisë. Policia dhe ushtria shqiptare ishin pothuajse të shpërbëra si pasojë e rebelimit popullor dhe kolapsit të strukturave shtetërore. Lucarelli (2000) vë në dukje se forcat ndërkombëtare shpesh herë përballeshin me kaosin në terren dhe nuk kishin një partner të besueshëm në qeverinë shqiptare për të koordinuar përpjekjet e stabilizimit. Kjo bëri që ndërhyrja të përqendrohej kryesisht në sigurimin e infrastrukturës kritike dhe garantimin e ndihmës humanitare.

Operacioni “Alba” arriti të sigurojë një nivel të qëndrueshëm sigurie deri në organizimin e zgjedhjeve parlamentare në qershor 1997, të cilat sollën në pushtet një qeveri të re nën drejtimin e Partisë Socialiste të Shqipërisë. Ndërhyrja u konsiderua një sukses për shkak të rikthimit të rendit në disa zona kyçe dhe krijimit të kushteve për një proces demokratik (Beehner, 2007). Megjithatë, stabiliteti i plotë ishte një proces i ngadalshëm dhe kërkonte

vite për të konsoliduar institucionet.

Një tjetër rezultat i rëndësishëm i ndërhyrjes ishte garantimi i shpërndarjes së ndihmave humanitare. Për shkak të krizës ekonomike dhe bankare, shumë qytetarë shqiptarë kishin humbur kursimet dhe ishin përballur me kushte të vështira jetese. Forcat ndërkombëtare ndihmuan në sigurimin e ushqimit dhe shërbimeve bazë për popullsinë. Për më tepër, Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare ofruan fonde për rindërtimin e infrastrukturës dhe për rimëkëmbjen e ekonomisë (Kubicek, 1998).

Ndërhyrja ndërkombëtare e bëri të qartë se institucionet shqiptare të sigurisë ishin tejet të dobëta dhe të paafta për të përballuar një krizë të brendshme. Pas përfundimit të Operacionit “Alba”, qeveria shqiptare mori masa për të reformuar policinë dhe ushtrinë, me mbështetjen e OSBE-së dhe NATO-s. Këto reforma ishin kritike për forcimin e kapacitetit të vendit për të ruajtur rendin në të ardhmen (Tripodi, 2002).

Operacioni “Alba” kishte ndikime të mëdha edhe në rajonin më të gjerë të Ballkanit. Stabilizimi i Shqipërisë ndihmoi në zbutjen e tensioneve në Kosovë dhe në rajonet përreth, duke penguar përhapjen e dhunës në një kohë kur rajoni ishte tashmë i destabilizuar nga luftërat në ish-Jugosllavi. Wagstaff (2000) përmend se ndërhyrja ishte një shembull i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin e përshkallëzimit të krizave rajonale.

Një nga mësimet kryesore të nxjerra nga Operacioni “Alba” ishte rëndësia e ndërhyrjes së koordinuar shumëkombëshe për të përballuar krizat në vendet e vogla dhe të dobëta.

Lucarelli (2000) thekson se pa një ndërhyrje të tillë, Shqipëria do të ishte përballur me një shpërbërje të mëtejshme dhe mund të ishte kthyer në një shtet i dështuar. Gjithashtu, operacioni tregoi rëndësinë e krijimit të një kornize ligjore dhe politike të fortë, e cila siguronte legjitimitetin dhe mbështetjen ndërkombëtare për ndërhyrjen.

Ndërhyrja ndërkombëtare ndihmuan Shqipërinë të kapërcejë një nga periudhat më të errëta të historisë së saj moderne dhe të vendoset në rrugën e integritit në Bashkimin Evropian dhe NATO. Kjo ndërhyrje shërbeu si një pikë kthesë për vendin, duke krijuar një bazë për reforma më të thella politike dhe institucionale. Siç vëren Del Boca (2001), ky operacion hapi rrugën për rritjen e angazhimit ndërkombëtar në Shqipëri, si dhe për integrimin më të thellë të vendit në strukturat perëndimore.

Pra, Operacioni “Alba” ishte një ndërhyrje shumëkombëshe komplekse që u zhvillua në një kontekst të paqëndrueshëm politik dhe social në Shqipëri. Ndërhyrja arriti të stabilizojë vendin për një periudhë afatshkurtër, duke siguruar ndihma humanitare dhe duke krijuar kushtet për rikthimin e rendit publik. Në të njëjtën kohë, operacioni nxori në pah dobësitë e institucioneve shqiptare dhe nevojën për reforma të thella në sektorin e sigurisë. Mësimet e nxjerra nga ky operacion vazhdojnë të jenë relevante për menaxhimin e krizave në kontekstin ndërkombëtar dhe tregojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për stabilizimin e vendeve të vogla dhe të brishta.

3.5. Ligji ndërkombëtar në kriza të brendshme

Ligji ndërkombëtar luan një rol jetik në menaxhimin e krizave të brendshme, veçanërisht

për vendet e vogla që janë shpesh më të prekshme nga destabilizimi i brendshëm dhe ndikimet e jashtme. Operacioni “Alba” në Shqipëri gjatë krizës së vitit 1997 ofron një rast studimi të vlefshëm për të analizuar se si ligji ndërkombëtar mund të zbatohet në një krizë të brendshme dhe cilat janë sfidat dhe mësimet kryesore të nxjerra nga kjo përvojë (Tripodi, 2002).

Një nga sfidat kryesore për vendet e vogla është ruajtja e sovranitetit të tyre në kontekstin e ndërhyrjeve ndërkombëtare. Operacioni “Alba” u autorizua nga Kombet e Bashkuara, por ai u krye nga një koalicion i shteteve të huaja, ku Italia luante rolin kryesor. Për vende të vogla si Shqipëria, kjo lloj ndërhyrjeje ngre pyetje për kufijtë e sovranitetit kombëtar, pasi autoritetet e vendit shpesh kanë pak fuqi ose kontroll mbi mënyrën se si zbatohet ndërhyrja ndërkombëtare. Për më tepër, ndërhyrja e huaj ndonjëherë mund të shihet si ndërhyrje në punët e brendshme të një shteti, duke krijuar tensione politike dhe juridike (Greco, 1998).

Në raste si Operacioni “Alba”, një sfidë tjetër është menaxhimi i interesave të ndryshme ndërkombëtare. Ndërhyrjet shumëkombëshe, edhe pse të mbështetura nga ligji ndërkombëtar, përfshijnë një sërë aktorësh me interesa të ndryshme gjeopolitike. Në rastin e Shqipërisë, Italia, Franca, Turqia, dhe shtetet e tjera pjesëmarrëse kishin interesa specifike në stabilitetin e rajonit, çka mund të ndikonte në mënyrën e menaxhimit të operacionit. Përplasjet e mundshme të interesave ndërkombëtare shpesh mund të minojnë kohezionin e përpjekjeve ndërkombëtare për menaxhimin e krizave (Crocì, 2000).

Në kontekstin e vendeve të vogla si Shqipëria, një sfidë e rëndësishme është dobësia e

institucioneve kombëtare për të zbatuar ligjin ndërkombëtar dhe për të menaxhuar krizën në mënyrë të pavarur. Shqipëria në vitin 1997 kishte institucione të dobëta dhe të disfunksionalizuara si rezultat i trazirave politike dhe ekonomike, dhe mungesa e rendit bëri që ndërhyrja ndërkombëtare të ishte e domosdoshme. Për vendet e vogla, kjo tregon se një nga sfidat më të mëdha është ndërtimi dhe forcimi i institucioneve të brendshme që mund të përballojnë dhe të menaxhojnë krizat pa varësi të plotë nga ndihma ndërkombëtare (Jarvis, 2000).

3.6. Roli i ligjit ndërkombëtar në legjitimimin e ndërhyrjes

Një nga çështjet kryesore të nxjerra nga Operacioni “Alba” është se ndërhyrjet ndërkombëtare në vendet e vogla janë më efektive dhe të pranueshme kur bazohen në ligjin ndërkombëtar. *Rezoluta 1101 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara* ishte një mjet kyç për legjitimimin e ndërhyrjes dhe sigurimin e mbështetjes ndërkombëtare për operacionin. Kjo tregon rëndësinë e krijimit të një kornize të qartë ligjore për ndërhyrjet, që siguron jo vetëm legjitimitet por edhe koherencë në zbatimin e politikave ndërkombëtare (Greco, 1998).

Një tjetër çështje e rëndësishme është rëndësia e koordinimit ndërkombëtar efektiv. Operacioni “Alba” tregoi se ndërhyrjet shumëkombëshe mund të jenë të suksesshme nëse ka një udhëheqje të fortë dhe një strategji të qartë për menaxhimin e krizës. Italia, si udhëheqëse e operacionit, arriti të koordinojë vendet pjesëmarrëse dhe të sigurojë një strukturë të qartë komandimi, duke minimizuar përplasjet e mundshme të interesave dhe duke garantuar që qëllimet e ndërhyrjes ishin të qarta për të gjithë aktorët (United Nations,

1997).

Ndërhyrja në Shqipëri tregoi se stabilizimi afatgjatë i vendeve të vogla kërkon më shumë sesa vetëm ndërhyrje të përkohshme ushtarake. Pas përfundimit të Operacionit “Alba”, Shqipëria hyri në një periudhë reformash të gjera në sektorin e sigurisë dhe të drejtësisë. Kjo tregoi se ndërhyrjet ndërkombëtare duhet të shoqërohen me mbështetje për reforma të thella politike dhe institucionale për të siguruar që vendet e vogla të mund të qëndrojnë të qëndrueshme dhe të mos kthehen në kriza të ngjashme në të ardhmen (Kubicek, 1998).

Operacioni “Alba” tregoi se ndërhyrjet ndërkombëtare në vende të vogla dhe të dobëta mund të jenë të suksesshme nëse ndërmerren shpejt dhe nëse kanë një fokus të qartë humanitar dhe të stabilizimit politik. Megjithatë, përvoja e Shqipërisë tregoi gjithashtu se ndërhyrjet duhet të jenë të përqendruara në parandalimin e përshkallëzimit të krizave dhe në krijimin e institucioneve të qëndrueshme që mund të mbajnë rendin edhe pas tërheqjes së trupave ndërkombëtare.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm nga Operacioni “Alba” është se vendet e vogla duhet të përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve të tyre për të zbatuar ligjin ndërkombëtar në mënyrë të pavarur. Ndërhyrjet ndërkombëtare janë shpesh të nevojshme në situata kritike, por për të siguruar stabilitet afatgjatë, vendet e vogla duhet të ndërtojnë institucione të forta që janë në gjendje të përballojnë krizat pa varësi nga jashtë (Kritsiotis, 1999).

Operacioni “Alba” ofron një rast të rëndësishëm për të kuptuar rolin e ligjit ndërkombëtar në menaxhimin e krizave të brendshme, veçanërisht për vendet e vogla. Ai tregon se

ndërhyrjet ndërkombëtare janë të domosdoshme kur institucionet kombëtare janë të dobëta dhe se ligji ndërkombëtar siguron një bazë të fortë për legjitimitetin e këtyre ndërhyrjeve. Në të njëjtën kohë, operacioni nxjerr në pah rëndësinë e reformave të qëndrueshme dhe të përqendruara në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme për zbatimin e ligjit dhe stabilizimin e vendeve të vogla. Sfidat që hasen gjatë këtyre proceseve janë të shumta, por mësimet nga kriza shqiptare dhe ndërhyrja ndërkombëtare ofrojnë një udhëzues për menaxhimin e krizave të ardhshme në vende të ngjashme.

3.7. Sovraniteti dhe Ligji Ndërkombëtar

Kriza e Shqipërisë në vitin 1997 ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe destabilizuese në historinë e saj moderne. Dështimi i skemave piramidale dhe pasojat e saj të rënda çuan në një kolaps të sistemit dhe në një krizë të rëndë politike dhe ekonomike. Ndërhyrja ndërkombëtare, përmes operacionit “Alba”, kishte për qëllim stabilizimin e vendit dhe mbështetje për rikthimin e rendit dhe sigurisë (Marchio, 2000). Analiza e harmonizimit të ligjit ndërkombëtar me konceptin e sovranitetit dhe sfidave që dolën gjatë menaxhimit të operacionit “Alba”, ofron një pasqyrë të thellë të këtij procesi.

Harmonizimi i ligjit ndërkombëtar me sovranitetin. Në përputhje me ligjin ndërkombëtar, ndërhyrjet ushtarake janë të ndërlikuara dhe zakonisht ndodhin në përputhje me një ftesë nga qeveria e vendit të prekur ose me mandatin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Frowein, 1998). Në rastin e Shqipërisë, qeveria shqiptare kishte kërkuar ndihmën ndërkombëtare për të përballuar krizën, dhe kjo kërkesë u mor parasysh në formimin dhe ekzekutimin e operacionit “Alba” (European Union, 1997). Ky operacion kishte një mandat të qartë dhe të kufizuar që përfshinte ruajtjen e rendit dhe sigurimin e ndihmës

humanitare, duke përfshirë ndihmën për rinovimin e institucioneve shtetërore (United Nations, 1997).

Ndërhyrja ndërkombëtare në Shqipëri përballëj me disa sfida në organizim dhe menaxhim. Koordinimi ndërmjet trupave dhe agjencive të ndryshme ndërkombëtare ndonjëherë ishte i vështirë, duke krijuar probleme në efektivitetin e operacionit (Smith, 1998). Përveç kësaj, forcat ndërkombëtare u përballën me sfida në terren, duke përfshirë përballje me grupe të armatosura dhe kriminelë lokalë, si dhe menaxhimin e emergjencave dhe situatave të tjera të papritura (Johnson & Davis, 1998). Roli dhe ndikimi i aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë gjithashtu ishin sfida të rëndësishme, duke pasur interesa të ndryshme dhe ndonjëherë strategji të përbashkëta të paqarta (Bellamy & Williams, 2005).

Kriza e Shqipërisë në vitin 1997 dhe ndërhyrja ndërkombëtare përmes operacionit “Alba” ofron një shembull kompleks të harmonizimit të ligjit ndërkombëtar me konceptin e sovranitetit. Ndërhyrja ndërkombëtare kishte për qëllim të ndihmonte në stabilizimin e vendit dhe përmirësimin e kushteve për popullatën, megjithatë, përballeshim me sfida të shumta në menaxhimin e operacionit dhe në koordinimin e aktorëve ndërkombëtarë. Ky studim ofron një kuptim të thellë të mënyrës se si ndërhyrjet ndërkombëtare mund të realizohen në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe të menaxhohen në mënyrë efektive për të arritur qëllimet e caktuara (Tripodi, 2002).

Është shumë e rëndësishme trajtimi i marrëdhënieve ndërmjet sovranitetit dhe ligjit ndërkombëtar në këtë punim mbi krizën e Shqipërisë dhe operacionin “Alba”. Kjo

ndihmon në kuptimin e kompleksitetit të ndërhyrjeve ndërkombëtare në një shtet sovran dhe se si ligji ndërkombëtar mund të balancojë interesat e sovranitetit të një vendi me nevojën për ndërhyrje ndërkombëtare. Kriza e Shqipërisë në vitin 1997 ishte një ngjarje e rëndësishme që pasoi një dështim të sistemit ekonomik dhe politik. Ndërhyrja ndërkombëtare përmes operacionit “Alba” kishte për qëllim të stabilizonte situatën dhe të ndihmonte në rivendosjen e rendit dhe sigurisë. Ky proces ofron një kontekst të vlefshëm për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet sovranitetit dhe ligjit ndërkombëtar, si dhe sfidat e organizimit dhe menaxhimit të operacioneve ndërkombëtare (Zenelaga & Goga, 2021).

Sovraniteti është një parim thelbësor në ligjin ndërkombëtar, i cili i jep një shteti autoritet të plotë dhe të pakontestueshëm mbi territorin dhe popullsinë e tij (Brownlie, 2008). Megjithatë, ndërhyrjet ndërkombëtare, të tilla si operacionet paqeruajtëse, shpesh kërkojnë një balancim të kujdesshëm midis respektimit të sovranitetit dhe nevojës për të adresuar krizat humanitare ose destabilizuese (Cassese, 2005).

Në kontekstin e krizës së Shqipërisë dhe operacionit “Alba”, një nga mënyrat për të balancuar sovranitetin dhe ligjin ndërkombëtar ishte përmes kërkesës së qeverisë shqiptare për ndihmë dhe mbështetje ndërkombëtare (European Union, 1997). Mandatet e OKB-së dhe bashkëpunimi ndërkombëtar janë mekanizma që mundësojnë ndërhyrje në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe respektimin e sovranitetit të shteteve (Kissinger, 2001).

Një çështje e rëndësishme është *legjitimiteti i ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe respektimi*

i sovranitetit të shtetit. Në rastin e Shqipërisë, ndërhyrja ndërkombëtare ishte mbështetur nga një kërkesë e qeverisë dhe kishte një mandat të qartë, që ndihmoi në mbështetje të një qeverie të dëmtuar pa shkelur hapur sovranitetin e vendit (United Nations, 1997). Kjo krijon një kontekst ku ligji ndërkombëtar dhe sovraniteti mund të harmonizohen për të arritur qëllime të përbashkëta.

Pavarësisht përpjekjeve për të balancuar sovranitetin dhe ligjin ndërkombëtar, operacionet ndërkombëtare përballen shpesh me sfida në terren. Koordinimi i forcave ndërkombëtare dhe menaxhimi i situatave komplekse në krizë mund të krijojnë kontradikta dhe vështirësi, të cilat mund të ndikojnë në efektivitetin e operacioneve dhe të përkeqësojnë situatën e krijuar (Smith, 1998). Këto sfida janë një pasqyrë e përpjekjeve për të balancuar kërkesat e ligjit ndërkombëtar me realitetet praktike të menaxhimit të krizave.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 për të ndaluar masakrat dhe spastrimin etnik të popullsisë shqiptare nga forcat serbe përfaqëson një nga ndërhyrjet më të rëndësishme humanitare të periudhës pas Luftës së Ftohtë. Kjo ndërhyrje, megjithëse e ndërmarrë pa një autorizim të drejtpërdrejtë nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka pasur një ndikim të thellë në zhvillimin e konceptit të *"Përgjegjësisë për Mbrojtje"* (*Responsibility to Protect - R2P*) dhe ka krijuar një precedent për ndërhyrjet humanitare të ardhshme në konflikte të tjera ndërkombëtare (Bellamy, 2009). Ky rast tregon se kur bashkësia ndërkombëtare përballet me krime masive dhe shkelje të të drejtave të njeriut, ajo përballet me sfidën e ruajtjes së sovranitetit shtetëror kundrejt detyrës për të mbrojtur civilët nga mizoritë.

Përpara ndërhyrjes në Kosovë, ndërhyrjet ndërkombëtare për të mbrojtur popullatat civile nga krimet masive ishin të rralla dhe të kufizuara në raste shumë specifike. Rastet e Bosnjës dhe Ruandës, ku bashkësia ndërkombëtare dështoi të parandalonte masakra të mëdha, theksuan nevojën për të zhvilluar një qasje të re ndaj mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ndërhyrja në Kosovë paraqiti një pikë kthese të rëndësishme duke treguar se bashkësia ndërkombëtare ishte e gatshme të vepronte, madje edhe pa miratimin e Këshillit

të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kur përballeshin me krime kundër njerëzimit dhe shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut (Thakur, 2011).

Në vitin 2001, raporti i *Komisionit Ndërkombëtar për Ndërhyrje dhe Sovranitet Shtetëror (ICISS)* formalizoi konceptin e “*Përgjegjësisë për Mbrojtje*” (R2P). Ky parim thekson se shtetet kanë një përgjegjësi të parë për të mbrojtur popullsinë e tyre nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe spastrimi etnik. Nëse një shtet dështonte në këtë përgjegjësi, atëherë bashkësia ndërkombëtare kishte të drejtë të ndërhynte, përfshirë edhe me forcë, për të mbrojtur popullsinë. Rastet si ai i Kosovës kontribuan në zhvillimin e kësaj doktrine duke treguar se ndërhyrjet humanitare janë të justifikueshme kur qëllimi është mbrojtja e popullatave të pafajshme (Evans & Sahnoun, 2002).

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në 1999 përfaqësoi një ndryshim të rëndësishëm në perceptimin ndërkombëtar të përgjegjësisë për mbrojtjen e popullatave nga krimet masive. Pa autorizim të drejtpërdrejtë nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, ajo u pa si një ndërhyrje humanitare thelbësore, duke nxitur debatet për konceptin e “Përgjegjësisë për Mbrojtje” (R2P), i formalizuar më vonë në raportin e Komisionit Ndërkombëtar në 2001 (International Commission on Intervention and State Sovereignty, 2001). Ky parim vendos detyrimin mbi shtetet për të mbrojtur qytetarët e tyre dhe, në rast dështimi, mbi komunitetin ndërkombëtar për të ndërhyrë. Ndërhyrja në Kosovë theksoi tensionet midis sovranitetit dhe të drejtave të njeriut, duke ndihmuar në formësimin e normave të reja ndërkombëtare për mbrojtjen e civilëve (Kuperman, 2009).

Megjithëse koncepti i R2P është institucionalizuar në dokumentet ndërkombëtare, ai

mbetet i diskutueshëm. Një ndërhyrje si ajo e NATO-s në Kosovë tregon sfidat praktike dhe ligjore për zbatimin e këtij parimi, duke përfshirë nevojën për legjitimitet dhe për një proces të qartë vendimmarrjeje brenda sistemit ndërkombëtar. Ndërhyrja tregoi gjithashtu se si një veprim i njëanshëm mund të frymëzojë zhvillimin e një norme të re, por edhe të nxisë dyshime për përdorim selektiv dhe abuziv të ndërhyrjes humanitare (Orford, 2011).

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë krijoi një precedent për ndërhyrjet humanitare në konflikte të tjera si Libia, Siria dhe Darfuri. Në 2011, Këshilli i Sigurimit autorizoi ndërhyrjen në Libi për të mbrojtur civilët, duke përdorur parimin R2P si bazë ligjore. Megjithatë, kjo ndërhyrje u kritikua si përdorim i tepruar i forcës për rrëzimin e regjimit të Gaddafit, duke ngritur dilema për legjitimitetin dhe qëllimet e saj (Bellamy, 2015).

Në të njëjtën kohë, ndërhyrja në Kosovë tregoi se bashkësia ndërkombëtare mund të dështojë të veprojë kur ka ndarje të thella mes fuqive të mëdha, siç është rasti në Siri. Në këtë konflikt, përkundër krimeve të rënda ndaj civilëve, ndasitë në Këshillin e Sigurimit kanë penguar një ndërhyrje efektive, duke nxjerrë në pah kufizimet praktike të parimit të R2P dhe sfidën për të ruajtur konsensusin ndërkombëtar për ndërhyrjet humanitare. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i precedentit të Kosovës është ndikimi i tij në sovranitetin shtetëror. Ndërhyrjet humanitare, edhe kur kanë për qëllim mbrojtjen e civilëve, ngrenë pyetje të rëndësishme për të drejtën ndërkombëtare dhe parimin e sovranitetit (Hoffman & Weiss, 2020). Në disa raste, si ai i Ukrainës, ndërhyrjet humanitare janë përdorur si një mjet për të justifikuar veprime ushtarake ose politike që shkelin integritetin territorial të një vendi. Ky precedent ka krijuar një terren të vështirë për bashkësinë ndërkombëtare, e cila përpiqet të vendosë një balancë midis ndërhyrjeve të justifikuara për mbrojtje dhe

shmangies së abuzimeve politike ose strategjike (Adamu, 2023).

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë krijoi një precedent të rëndësishëm për ndërhyrjet humanitare, si ajo në Libi në 2011, e mbështetur nga Këshilli i Sigurimit dhe e bazuar në parimin e R2P për mbrojtjen e civilëve. Megjithatë, pasojat e ndërhyrjes në Libi dhe konflikti në Siri treguan sfidat dhe kufizimet e këtyre ndërhyrjeve, veçanërisht për shkak të ndarjeve politike në arenën ndërkombëtare (Kuperman, 2016). Ndërhyrja në Kosovë nxiti diskutime mbi kufijtë dhe mundësitë e ndërhyrjeve humanitare në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Ndërhyrja humanitare e NATO-s në Kosovë përfaqëson një moment kyç në historinë e ndërhyrjeve ndërkombëtare, duke nxitur zhvillimin e konceptit të R2P dhe duke krijuar precedentë për ndërhyrje të ngjashme. Ndikimi i kësaj ndërhyrjeje ka qenë i thellë, duke ofruar një kornizë për ndërhyrje humanitare, por edhe duke ngjallur debat për ligjshmërinë dhe qëllimin e tyre. Ndërsa rastet e mëvonshme kanë treguar fuqinë dhe kufizimet e këtij modeli, përvoja e Kosovës mbetet një shembull i rëndësishëm për të kuptuar kompleksitetin e ndërhyrjeve humanitare dhe sfidat për t'i bërë ato të ligjshme, të efektshme dhe të drejta në nivel ndërkombëtar.

4.5. Të drejtat humanitare

Ligji ndërkombëtar humanitar (LNH), i njohur gjithashtu si ligji i konfliktit të armatosur, ka për qëllim të mbrojë personat që nuk marrin pjesë në luftime dhe të kufizojë metodat

e luftës. Kriza e Kosovës në vitin 1999, si një nga konfliktet më të ndjeshme të pas Luftës së Ftohtë, ka pasur një ndikim të thellë në (LNH) dhe mënyrën se si zbatohen normat ndërkombëtare gjatë dhe pas një konflikti. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, spastrimi etnik i kryer nga regjimi serb dhe vendosja e administratës ndërkombëtare pas përfundimit të luftës janë të gjitha elemente që ngrenë çështje të rëndësishme për zhvillimin dhe forcimin e (LNH) së (Burger, 2000).

Kriza e Kosovës solli në vëmendje dështimet e bashkësisë ndërkombëtare për të parandaluar shkeljet masive të të drejtave të njeriut dhe krimet kundër njerëzimit. Operacionet serbe të spastrimit etnik, dëbimi masiv i shqiptarëve të Kosovës dhe abuzimet sistematike të të drejtave të njeriut përbënin shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës dhe të protokolleve të tyre shtesë. Megjithatë, përballë këtij realiteti, mungesa e një ndërhyrjeje të menjëhershme dhe të koordinuar nga ana e Kombeve të Bashkuara tregoi se (LNH) nuk ishte efektive për të parandaluar krime të tilla, duke ngritur pyetje për zbatueshmërinë dhe fuqinë e saj në situata të krizave të mëdha (Weller, 1999).

Një nga çështjet kryesore që u ngrit gjatë krizës së Kosovës ishte mënyra se si ndërhyrja humanitare nga NATO ndikoi në (LNH). Ndërhyrja pa një autorizim të posaçëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS-KB) u konsiderua si një shkelje e ligjit ndërkombëtar dhe, njëkohësisht, si një përpjekje për të parandaluar shkeljet masive të të drejtave të njeriut. Ky tension midis normave të sovranitetit dhe ndërhyrjes humanitare shërbeu si një pikë kritike për të shqyrtuar mënyrën se si (LNH) mund të përmirësohet për të siguruar një mbrojtje më efektive të popullatave civile në situata të krizës (Chesterman, 2002).

Zbatimi i (LNH) gjatë konfliktit të Kosovës ishte sfidues për shkak të natyrës së ndërlikuar të luftës dhe numrit të madh të aktorëve të përfshirë. Nga njëra anë, forcat serbe shkelën në mënyrë të përsëritur rregullat e konfliktit të armatosur, duke kryer sulme të qëllimshme ndaj civilëve dhe duke përdorur torturë dhe dhunë sistematike për të dëbuar popullsinë shqiptare. Nga ana tjetër, operacionet e NATO-s për të ndaluar këto shkelje përballen me kritika për shkak të disa veprimeve të saj, siç ishin sulmet ajrore që shkaktuan viktima civile, gjë që ngriti çështje për respektimin e parimeve të proporcionalitetit dhe parashikimit në luftën moderne (Henckaerts & Doswald-Beck, 2005).

Për të përballuar këtë sfidë, bashkësia ndërkombëtare ka bërë përpjekje për të forcuar mekanizmat për mbikëqyrjen dhe zbatimin e (LNH). Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim ishte krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi (ICTY), e cila trajtoi krimet e kryera gjatë konflikteve në Ballkan, përfshirë Kosovën. Gjykata jo vetëm që gjykoi dhe dënoi disa nga përgjegjësit kryesorë të krimeve, por gjithashtu dha një mesazh të fuqishëm për mosndëshkimin dhe rëndësinë e mbajtjes përgjegjëse të shkelësve të (LNH) -së (Akhavan, 1998).

Pas përfundimit të konfliktit, zbatimi i (LNH) vazhdoi të jetë një sfidë për rindërtimin e shoqërisë kosovare dhe për vendosjen e një sistemi të qëndrueshëm të drejtësisë. Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) luajti një rol të rëndësishëm në këtë drejtim duke krijuar struktura për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të forcuar sundimin e ligjit. Megjithatë, procesi i rindërtimit pas konfliktit tregoi se përpjekjet për

të zbatuar (LNH) nuk mbarojnë me përfundimin e luftimeve. Për të siguruar drejtësi dhe për të parandaluar përsëritjen e krimeve, është e nevojshme që bashkësia ndërkombëtare të përqendrohet në forcimin e institucioneve të drejtësisë dhe në mbështetjen e procesit të pajtimit (Reka, 2003).

Rezoluta 1244 e miratuar nga KS-KB përcaktoi kuadrin ligjor për administrimin ndërkombëtar të Kosovës dhe për mbrojtjen e të drejtave të popullsisë së saj. Megjithatë, sfidat e zbatimit të kësaj rezolute dhe përplasjet politike ndërmjet komuniteteve etnike nxorën në pah nevojën për një qasje më të integruar dhe më të qëndrueshme për të zbatuar (LNH) pas konflikteve (Yannis, 2004). Përveç kësaj, përvoja e Kosovës tregoi se ndërhyrjet ndërkombëtare nuk duhet të kufizohen vetëm në aspektin ushtarak, por duhet të përfshijnë gjithashtu përpjekje për rindërtimin e shoqërisë dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Kriza e Kosovës ofron disa mësim të rëndësishme për të ardhmen e (LNH) dhe për mënyrat e zbatimit të saj gjatë dhe pas konflikteve. *Së pari*, është e domosdoshme që bashkësia ndërkombëtare të jetë e gatshme të veprojë shpejt dhe në mënyrë të koordinuar për të parandaluar shkeljet masive të të drejtave të njeriut. *Së dyti*, për të siguruar që ndërhyrjet humanitare të jenë të legjitimuara dhe të mbështetura nga parimet e (LNH) - së, është e nevojshme që këto veprime të kenë një bazë të fortë ligjore dhe të ndjekin një proces të qartë vendimmarrjeje (Chesterman, 2002).

Një tjetër mësim i rëndësishëm është rëndësia e përgjegjësisë për të siguruar drejtësi për viktimat dhe për të ndjekur penalisht autorët e krimeve. Përpjekjet për të mbështetur

proceset e drejtësisë ndërkombëtare dhe forcimin e institucioneve vendore janë kyçe për të ndërtuar paqe të qëndrueshme dhe për të siguruar që (LNH) të zbatohet me efikasitet. Përvoja e Kosovës, me të gjitha sfidat dhe përparësitë e saj, mbetet një rast studimor që nënvizon nevojën për një angazhim të vazhdueshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe respektimin e parimeve të ligjit ndërkombëtar.

4.6. Rezoluta 1244 dhe administrimi ndërkombëtar

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS-KB), e miratuar më 10 qershor 1999, shënoi një pikë kthese në menaxhimin e krizës së Kosovës, duke krijuar kornizën ligjore për administrimin ndërkombëtar të rajonit. Qëllimi i saj kryesor ishte stabilizimi i Kosovës pas konfliktit të ashpër midis forcave serbe dhe popullsisë shqiptare, si dhe sigurimi i një ambienti të sigurt për kthimin e refugjatëve dhe për vendosjen e një rendi të ri politik. Përmes krijimit të *Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)*, KS-KB synonte të garantonte një kalim të qëndrueshëm drejt një shoqërie demokratike dhe multietnike. Megjithatë, ndërsa ka patur disa arritje të rëndësishme, efektiviteti i *Rezolutës 1244* dhe administratës ndërkombëtare ka qenë subjekt i shumë debatimeve dhe vlerësimeve të ndryshme (Waller & Gökay, 2014).

Rezoluta 1244 vendosi kornizën për një prani të qëndrueshme ndërkombëtare në Kosovë, duke autorizuar UNMIK për të drejtuar çështjet politike, ekonomike dhe të sigurisë në rajon. Ajo synonte të ruante sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë, ndërsa njëkohësisht garantonte një autonomi të gjerë për Kosovën. UNMIK kishte një mandat të

gjerë për të mbikëqyrur rindërtimin e institucioneve demokratike, për të nxitur pajtimin ndëretnik dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky mandat përfshinte një gamë të gjerë përgjegjësish, duke përfshirë krijimin e një qeverie të përkohshme dhe ndihmën për procesin zgjedhor në rajon (Muharremi, 2014).

Një arritje kryesore e administratës ndërkombëtare ishte sigurimi i stabilitetit dhe parandalimi i rikthimit të dhunës masive në Kosovë. Prania e forcave ndërkombëtare ndihmoi kalimin nga lufta në një periudhë stabiliteti, duke lehtësuar kthimin e refugjatëve, organizimin e zgjedhjeve dhe ndërtimin e institucioneve demokratike. UNMIK gjithashtu punoi për krijimin e një sistemi drejtësie për trajtimin e krimeve të konfliktit, në bashkëpunim me *Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi* (OSCE, 2009).

Pavarësisht arritjeve të konsiderueshme, administrata ndërkombëtare e Kosovës u përball me shumë sfida që kufizuan efektivitetin e saj. Një nga sfidat kryesore ishte mungesa e një strategjie të qartë për përfundimin e administrimit ndërkombëtar dhe përcaktimin e statusit final të Kosovës. Për një kohë të gjatë, Kosova qëndroi në një situatë të paqartë juridike, duke shkaktuar tensione të vazhdueshme me Serbinë dhe duke kontribuar në pasigurinë politike dhe institucionale brenda Kosovës. Kjo situatë e paqartë ndikoi negativisht në investimet ekonomike dhe në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme (Armakolas & Ker-Lindsay, 2019).

Një tjetër kritikë kryesore lidhej me qasjen paternaliste të UNMIK-ut në qeverisjen e Kosovës. Shpeshherë, UNMIK u akuzua për mungesë të përfshirjes së komunitetit lokal në procesin e vendimmarrjes, gjë që krijoi ndjenja të pakënaqësisë dhe mungesë të besimit

nga ana e popullatës kosovare. Për më tepër, administrata ndërkombëtare u përball me korrupsionin dhe mungesën e efikasitetit në disa fusha kyçe, si drejtësia dhe administrimi publik, çka pengoi përpjekjet për të ndërtuar një shtet të qëndrueshëm dhe funksional (Yannis, 2001).

Efektiviteti i *Rezolutës 1244* dhe administratës ndërkombëtare në Kosovë ka pasur rezultate të përziera. Ndërhyrja ndërkombëtare ishte kyçe për stabilizimin dhe parandalimin e dhunës së mëtejshme, por sfidat gjatë administrimit treguan nevojën për qasje më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në menaxhimin e konflikteve dhe rindërtimin pas tyre. Përvoja e Kosovës nënvizon rëndësinë e përcaktimit të objektivave të qarta, afateve dhe përfshirjes së komunitetit lokal për të siguruar qëndrueshmëri (Doyle & Sambanis, 2006). Ky rast ofron mësim për politikën e ardhshme të mbështetjes së institucioneve lokale, forcimit të shtetit ligjor dhe promovimit të pajtimit ndëretnik.

Ndërhyrjet ndërkombëtare në situata të krizave humanitare ose konflikteve të brendshme janë një nga temat më të ndërlikuara në politikën globale. Debatet mbi to shpesh përqendrohen te etika dhe politika e këtyre ndërhyrjeve, duke shqyrtuar motivet që qëndrojnë pas tyre, legjitimitetin politik që ato mbartin dhe ndikimin afatgjatë në shtetet dhe rajonet e prekura (Nasir, 2024). Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë më 1999 është një shembull klasik që ka ngjallur diskutime të thella lidhur me këto çështje. Ndërhyrjet e tilla kanë potencialin për të shpëtuar jetë dhe për të ndaluar krime të mëdha, por ato gjithashtu ngjallin pyetje për qëllimet e vërteta të aktorëve ndërkombëtarë, për ndërhyrjet selektive dhe për pasojat e mundshme afatgjata.

Motivet e ndërhyrjeve ndërkombëtare janë shpesh komplekse. Në rastin e NATO-s në

Kosovë, ndërhyrja u justifikua si mbrojtje ndaj krizës humanitare dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, për të ndaluar mizoritë kundër popullsisë shqiptare. Megjithatë, disa analistë vënë në dukje se edhe interesat strategjike dhe gjeopolitike luajtën rol, duke përfshirë synimin e NATO-s për të forcuar ndikimin në rajon dhe stabilizuar Ballkanin sipas interesave perëndimore (Chomsky, 2002).

Këto dyshime për motivet pas ndërhyrjeve humanitare shpesh çojnë në një skepticizëm të thellë në nivel ndërkombëtar. Në disa raste, ndërhyrjet janë perceptuar si hipokrite, ku aktorët ndërkombëtarë veprojnë në një konflikt por injorojnë të tjerët me pasoja të ngjashme, duke ngritur pyetje për selektivitetin dhe standardet e dyfishta në politikën ndërkombëtare. Kjo çon në një debat të gjerë për etikën e ndërhyrjeve: nëse ato janë të motivuara vërtet nga parime humanitare, apo janë thjesht maska për të mbrojtur interesa të ngushta të aktorëve të fuqishëm.

Legjitimiteti politik i ndërhyrjeve ndërkombëtare është një çështje e debatueshme në të drejtën ndërkombëtare. Në rastin e Kosovës, ndërhyrja e NATO-s pa mandat të qartë nga Këshilli i Sigurimit ngriti dyshime mbi ligjshmërinë e saj, duke përplasur nevojën për ndërhyrje humanitare me respektin për sovranitetin shtetëror (Wheeler, 2000). Gjithashtu, legjitimiteti varet nga mbështetja e komunitetit ndërkombëtar; ndërhyrjet me konsensus më të gjerë perceptohen si më të drejta, ndërsa mungesa e miratimit dhe ndasitë midis fuqive të mëdha dobësojnë legjitimitetin dhe i japin atyre ngjyrën e veprimeve të njëanshme për interesa të caktuara (Cook, 2010).

Ndikimi afatgjatë i ndërhyrjeve ndërkombëtare është një tjetër aspekt i rëndësishëm për

t'u shqyrtuar. Në rastin e Kosovës, ndërhyrja e NATO-s kontribuoi në ndalimin e spastrimit etnik dhe në sigurimin e stabilitetit të përkohshëm, por pasojat afatgjata të kësaj ndërhyrjeje kanë qenë të ndërlikuara. Krijimi i një administrate ndërkombëtare dhe ndërtimi i një shoqërie demokratike ishin qëllime të rëndësishme, por procesi ka qenë i ngadalshëm dhe i vështirë. Ndërhyrja ndërkombëtare ndihmoi në parandalimin e një katastrofe humanitare, por krijoi edhe një situatë të paqartë juridike dhe politike për statusin e Kosovës, duke shkaktuar tensione të vazhdueshme me Serbinë dhe duke përplasar komunitetet etnike në rajon (Ker-Lindsay, 2013).

Ndërhyrjet ndërkombëtare kanë potencial për të krijuar një precedent për veprimet e ardhshme, por ato gjithashtu përmbajnë rreziqe të mëdha. Kur ndërhyrjet konsiderohen të suksesshme dhe legjitime, ato mund të nxisin ndërhyrje të ngjashme në të ardhmen për të mbrojtur civilët dhe për të ndaluar krimet masive. Në të kundërt, kur ato perceptohen si të njëanshme ose të paefektshme, ato mund të dëmtojnë besueshmërinë e komunitetit ndërkombëtar dhe të rrisin skepticizmin ndaj ndërhyrjeve të ardhshme (Bellamy, 2015).

Debati mbi etikën dhe politikën e ndërhyrjeve ndërkombëtare mbetet një sfidë komplekse në politikën globale. Motivet, legjitimiteti politik dhe ndikimi afatgjatë i këtyre ndërhyrjeve janë çështje që kërkojnë një vlerësim të kujdesshëm për të siguruar që ndërhyrjet të jenë të justifikuara dhe të mbështetura nga parime të qarta morale dhe ligjore. Ndërhyrja në Kosovë ofron një rast studimor të rëndësishëm për të shqyrtuar këto aspekte dhe për të nxjerrë mësim për të ardhmen e ndërhyrjeve humanitare dhe politike.

4.7. Stabiliteti rajonal

Kriza e Kosovës në fund të viteve 1990 ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme që ndikuan në stabilitetin rajonal të Ballkanit dhe pati implikime të gjera për marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky konflikt nxori në pah ndasitë historike, etnike dhe politike të rajonit, duke theksuar rëndësinë e menaxhimit të konflikteve dhe ndërhyrjes ndërkombëtare për stabilizimin e situatave të tilla. Ndërhyrja e NATO-s dhe reagimi ndërkombëtar ndaj krizës së Kosovës nuk ndryshuan vetëm peizazhin politik të Ballkanit, por gjithashtu ndikuan në doktrinën dhe praktikën ndërkombëtare të menaxhimit të krizave dhe të drejtave të njeriut (Krieger, 2001).

Kriza e Kosovës kishte pasoja të rëndësishme për stabilitetin e Ballkanit, një rajon tashmë i brishtë dhe i ndërlikuar nga konflikte etnike dhe politike. Ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999, për të ndalur spastrimin etnik të kryer nga forcat serbe ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës, shënoi një përfshirje të fuqishme të komunitetit ndërkombëtar në këtë rajon, duke ndalur një katastrofë të mëtejshme humanitare, por gjithashtu duke thelluar ndasitë etnike dhe politike. Pas ndërhyrjes, Ballkani përjetoi një periudhë të tensionuar, ku qeveritë e vendeve fqinje dhe komunitetet etnike brenda Kosovës ishin të ndara mbi çështjen e statusit të saj. Krijimi i një administrate ndërkombëtare në Kosovë nën mandatin e Kombeve të Bashkuara (UNMIK) u pa si një përpjekje për të qetësuar situatën, por tensionet vazhduan të ekzistojnë për një kohë të gjatë, veçanërisht në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë (Ker-Lindsay, 2013).

Kriza në Kosovë ndikoi thellë marrëdhëniet ndëretnike në Ballkan, ku ndërhyrja e

NATO-s dhe pavarësia u panë si fitore nga shqiptarët, por si shkelje sovraniteti nga serbët. Kjo ndarje vazhdon të komplikojë situatën politike në rajon. Ndërhyrja e NATO-s, edhe pa mandat të Këshillit të Sigurimit, ngriti sfida për të drejtën ndërkombëtare dhe forcoi doktrinën e ndërhyrjes humanitare, duke ndikuar në zhvillimin e konceptit R2P si precedent për ndërhyrje të tjera (Thakur, 2016).

Kriza e Kosovës rriti ndërgjegjësimin ndërkombëtar për nevojën e një qasje më të koordinuar ndaj konflikteve. Ndërhyrja e NATO-s tregoi fuqinë dhe kufizimet e aleancave ushtarake, duke ngritur debate mbi përdorimin e forcës pa mandat të KS-KB-së. Kjo ndarje perceptimesh krijoi tensione midis Rusisë dhe Perëndimit që vazhdojnë të ndikojnë politikën ndërkombëtare (Weller, 1999). Përvoja e Kosovës theksoi rëndësinë e një qasjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin e konflikteve, duke shmangur selektivitetin dhe keqpërdorimet.

Ndikimi i krizës së Kosovës në stabilitetin rajonal të Ballkanit dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare ka qenë i thellë dhe i ndërlikuar. Ai ka ofruar mësimet e rëndësishme për mënyrën se si bashkësia ndërkombëtare përballet me konflikte të ngjashme dhe për sfidat e menaxhimit të krizave në rajone të ndërlikuara. Duke krijuar një precedent për ndërhyrjet humanitare, kriza e Kosovës ka ndikuar në politikën globale dhe ka theksuar rëndësinë e një qasjeje të balancuar dhe të drejtë për të siguruar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

4.8. OJQ-të dhe shoqëria civile pas konfliktit

Në trajtimin e krizave humanitare dhe stabilizimin e situatave të pas-konfliktit, organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe aktorët e shoqërisë civile kanë luajtur një rol të rëndësishëm. Kriza e Kosovës në fund të viteve 1990 është një shembull ku ndërhyrja e aktorëve jo-shtetërorë përshpejtoi ndihmën humanitare dhe mbështeti procesin e stabilizimit dhe rindërtimit pas konfliktit. Në kontekstin e një krize të përmasave të mëdha, me shkelje sistematike të të drejtave të njeriut dhe dëbime masive, OJQ-të dhe aktorët e shoqërisë civile kontribuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbështetjen e popullatës së prekur dhe në përf forcimin e përpjekjeve për pajtim dhe ndërtim të paqes (Kokott, 2002).

Gjatë krizës së Kosovës, OJQ-të ndërkombëtare dhe lokale u mobilizuan për të ofruar ndihmë të menjëhershme për refugjatët dhe të zhvendosurit, duke siguruar ushqim, strehim dhe kujdes mjekësor. Organizata të tilla si *Kryqi i Kuq Ndërkombëtar*, *UNHCR* dhe *Mjekët pa Kufij* ishin të pranishme në terren për të adresuar nevojat themelore të qindra mijëra personave që u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të dhunës dhe spastrimit etnik të kryer nga forcat serbe. Ky mobilizim masiv humanitar ndihmoi në parandalimin e një krize humanitare edhe më të rëndë dhe krijoi kushtet për mbijetesën e popullatës në kushte të vështira (Barnett & Weiss, 2008).

Përveç ndihmës humanitare të menjëhershme, OJQ-të luajtën një rol të rëndësishëm në dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe raportimin e tyre te komuniteti ndërkombëtar. Organizata si *Human Rights Watch* dhe *Amnesty International*

dokumentuan krimet e kryera gjatë konfliktit dhe ngritën ndërgjegjësimin global për vuajtjet e popullatës shqiptare të Kosovës. Ky raportim shërbeu si një mjet për të ushtruar presion mbi fuqitë e mëdha dhe për të nxitur ndërhyrjen ndërkombëtare, duke treguar se angazhimi i shoqërisë civile në dokumentimin e krimeve ka një ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e një ndërgjegjësimi global dhe në formësimin e politikave ndërkombëtare (Human Rights Watch, 2001).

Pas përfundimit të konfliktit, OJQ-të luajtën një rol të rëndësishëm në procesin e rindërtimit dhe stabilizimit të Kosovës. Përmes projekteve të tyre, ato ndihmuan në krijimin e kushteve për një shoqëri të qëndrueshme dhe të pajtuar, duke ofruar mbështetje për rindërtimin e infrastrukturës, nxitjen e dialogut ndëretnik dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale. OJQ-të u përfshinë në programe të pajtimit, duke synuar të ulin tensionet ndëretnike dhe të nxisin një dialog të hapur ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Përmes edukimit, projekteve kulturore dhe mbështetjes për gratë dhe të rinjtë, këto organizata kontribuan në rindërtimin e shoqërisë civile dhe në krijimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për Kosovën (Pugh & Turner, 2011).

Një nga aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së OJQ-ve ishte përpjekja për forcimin e sundimit të ligjit dhe të drejtësisë. Ato ndihmuan në ndërtimin e institucioneve të reja dhe në mbështetjen e sistemit të drejtësisë për të trajtuar krimet e kryera gjatë dhe pas konfliktit. Në bashkëpunim me administratën ndërkombëtare, OJQ-të punuan për të siguruar që proceset e drejtësisë të ishin të pavarura, transparente dhe të mbështetura nga popullata vendase. Këto përpjekje ishin të rëndësishme për të rivendosur besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe për të promovuar pajtimin dhe stabilitetin afatgjatë

(Duffield, 2007).

Megjithëse roli i OJQ-ve ka qenë thelbësor për trajtimin e krizës humanitare dhe për stabilizimin pas konfliktit, ka pasur edhe sfida dhe kritika që lidhen me aktivitetin e tyre. Disa OJQ janë akuzuar për mungesë të koordinimit dhe për qasje paternaliste, duke vepruar shpesh në mënyrë të pavarur nga strukturat lokale dhe pa një strategji të qartë për zhvillimin afatgjatë. Kjo qasje mund të ketë krijuar varësi të tepërt nga ndihma ndërkombëtare dhe të ketë penguar zhvillimin e kapaciteteve vendore. Për më tepër, disa kritika kanë ngritur pyetje për mungesën e transparencës dhe për përdorimin e fondeve në mënyrë joefikase, duke nxjerrë në pah nevojën për përgjegjësi më të madhe nga ana e OJQ-ve dhe për një bashkëpunim më të mirë me komunitetet vendase (Duffield, 2007).

Kontributi i OJQ-ve dhe aktorëve të shoqërisë civile në trajtimin e krizës humanitare dhe stabilizimin pas konfliktit të Kosovës është një shembull i fuqishëm i rëndësisë së këtyre aktorëve në kontekste të krizave komplekse. Ndihma e tyre humanitare, mbështetja për pajtimin dhe rindërtimin, si dhe përpjekjet për forcimin e sundimit të ligjit kanë qenë thelbësore për përparimin e Kosovës drejt stabilitetit dhe demokracisë. Megjithatë, përvoja e Kosovës tregon se suksesi i OJQ-ve varet nga aftësia e tyre për të bashkëpunuar ngushtë me strukturat vendore, për të siguruar transparencë dhe për të zhvilluar strategji të qëndrueshme për rindërtimin dhe zhvillimin afatgjatë.

4.9. Mësime të nxjerra

Kriza e Kosovës në fund të viteve 1990 dhe ndërhyrja ndërkombëtare që pasoi ofrojnë një mundësi të rëndësishme për të reflektuar mbi rolin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS-KB) dhe të ligjit ndërkombëtar në menaxhimin e krizave rajonale. Ky rast tregon sfidat dhe kufizimet e rendit ndërkombëtar përballë krizave humanitare, ndërsa ofron mësim të vlefshme për forcimin e mekanizmave ndërkombëtarë të drejtësisë dhe për rolin e institucioneve ndërkombëtare në garantimin e paqes dhe sigurisë. Duke analizuar ndërveprimet midis KS-KB-së, aktorëve ndërkombëtarë dhe ligjit ndërkombëtar, është e mundur të identifikohen dobësitë dhe pikat e forta të sistemit ekzistues, si dhe nevojat për reformë dhe përmirësim të mëtejshëm.

1. Dështimi i KS-KB-së për të ndërhyrë në kohë. Një nga mësimet kryesore që mund të nxirren nga rasti i Kosovës është dështimi i KS-KB-së për të ndërhyrë në kohë për të parandaluar krizat humanitare dhe për të mbrojtur civilët nga shkeljet e të drejtave të njeriut. Përkundër raportimeve të shumta mbi dhunën dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut nga forcat serbe ndaj popullsisë shqiptare, KS-KB mbeti i bllokuar për shkak të ndarjeve mes anëtarëve të tij të përhershëm. Rusia, një aleate tradicionale e Serbisë, kundërshtoi çdo veprim ushtarak të autorizuar nga KS-KB, duke e bërë të pamundur arritjen e një konsensusi për ndërhyrjen ndërkombëtare. Kjo situatë nxjerr në pah dobësinë e sistemit të KS-KB-së për të vepruar shpejt dhe në mënyrë efektive kur interesat e fuqive të mëdha bien në kundërshtim, duke krijuar një bllokim që vonon veprimet e domosdoshme humanitare (Chesterman, 2002).

Kjo përvojë nënvizon nevojën për një reformim të sistemit të KS-KB-së për të siguruar që bllokimet politike të mos pengojnë veprimet e nevojshme për të mbrojtur jetët e njerëzve dhe për të ndaluar krimet kundër njerëzimit. Për të përballuar sfida të tilla në të ardhmen, mund të kërkohej rishikimi i të drejtës së vetos ose krijimi i mekanizmave që lejojnë veprime kolektive edhe kur konsensusi nuk arrihet.

2. Ndërhyrja e NATO-s dhe debati për ligjshmërinë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që doli nga kriza e Kosovës është debati për legjitimitetin dhe ligjshmërinë e ndërhyrjeve ndërkombëtare pa një autorizim të KS-KB-së. Ndërhyrja e NATO-s për të ndalur spastrimin etnik dhe dhunën masive në Kosovë u krye pa një mandat të qartë të KS-KB-së, gjë që ngjalli debate të forta për ligjshmërinë e përdorimit të forcës. Disa e konsideruan këtë ndërhyrje si një veprim të nevojshëm dhe të justifikuar për të ndaluar një krizë humanitare, duke argumentuar se parimi i sovranitetit duhet të jetë i kufizuar në raste të krimeve masive dhe gjenocidit. Megjithatë, të tjerë argumentuan se ndërhyrja përbënte një shkelje të të drejtës ndërkombëtare, pasi nuk kishte mbështetjen e KS-KB-së dhe mund të krijonte një precedent të rrezikshëm për ndërhyrje të njëanshme në të ardhmen (Wheeler, 2000).

Ky debat nxjerr në pah tensionin midis parimit të sovranitetit dhe të drejtave të njeriut në rendin ndërkombëtar dhe tregon nevojën për qartësi më të madhe dhe reforma në të drejtën ndërkombëtare për ndërhyrjen humanitare. Një qasje e unifikuar dhe e mbështetur nga KS-KB do të ndihmonte për të garantuar legjitimitetin e ndërhyrjeve dhe për të parandaluar keqpërdorimin e tyre për qëllime politike.

3. Zhvillimi i konceptit të "Përgjegjësisë për Mbrojtje" R2P. Një nga mësimet më të rëndësishme të nxjerra nga rasti i Kosovës është zhvillimi i konceptit të "Përgjegjësisë për Mbrojtje" (*Responsibility to Protect - R2P*). Ky parim, i formalizuar më vonë, argumenton se shtetet kanë një përgjegjësi për të mbrojtur popullsinë e tyre nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Kur një shtet dështon të përmbushë këtë përgjegjësi, bashkësia ndërkombëtare ka të drejtë të ndërhyjë për të mbrojtur jetët e popullatave civile. Rasti i Kosovës tregoi se ndërhyrja humanitare mund të jetë e nevojshme, por gjithashtu theksoi rëndësinë e një baze ligjore të qartë për të justifikuar veprime të tilla dhe për të siguruar që ato janë në përputhje me normat dhe parimet ndërkombëtare (Bellamy, 2009).

4. Përforcimi i sundimit të ligjit pas konfliktit. Pas konfliktit në Kosovë, përforcimi i sundimit të ligjit dhe rindërtimi i institucioneve u bënë thelbësore. Administrata ndërkombëtare sipas Rezolutës 1244 dhe sistemi i drejtësisë për krimet e luftës ndihmuan në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme. Mbështetja e pajtimit ndëretnik dhe ndjekja penale e përgjegjësve për krime kundër njerëzimit treguan rëndësinë e ligjit ndërkombëtar në fazat post-konflikt. Megjithatë, sfidat si korrupsioni dhe ndarjet etnike kërkojnë angazhim të vazhdueshëm ndërkombëtar për rezultate afatgjata (Muharremi, 2014).

Rasti i Kosovës ofron një pasqyrë të vlefshme mbi rolin e KS-KB-së dhe të ligjit ndërkombëtar në menaxhimin e krizave. Ndërsa ai nxjerr në pah dobësitë dhe kufizimet e sistemit ekzistues, gjithashtu thekson rëndësinë e përpjekjeve për reformë dhe përforcim të mekanizmave ndërkombëtarë për të siguruar që krizat e ardhshme të trajtohen në mënyrë më efektive dhe të qëndrueshme. Nëpërmjet këtij rasti, bashkësia ndërkombëtare

ka marrë mësim për nevojën për bashkëpunim, transparencë dhe një angazhim të
sinqertë për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të ndërtuar paqe të qëndrueshme.

4.10. Konkluzione

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 dhe pasojat e saj përbëjnë një rast të rëndësishëm për analizën e së drejtës ndërkombëtare dhe mekanizmave të menaxhimit të krizave. Ndërhyrja, e cila u realizua pa një mandat të drejtpërdrejtë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nxiti një debat të thellë mbi tensionin mes ligjshmërisë dhe legjitimitetit në aksionet ndërkombëtare. Nga njëra anë, ajo u pa si një domosdoshmëri për të ndaluar spastrimin etnik dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut, ndërsa nga ana tjetër, shënoi një precedent të diskutueshëm për përdorimin e forcës jashtë kornizës së OKB-së. Ky rast ndikoi ndjeshëm në evolucionin e normave ndërkombëtare, duke kontribuar në zhvillimin e konceptit të "Responsibility to Protect" (R2P) si një parim të së drejtës ndërkombëtare për ndërhyrje humanitare.

Në aspektin e stabilitetit rajonal, ndërhyrja ndikoi jo vetëm në ndryshimin e dinamikave në Kosovë, por edhe në të gjithë rajonin e Ballkanit. Rezoluta 1244 e KS-KB vendosi administrimin ndërkombëtar të Kosovës nën UNMIK-un, duke krijuar një kornizë për stabilizimin e territorit dhe rindërtimin e institucioneve shtetërore. Megjithatë, ndërhyrja dhe administrimi ndërkombëtar nuk arritën të parandalonin sfidat afatgjata politike dhe juridike, veçanërisht në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës, i cili mbeti i diskutueshëm për një pjesë të konsiderueshme të bashkësisë ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, rasti i Kosovës evidentoi edhe kufizimet e Këshillit të Sigurimit në menaxhimin e konflikteve kur interesat e fuqive të mëdha janë në përplasje. Rusia dhe Kina e kundërshtuan ndërhyrjen dhe më pas refuzuan njohjen e pavarësisë së Kosovës, duke treguar se mungesa e konsensusit mes anëtarëve të përhershëm të KS-KB-së mund

të bllokojë veprimet e OKB-së në raste urgjente. Kjo situatë ka ngritur vazhdimisht çështjen e reformës së Këshillit të Sigurimit dhe nevojën për mekanizma më efikasë në menaxhimin e krizave ndërkombëtare.

Gjithashtu, përvoja e Kosovës tregoi rëndësinë e aktorëve jo-shtetërorë në procesin e rindërtimit dhe pajtimit pas konfliktit. Organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe shoqëria civile luajtën një rol kyç në mbështetjen e zhvillimit demokratik dhe stabilitetit në vend, duke treguar se rindërtimi pas konfliktit nuk është vetëm një proces politik dhe juridik, por kërkon edhe një angazhim të gjerë social dhe ekonomik.

Në përfundim, rasti i Kosovës mbetet një shembull i rëndësishëm për analizën e ndërhyrjeve ndërkombëtare, kufizimeve të sistemit të sigurisë globale dhe sfidave të pas-konfliktit. Ai vërteton se ndërhyrjet humanitare mund të jenë të nevojshme për të parandaluar katastrofat humanitare, por njëkohësisht thekson nevojën për një kuadër ligjor dhe institucional më të qartë për të shmangur tensionet gjeopolitike dhe pasiguritë ligjore. Përvoja e Kosovës është një mësim për politikën ndërkombëtare, duke nënvizuar rëndësinë e reformës së organizatave ndërkombëtare dhe adaptimit të së drejtës ndërkombëtare ndaj sfidave të reja globale.

KAPITULLI I PESTË: RAST ANALIZE UKRAINË – LUFTA E VITIT 2022

5.1. Hyrje

Ky kapitull analizon luftën në Ukrainë nga një këndvështrim i gjerë, duke marrë në konsideratë aspektet *ligjore, politike dhe ndërkombëtare* të konfliktit. Nëpërmjet nënkapitujve dhe nënpikave, do të trajtohen shkaqet, rrjedhojat dhe ndikimet globale të kësaj lufte, si dhe roli i ligjit ndërkombëtar dhe institucioneve ndërkombëtare në menaxhimin e saj. Kriza në Ukrainë është një nga ngjarjet më të rëndësishme gjeopolitike të shekullit XXI, që ka thelluar tensionet midis Rusisë dhe Perëndimit dhe ka riformuar dinamikat e sigurisë në Evropë dhe më gjerë. Fillimisht e shënuar nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe më pas e përshkallëzuar në një konflikt të plotë në vitin 2022 me një pushtim të plotë të Ukrainës nga forcat ruse, kjo krizë është pasojë e një kombinimi kompleks të faktorëve politikë, historikë dhe strategjikë (Barron, 2022).

Shkaqet kryesore të krizës mund të ndahen në dy kategori kryesore: *faktorët e brendshëm dhe ata të jashtëm*. Nga njëra anë, Rusia e ka perceptuar afrimin e Ukrainës drejt institucioneve perëndimore, si Bashkimi Evropian dhe NATO, si një kërcënim për interesat e saj strategjike dhe influencën tradicionale mbi këtë shtet fqinj (D’Anieri, 2019). Presidenti Vladimir Putin dhe establishmenti rus kanë argumentuar se përpjekjet për të integruar Ukrainën në strukturat perëndimore cenojnë sigurinë kombëtare të Rusisë dhe sfidojnë balancën e fuqisë në rajon. Nga ana tjetër, tendencat për demokratizim dhe reformat pro-perëndimore në Ukrainë janë përballur me rezistencë të fuqishme nga grupe

politike dhe ekonomike që shihnin lidhjet tradicionale me Rusinë si të domosdoshme për stabilitetin e vendit (Jing, 2022).

Rusia, përmes ndërhyrjes së saj në Ukrainë, synon të përmbushë disa qëllime strategjike. *Së pari*, ajo kërkon të sigurojë kontrollin e sferës së saj të ndikimit në ish-hapësirën sovjetike, duke shuar aspiratat perëndimore të Ukrainës. *Së dyti*, Rusia aspiron të dëshmojë aftësinë e saj për të sfiduar rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla të krijuara pas Luftës së Ftohtë dhe të vendosura nga fuqitë perëndimore. Nga ana tjetër, për Ukrainën dhe aleatët e saj perëndimorë, qëllimi kryesor është mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit, si dhe mbrojtja e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe sistemit ndërkombëtar të bazuar në rregulla (Dijkstra et al., 2022).

Kriza në Ukrainë dallon nga konfliktet e mëparshme në disa aspekte kyçe. *Së pari*, ajo është një përplasje ndërmjet një fuqie të madhe që sfidon rendin ekzistues dhe një shteti më të vogël që mbështetet fuqimisht nga komuniteti ndërkombëtar. Kjo krizë gjithashtu ka shënuar rikthimin e tensioneve gjeopolitike të ngjashme me periudhën e Luftës së Ftohtë, me përdorimin e diplomacisë së sanksioneve, konflikteve hibride dhe luftës së informacionit. Sipas Khorram-Manesh, Goniewicz dhe Burkle (2023), lufta hibride e udhëhequr nga Rusia në Ukrainë ka pasur ndikime të gjera sociale dhe shëndetësore. Konflikti ka krijuar presione të mëdha mbi sistemet e shëndetit publik, duke përfshirë dëmtimin e infrastrukturës, ndërprerjen e shërbimeve shëndetësore dhe përkeqësimin e situatës për grupet më të ndjeshme të popullsisë. Përballja me këto sfida kërkon përmirësimin e gatishmërisë për fatkeqësi dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Së dyti, përfshirja e teknologjisë kibernetike, operacionet e dezinformimit dhe përdorimi i

mjeteve jo-konvencionale të luftës kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si zhvillohet konflikti, duke e bërë atë shumëdimensional (Pratiwi & Mardenis, 2023).

Përballë kësaj krize, Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka përjetuar një bllokim të thellë për shkak të të drejtës së vetos të Rusisë, si një anëtare e përhershme. Ky bllokim ka ilustruar qartë kufizimet e sistemit ekzistues të qeverisjes globale në adresimin e konflikteve ku përfshihen fuqitë e mëdha. Përpjekjet për të kaluar rezoluta që dënojnë agresionin rus dhe kërkojnë ndërhyrje ndërkombëtare janë bllokuar vazhdimisht, duke nxjerrë në pah nevojën për reforma strukturore në sistemin e Këshillit të Sigurimit (Ibrahimov, 2023).

5.2. Ligji ndërkombëtar dhe lufta

Lufta në Ukrainë, e cila përfshin ndërhyrjen e Rusisë që prej vitit 2014, përfaqëson një nga konfliktet më të rëndësishme të shekullit XXI, me ndikime të thella në marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurinë globale dhe të drejtën ndërkombëtare. Analizimi i këtij konflikti është thelbësor për të kuptuar aspektet gjeopolitike, juridike, ekonomike dhe të sigurisë ndërkombëtare, duke ofruar gjithashtu mundësi për të nxjerrë mësimë mbi të ardhmen e rendit ndërkombëtar (Allison, 2014). Konflikti në Ukrainë, që filloi me aneksimin e Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe u përshkallëzua në një luftë të plotë më 2022, përfaqëson një pikë kthese për politikën dhe sigurinë ndërkombëtare. Ky konflikt ka përfshirë aspekte të shumta të ligjit ndërkombëtar, të vetëmbrojtjes, të aleancave ndërkombëtare dhe të ndikimit të fuqive të mëdha në rendin global. Si i tillë, lufta në Ukrainë ofron një rast studimor për të analizuar dinamika të ndryshme që ndikojnë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për të nxjerrë mësimë për të ardhmen e sigurisë dhe stabilitetit global (Dragiev, 2020).

Lufta në Ukrainë ka qenë një përplasje midis Perëndimit dhe Rusisë për ndikim gjeopolitik. Nga njëra anë, Ukraina ka përfshirë përpjekjet për integrim të mëtejshëm në strukturat perëndimore, përfshirë NATO-n dhe Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër, Rusia e sheh këtë si një kërcënim ndaj sferës së saj tradicionale të ndikimit dhe si një sfidë për sigurinë e saj kombëtare (Sakwa, 2015). Ky aspekt e bën konfliktin të rëndësishëm për të analizuar mënyrën sesi fuqitë e mëdha ndërveprojnë përmes ndikimit dhe si rivalitetet e tyre ndikojnë në stabilitetin rajonal dhe global. Aneksimi i Krimesë nga Rusia në vitin 2014 përbën një shembull të qartë të shkeljes së sovranitetit dhe integritetit territorial të një shteti.

Kjo ngjarje sfidoi normat ndërkombëtare dhe parimet e Kartës së OKB-së që mbrojnë integritetin territorial të shteteve (United Nations, 1945). Studimi i kësaj shkeljeje të ligjit ndërkombëtar dhe përgjigjes së komunitetit ndërkombëtar është thelbësor për të kuptuar kufizimet e mekanizmave ekzistues të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, si dhe për të vlerësuar efektivitetin e përgjigjes diplomatike dhe ekonomike ndaj agresionit.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka qenë i bllokuar për shkak të përdorimit të vetos nga Rusia, si një anëtare e përhershme, duke penguar miratimin e masave detyruese për të ndaluar agresionin dhe për të mbështetur sovranitetin e Ukrainës. Ky rast ilustron kufizimet strukturore të Këshillit dhe nevojën për reforma për të përmirësuar aftësinë e tij për të ndërhyrë në konflikte kur janë të përfshira fuqitë e mëdha (Malone, 2021). Lufta në Ukrainë mund të shërbejë si një shembull për studimin e reformës së Këshillit të Sigurimit dhe për diskutimet mbi efektivitetin e të drejtës së vetos në ruajtjen e paqes

ndërkombëtare. Lufta në Ukrainë ka vënë në qendër të vëmendjes parimin e vetëmbrojtjes, të parashikuar në Nenin 51 të Kartës së OKB-së, si dhe legjitimitetin e ndihmës ndërkombëtare për një vend të sulmuar. Ndihma ushtarake dhe humanitare që i është dhënë Ukrainës nga shumë shtete dhe organizata ndërkombëtare përbën një rast studimor për të analizuar kufizimet dhe ndikimin e ndihmës ndërkombëtare në ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të një shteti në përballje me agresionin (Dinstein, 2019).

Komuniteti ndërkombëtar ka reaguar ndaj agresionit rus përmes një serie sanksionesh ekonomike dhe diplomatike të vendosura nga BE-ja, SHBA-ja dhe aleatë të tjerë. Sanksionet përfshijnë ngrirje të pasurive, ndalime të udhëtimit dhe kufizime tregtare që synojnë të izolojnë Rusinë ekonomikisht dhe politikisht (Pifer, 2022). Studimi i efektivitetit të sanksioneve dhe ndikimit të tyre në sjelljen e një fuqie të madhe ofron një mundësi të rëndësishme për të vlerësuar fuqinë dhe kufizimet e këtij mjeti politik.

Konflikti në Ukrainë është karakterizuar nga akuza për krime lufte dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Dokumentimi dhe ndjekja penale e këtyre krimeve nga Gjykata Ndërkombëtare Penale (ICC) dhe organizata të tjera ndërkombëtare është një aspekt tjetër që e bën këtë konflikt të rëndësishëm për studim. Analiza e mënyrës sesi drejtësia ndërkombëtare vepron për të ndjekur përgjegjësit dhe për të garantuar llogaridhënien ofron mësim të rëndësishëm për të ardhmen e drejtësisë ndërkombëtare (Forsythe, 2012).

Lufta në Ukrainë ka ndikuar ndjeshëm në tregjet globale të energjisë dhe ka theksuar

rëndësinë e sigurisë energjetike për stabilitetin politik dhe ekonomik të Evropës dhe më gjerë. Varësia e shumë vendeve nga furnizimi me energji nga Rusia ka krijuar një krizë energjetike, duke nxitur përpjekje për të diversifikuar burimet dhe për të siguruar një siguri më të qëndrueshme energjetike (Goldthau & Sitter, 2022). Ky dimension gjeoekonomik është i rëndësishëm për të kuptuar ndikimet e luftës përtej fushës së betejës. Lufta Hibride dhe Teknologjitë e Reja. Konflikti në Ukrainë është shënuar nga përdorimi i luftës hibride, përfshirë luftën kibernetike, dezinformimin dhe taktikat jo-konvencionale. Analiza e mënyrës sesi këto mjete janë përdorur për të ndikuar në moralin publik dhe për të destabilizuar shtetin ukrainas mund të ofrojë njohuri të rëndësishme për zhvillimet bashkëkohore të konfliktit dhe për sfidat e ardhshme të sigurisë (Thomas, 2020).

Përfshirja e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale si NATO dhe BE në konfliktin në Ukrainë tregon fuqinë dhe limitet e aleancave ndërkombëtare për të ruajtur paqen dhe sigurinë. Studimi i mënyrës sesi këto organizata kanë reaguar ndaj agresionit dhe kanë bashkëpunuar me shtetet anëtare ofron një mundësi për të vlerësuar fuqinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në adresimin e konflikteve të mëdha (Gheciu, 2025). Lufta në Ukrainë ofron një rast studimor gjithëpërfshirës për të analizuar aspekte të shumta të ligjit ndërkombëtar, gjeopolitikës, sigurisë dhe ekonomisë. Duke përfshirë një përplasje të fuqive të mëdha dhe ndikime të thella rajonale dhe globale, ky konflikt ofron mësim të rëndësishëm për të ardhmen e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë globale. Ligji ndërkombëtar është një sistem kompleks rregullash dhe normash që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Ky sistem përbëhet nga traktate, konventa, dhe zakon ndërkombëtar që

janë krijuar për të promovuar paqen dhe sigurinë globale, për të mbrojtur të drejtat e njeriut, dhe për të siguruar zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve (Roberts, 2019).

Ligji ndërkombëtar bazohet në parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, që ndalon përdorimin e forcës për ndryshimin e kufijve dhe nxit zgjidhje paqësore të konflikteve (UN, 1945). Institucione si OKB, OSBE dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë luajnë rol kyç në zbatimin e këtyre rregullave. OKB-ja ka mandat për ruajtjen e paqes dhe promovimin e të drejtave të njeriut (UN, 2023), OSBE monitoron sigurinë dhe ndërmjetëson konflikte në Evropë (OSCE, 2023), ndërsa GJND trajton mosmarrëveshjet dhe shkeljet e ligjit ndërkombëtar (ICJ, 2023).

Kriza në Ukrainë ka filluar me aneksimin e Krimesë nga Rusia në vitin 2014, një akt që ka shkaktuar shqetësime të mëdha për shkeljet e ligjit ndërkombëtar. Aneksimi i Krimesë është konsideruar si një shkelje e hapur e Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila ndalon përdorimin e forcës për të ndryshuar kufijtë e shteteve (UN, 2014). Ky akt ka përshkallëzuar tensionet dhe ka ndikuar negativisht në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit të Evropës Lindore. Për më tepër, konflikti në lindje të Ukrainës ka sjellë raportime të shumta për shkelje të konventave të Gjenevës, që mbrojnë të drejtat e civilëve dhe trajtimin e ushtarëve të kapur (ICRC, 2020). Shkeljet e të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës, si sulmet ndaj civilëve dhe shkatërrimi i infrastrukturës civile, janë dokumentuar nga organizatat ndërkombëtare dhe kanë ndikuar rëndë në cilësinë e jetës së njerëzve në zonat e prekura.

Institucionet ndërkombëtare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përpjekjet për të

zgjdhur dhe menaxhuar konfliktin në Ukrainë. Kombet e Bashkuara, përmes Këshillit të Sigurimit, kanë miratuar një sërë rezolutash që dënojnë agresionin dhe imponojnë sanksione ndërkombëtare për të ndikuar në politikat e Rusisë (UNSC, 2022). Këto rezoluta janë një mjet i rëndësishëm për të detyruar shtetet të respektojnë ligjin ndërkombëtar dhe për të ushtruar presion mbi ata që shkelin rregullat e pranuar ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka ofruar një platformë për negociata dhe ka dërguar vëzhgues në rajonin e konfliktit për të monitoruar dhe raportuar mbi situatën e sigurisë (OSCE, 2023). Angazhimi i OSBE-së ka ndihmuar në krijimin e mundësive për dialog dhe ka kontribuar në përpjekjet për të ndaluar përshkallëzimin e konfliktit.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) ka marrë kërkesa nga Ukraina dhe shtete të tjera për të shqyrtuar dhe gjykuar për shkeljet e ligjit ndërkombëtar nga Rusia. Ky mekanizëm ofron një mundësi për të mbajtur përgjegjësi aktorët ndërkombëtarë dhe për të siguruar që ligji ndërkombëtar të zbatohet në mënyrë të drejtë (ICJ, 2023). Pra, konflikti në Ukrainë është një shembull i ndërlikimeve që lidhen me zbatimin e ligjit ndërkombëtar dhe rolin e institucioneve ndërkombëtare në menaxhimin e krizave globale. Ndërsa ligji ndërkombëtar synon të ndalojë shkeljet dhe të promovojë zgjidhjet paqësore, efektiviteti i tij shpesh varet nga bashkëpunimi i shteteve dhe forcimi i mekanizmave të zbatimit. Institucionet ndërkombëtare kanë një rol kyç në mbështetje të këtyre përpjekjeve, por sfidat e përballuara në Ukrainë tregojnë se ndihma e këtyre institucioneve duhet të jetë më e fortë dhe më e koordinuar për të arritur rezultate të qëndrueshme (Pifer, 2023).

Lufta në Ukrainë, që nisi me pushtimin rus në shkurt 2022, është një konflikt kompleks

me shkaqe historike, politike dhe gjeopolitike. Ajo përfshin rivalitete mes Ukrainës, që kërkon integrim në BE dhe NATO, dhe interesat e Rusisë, e cila sheh këtë si kërcënim (Miller, 2021; Kivimäki, 2025). Ndërgjegjësimi historik dhe identitar mes dy vendeve luan një rol kyç në tensionet aktuale.

Politika e jashtme e Rusisë, e udhëhequr nga Vladimir Putin, ka qenë një tjetër faktor i rëndësishëm. Rusia e sheh Ukrainën si një zonë të rëndësishme strategjike dhe ka bërë përpjekje për të ruajtur ndikimin e saj në rajon. Politika ruse është e udhëhequr nga dëshira për të parandaluar zgjerimin e NATO-s dhe për të mbajtur një sfond të favorshëm gjeopolitik në kufijtë e saj (Sakwa, 2017). Pushtimi i Krimesë në 2014 dhe shpërthimi i luftës në lindje të Ukrainës janë tregues të angazhimit të Rusisë për të kundërshtuar integrimin e Ukrainës në strukturat perëndimore dhe për të ruajtur ndikimin e saj në rajon.

Lufta në Ukrainë ka pasur rrjedhoja të thella dhe të shumëfishta, që prekin aspektet politike, ekonomike, dhe humanitare të vendit dhe rajonit më të gjerë. Politikisht, konflikti ka destabilizuar rajonin dhe ka shkaktuar tensione ndërkombëtare të mëdha. Përpjekjet për të ndaluar përshkallëzimin e konfliktit dhe për të arritur një zgjidhje diplomatike kanë qenë të pasuksesshme deri tani, dhe situata ka krijuar një ndarje të thellë ndërmjet shteteve perëndimore dhe Rusisë. Sanksionet ndërkombëtare të vendosura ndaj Rusisë kanë për qëllim të ndikojnë në politikën e saj dhe të dëmtojnë ekonominë ruse, por gjithashtu kanë ndikuar në ekonominë globale përmes shqetësimeve për energjinë dhe tregtinë (European Council, 2023).

Ekonomikisht, Ukraina ka pësuar dëme të mëdha nga lufta, duke përfshirë shkatërrimin

e infrastrukturës dhe humbjen e burimeve natyrore dhe ekonomike. Të dhënat për dëmet e shkaktuara dhe koston e rindërtimit janë të mëdha dhe përfaqësojnë një sfidë të rëndësishme për rikuperimin e ekonomisë ukrainase në të ardhmen (World Bank, 2022). Nga ana tjetër, Rusia ka përjetuar një ndikim ekonomik të rëndë për shkak të sanksioneve ndërkombëtare dhe përshkallëzimit të krizës ekonomike të brendshme.

Ne kontekstin social, lufta ka shkaktuar një krizë të thellë humanitare. Mijëra civilë janë vrarë dhe janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre, duke krijuar një numër të madh refugjatësh dhe të braktisurish. Ndihma ndërkombëtare ka qenë e nevojshme për të përballuar këtë situatë, dhe organizatat humanitare kanë ndihmuar në ofrimin e ndihmës emergjente dhe mbështetjes për të prekurit nga konflikti (UNHCR, 2023). Shkatërrimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të rëndësishme është bërë një pengesë e madhe për jetesën e përditshme të qytetarëve të Ukrainës dhe për përpjekjet e rikuperimit pas konfliktit.

Pra, Lufta në Ukrainë është një krizë shumëdimensionale që ka shkaqe të thella dhe rrjedhoja të mëdha. Shkaqet përfshijnë rivalitetet historike dhe identitare, politikën e jashtme të Rusisë dhe aspiratat e Ukrainës për integrim në strukturat perëndimore. Rrjedhokat e konfliktit janë të ndjeshme dhe prekin aspekte të ndryshme të jetës në Ukrainë dhe në rajon. Ndërsa përpjekjet ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktin vazhdojnë, është e qartë se kjo krizë kërkon një angazhim të koordinuar dhe të vazhdueshëm për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme dhe për të ndihmuar në rikuperimin e rajonit.

5.3. Sovraniteti dhe ligji ndërkombëtar

Debati mbi marrëdhënien midis ligjit ndërkombëtar, sovranitetit dhe luftës mbetet një nga çështjet më komplekse dhe të diskutueshme në fushën e studimeve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Në një kontekst ku shtetet synojnë të mbrojnë sovranitetin e tyre, rregullimi dhe kufizimi i përdorimit të forcës ndërkombëtare përballen me sfida dhe kundërshtime të shumta. Për të kuptuar më thellë këto tensione dhe ndërveprime, do të analizohen argumentet kryesore mbi ligjin ndërkombëtar dhe sovranitetin, duke u mbështetur në perspektivat e studiuesve të ndryshëm.

Ligji ndërkombëtar është i ndërtuar mbi parimin që shtetet duhet të respektojnë njëri-tjetrin dhe të zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore. Kartës së Kombeve të Bashkuara, si akti themelor i ligjit ndërkombëtar, ndalon përdorimin e forcës, përveç rasteve të vetëmbrojtjes ose kur është e miratuar nga Këshilli i Sigurimit i KB-së (UN, 1945). Në përpjekje për të mbrojtur rendin ndërkombëtar dhe për të parandaluar luftërat, ky sistem ligjor synon të balancojë interesat e sovranitetit të shteteve dhe kërkesat për ndalimin e përdorimit të forcës. Nga ana tjetër, sovraniteti është një nga parimet bazë që formon struktura e sistemit ndërkombëtar. Ai përfaqëson të drejtën e shteteve për të kontrolluar dhe menaxhuar çështjet e brendshme dhe për të bërë politika të jashtme pa ndërhyrje nga aktorë të tjerë ndërkombëtarë (Donnelly, 2006). Problematika e ndihmës ndërkombëtare për të zgjidhur krizat humanitare ose për të ndaluar shkeljet e ligjit ndërkombëtar, përballen shpesh me sfidat e respektimit të sovranitetit.

Një debat kryesor lidhur me ndërhyrjet ndërkombëtare fokusohet te të drejtat dhe

kufizimet në kuadër të sovranitetit shtetëror. Kriteri i Ndërhyrjes Humanitare justifikon ndërhyrjet kur ato janë të nevojshme për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të parandaluar krime të rënda, si në rastin e *NATO-s në Kosovë (1999) dhe Libisë (2011)* (Evans, 2008). Megjithatë, disa argumentojnë se këto ndërhyrje shpesh shkelin sovranitetin dhe mund të dëmtojnë stabilitetin, duke u bazuar më shumë në interesat e fuqive të mëdha dhe duke dështuar të sigurojnë rezultate të qëndrueshme (Jackson, 2000).

Një tjetër këndvështrim është se rregullat e ligjit ndërkombëtar për ndërhyrjet e huaja janë shpesh të paqarta dhe të ndikuara nga politikë dhe interesa strategjike. Zysset (2022) argumenton se ndihma ndërkombëtare për të mbrojtur të drejtat e njeriut duhet të rregullohet më mirë dhe të jetë në përputhje me parimet e ligjit ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, ndihma ndërkombëtare do të ishte më efektive dhe më e drejtë në ndihmën e atyre që janë të prekur nga shkeljet e rënda. Nga ana tjetër, Walzer (2006) ka mbrojtur idenë se ndërhyrjet për shkak të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut janë të justifikueshme dhe se ligji ndërkombëtar duhet të evoluojë për të mbështetur këtë praktikë. Ai argumenton se ndihma ndërkombëtare është e nevojshme për të mbrojtur individët nga tiranitë dhe shkeljet sistematike të të drejtave, edhe nëse kjo do të thotë të bëhen kompromise me sovranitetin e shteteve.

Pra, debati mbi marrëdhënien midis ligjit ndërkombëtar, sovranitetit dhe luftës është i ndërlikuar dhe përfshin një gamë të gjerë perspektivash dhe argumentesh. Ndërsa ligji ndërkombëtar përpiket të balancojë parimet e sovranitetit dhe ndalimin e përdorimit të forcës, ka shumë debate mbi mënyrat më të mira për të trajtuar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të ruajtur rendin ndërkombëtar. Ndërhyrjet ndërkombëtare shpesh janë të

kontestueshme dhe kërkojnë një analizë të kujdesshme për të siguruar që ato janë të drejtë, efektive dhe në përputhje me rregullat e ligjit ndërkombëtar. Ky debat do të vazhdojë të jetë një temë e rëndësishme në politikën ndërkombëtare dhe studimet e ligjit ndërkombëtar.

Konflikti i vazhdueshëm në Ukrainë, i cili filloi me aneksimin e Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe përshkallëzimin e mëtejshëm me pushtimin e plotë të Ukrainës në vitin 2022, ka tërhequr vëmendjen ndërkombëtare dhe ka ngritur pyetje të rëndësishme mbi aplikimin e ligjit ndërkombëtar. Në këtë kontekst kompleks do të shqyrtohen palët e përfshira në konflikt, ndihma e palëve të treta dhe mënyra se si ligji ndërkombëtar po aplikohet (D'Anieri, 2019).

Në thelb, konflikti në Ukrainë përfshin dy palë kryesore: *Ukraina dhe Rusia*. Ukraina, si një shtet i pavarur, është duke mbrojtur sovranitetin e saj dhe integritetin territorial kundër një agresioni të jashtëm. Nga ana tjetër, Rusia është akuzuar për shkelje të ligjit ndërkombëtar duke aneksuar Krimenë dhe duke mbështetur grupet separatiste në lindje të Ukrainës (Miller, 2021). Në përpjekje për të justifikuar veprimet e saj, Rusia ka pretenduar se ka për qëllim mbrojtjen e popullsisë rusisht-folëse dhe luftimin e terrorizmit, por këto pretendime janë refuzuar nga shumica e komunitetit ndërkombëtar dhe konsiderohen si justifikime për ekspansionizëm dhe shkelje të ligjit ndërkombëtar (Sakwa, 2017).

Ndihma ndërkombëtare për Ukrainën ka përfshirë mbështetje politike, ekonomike dhe ushtarake nga shtete dhe organizata të ndryshme. SHBA-ja, BE-ja dhe aleatët e tjerë kanë ofruar armë, trajnim ushtarak, si dhe ndihmë ekonomike dhe humanitare për të përballuar

krizën (European Council, 2023). Kjo ndihmë mbështetet në parimet e ligjit ndërkombëtar që lejojnë asistencën për shtetet viktimat të agresionit (UN, 1945).

Për të ndikuar në politikën e jashtme të Rusisë, komuniteti ndërkombëtar ka vendosur sanksione të shumta ekonomike dhe politike. Këto sanksione kanë për qëllim të dëmtojnë ekonominë ruse dhe të ushtrojnë presion mbi qeverinë ruse për të ndaluar agresionin dhe për të tërhequr trupat nga territori ukrainas (Baker, 2022). Sanksionet janë një formë e presionit ndërkombëtar që ndihmon në zbatimin e ligjit ndërkombëtar dhe në ruajtjen e rendit ndërkombëtar, megjithëse ndonjëherë ato mund të kenë efekte të paparashikueshme (Smith, 2023).

Ligji ndërkombëtar, përfshirë Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe konventat e tjera ndërkombëtare, kërkon që shtetet të respektojnë sovranitetin e tjetrit dhe të zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore. Konflikti në Ukrainë ka paraqitur sfida të mëdha për zbatimin e këtyre rregullave. Nga njëra anë, ndihma ndërkombëtare dhe sanksionet janë përpjekje për të detyruar shtetet të respektojnë ligjin ndërkombëtar dhe për të ndihmuar viktimat e agresionit. Nga ana tjetër, sfidat përfshijnë efikasitetin e këtyre masave dhe ndikimin e tyre në stabilitetin rajonal dhe global.

Një pyetje kyçe është se sa efikase janë masat ndërkombëtare për të ndikuar në sjelljen e shteteve. Ndihma dhe sanksionet kanë për qëllim të dëmtojnë interesat e shteteve që shkelin ligjin ndërkombëtar dhe të përmirësojnë situatën për viktimat. Sidoqoftë, ka debate në lidhje me efektivitetin e këtyre masave dhe ndikimin e tyre në përpjekjet për zgjidhjen e konfliktit (Smith, 2023). Disa studiues argumentojnë se sanksionet mund të

rrisin tensionet dhe të dëmtojnë më shumë civilët sesa qeveritë që janë targetuar (Baker, 2022).

Ndihma ndërkombëtare për Ukrainën është një aplikim i drejtë i ligjit ndërkombëtar që synon mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve. Nga ana tjetër, e drejta ndërkombëtare e vetëmbrojtjes lejon që shtetet të mbrojnë veten nga agresioni, por ndihma duhet të jetë e përputhshme me normat dhe rregullat ndërkombëtare për të shmangur përshkallëzimin e mëtejshëm të konfliktit (Asada, 2024).

Pra, konflikti në Ukrainë është një shembuj i sfidave që lindin nga përpjekjet për të zbatuar ligjin ndërkombëtar në një botë ku sovraniteti i shteteve dhe ndihma ndërkombëtare janë në tension. Ndihma ndërkombëtare dhe sanksionet janë mjetet kryesore për të ndikuar në sjelljen e shteteve dhe për të mbështetur viktimat e agresionit. Megjithatë, efikasiteti i këtyre masave dhe ndikimi i tyre në zgjidhjen e konfliktit mbetet një temë e diskutueshme që kërkon një analizë të thellë dhe të kujdesshme për të siguruar që ligji ndërkombëtar të zbatohet në mënyrë efektive dhe të drejtë.

5.4. Qëndrimet ndërkombëtare

Konflikti në Ukrainë, i nisur me aneksimin e Krimesë nga Rusia në 2014 dhe përshkallëzimin në 2022, paraqet një sfidë të madhe për ligjin ndërkombëtar. Ky ligj, duke përfshirë Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe rregullat për përdorimin e forcës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është interpretuar ndryshe në lidhje me këtë konflikt (Asada, 2024). Ky rast nxjerr në pah tensionet mes sovranitetit shtetëror dhe nevojës për

mbrojtjen e rendit dhe të drejtave ndërkombëtare, duke sjellë qasje të ndryshme mbi zbatimin e ligjit në këtë kontekst (Ike et al., 2024).

Një nga interpretimet më të rëndësishme është se veprimet e Rusisë janë në shkelje të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Karta e KB-së ndalon përdorimin e forcës, përveç rasteve të vetëmbrojtjes dhe atyre që janë të miratuara nga Këshilli i Sigurimit i KB-së (UN, 1945). Nga kjo këndvështrim, aneksimi i Krimesë dhe ndërhyrjet në lindje të Ukrainës përbëjnë shkelje të sovranitetit të Ukrainës dhe janë të papranueshme sipas ligjit ndërkombëtar. Shtetet e Bashkuara dhe shumica e vendeve perëndimore e kanë dënuar veprimin e Rusisë si agresion dhe kanë kërkuar respektimin e integritetit territorial të Ukrainës (Baker, 2022).

Një tjetër qëndrim është se ndihma ndërkombëtare që Ukraina ka marrë është në përputhje me parimet e ligjit ndërkombëtar. Në përputhje me parimin e vetëmbrojtjes së garantuar nga Karta e KB-së, ndihma për Ukrainën është e justifikueshme si mbështetje për një shtet që po përballet me një agresion të jashtëm (Sakwa, 2017). Ndihma e ofruar nga vendet perëndimore dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë ndihmën ushtarake, ekonomike dhe humanitare, është një aplikim i ligjit ndërkombëtar që synon mbrojtjen e sovranitetit dhe të drejtave të njeriut (European Council, 2023).

Nga ana tjetër, disa kritikë argumentojnë se sanksionet dhe ndihma ndërkombëtare ndaj Ukrainës mund të kenë efekte të papritura dhe ndonjëherë të dëmshme. Disa studiues sugjerojnë se sanksionet mund të rrisin tensionet dhe të përkeqësojnë situatën humanitare, duke ndikuar negativisht në popullatën civile më shumë se në qeverinë që është targetuar

(Smith, 2023). Për më tepër, ndihma ndërkombëtare ka qenë subjekt i kritikave se mund të jetë përdorur për të justifikuar veprime të cilat nuk përkojnë me të gjitha normat e ligjit ndërkombëtar (Baker, 2022).

Një tjetër qasje është ajo e neutralitetit, ku disa aktorë ndërkombëtarë dhe analistë përpiqen të mbajnë një pozicion të ekuilibruar. Ata argumentojnë se ndërhyrjet dhe ndihma ndërkombëtare duhet të jenë të balancuara dhe të drejtuara nga parimet e ligjit ndërkombëtar që përfshijnë neutralitetin dhe respektimin e sovranitetit të të gjitha palëve të përfshira. Kjo qasje sugjeron që çdo ndihmë dhe ndërhyrje duhet të jetë e kufizuar dhe e orientuar në mënyrë që të mos përkeqësojë konfliktin dhe të sigurojë që të gjitha palët të kenë mundësinë për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore (Jackson, 2000).

Gjykatat ndërkombëtare, si Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (ICJ) dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC), gjithashtu kanë luajtur një rol në vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të ndryshme në konfliktin e Ukrainës. Në shumë raste, kërkesa për hetime dhe ndjekje të mundshme për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit janë bërë në këtë kontekst. Këto organizata ndihmojnë në zbatimin e ligjit ndërkombëtar dhe në mbështetje të drejtësisë ndërkombëtare, duke përpjekur të sigurojnë që veprimet e shteteve dhe individëve të jenë në përputhje me normat e pranueshme ndërkombëtare (Ngwang, 2024).

Pra, pozita e ligjit ndërkombëtar për luftën në Ukrainë është komplekse dhe përfshin një mori qëndrimesh dhe perspektivash. Ndërsa shumica e aktorëve ndërkombëtarë e konsiderojnë veprimin e Rusisë si një shkelje të ligjit ndërkombëtar dhe mbështesin ndihmën për Ukrainën si një veprim të drejtë sipas parimeve të ligjit ndërkombëtar,

kritikat dhe sfidat vazhdojnë të jenë të pranishme. Ndihma ndërkombëtare dhe sanksionet janë mjete të rëndësishme për të mbrojtur rendin ndërkombëtar dhe të drejtat e njeriut, por ato gjithashtu duhet të menaxhohen me kujdes për të siguruar që të kontribuojnë në një zgjidhje të qëndrueshme dhe të drejtë për konfliktin.

Implementimi i ligjit ndërkombëtar përbën një sfidë të vazhdueshme për komunitetin ndërkombëtar. Me një gamë të gjerë normash dhe rregullash që rregullojnë marrëdhëniet ndërkombëtare – *që nga Karta e Kombeve të Bashkuara, konventat për të drejtat e njeriut, e deri te ligji humanitar* – përpjekjet për zbatimin e këtyre rregullave shpesh përballen me pengesa të ndryshme. Zbatimi i ligjit ndërkombëtar përfshin si mundësi të rëndësishme për promovimin e paqes dhe drejtësisë, ashtu edhe sfida që burojnë nga mosangazhimi i njëtrajtrashëm i shteteve, mungesa e mekanizmave detyrues dhe ndikimi i interesave gjeopolitike.

Një nga avantazhet kryesore të implementimit të ligjit ndërkombëtar është ruajtja e rendit ndërkombëtar dhe stabilitetit. Normat dhe rregullat ndërkombëtare ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm për shtetet dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë. Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe traktatet e tjera ndërkombëtare krijojnë një kuadër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe parandalimin e konflikteve, duke kontribuar në një rend global më të stabilizuar dhe të paqes (UN, 1945).

Komuniteti ndërkombëtar ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të siguruar respektimin e standardeve humanitare. Konventat ndërkombëtare, si Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa e Gjenevës për ligjin

humanitar ndërkombëtar, ofrojnë mbrojtje për individët dhe grupe të caktuara, dhe përpjekjet për implementimin e këtyre normave ndihmojnë në parandalimin e shkeljeve të drejta dhe krimeve të rënda (Donnelly, 2006). Këto instrumente ndërkombëtare janë themelore për promovimin e standardeve universale dhe për mbështetje ndaj viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Implementimi i ligjit ndërkombëtar kontribuon në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndihmon në krijimin e marrëdhënieve më të mira midis shteteve. Marrëveshjet ndërkombëtare dhe traktatet krijojnë mundësi për bashkëpunim në fusha të ndryshme, si tregtia, siguria, dhe mjedisi. Këto marrëveshje ndihmojnë në ndihmën e shteteve për të zgjidhur probleme të përbashkëta dhe për të arritur qëllime të përbashkëta në një mënyrë të organizuar dhe të ndihmuar nga ligji (Jackson, 2000).

Një nga dobësitë kryesore të ligjit ndërkombëtar është mungesa e ekzekutimit të detyrueshëm dhe efikas. Shpesh, normat ndërkombëtare janë joefektive për shkak të mungesës së mekanizmave të fuqishëm për zbatimin dhe ndëshkimin e shkelësve, ndërsa sanksionet kanë efekt të kufizuar (Smith, 2023). Për më tepër, implementimi i ligjit ndërkombëtar shpesh ndikohet nga interesat e shteteve të fuqishme, të cilat mund të përdorin ndikimin e tyre për të favorizuar qëllimet e veta, duke krijuar pabarazi dhe pasiguri për shtetet më të dobëta (Miller, 2021).

Interpretimet e ndryshme dhe paqartësitë në ligjin ndërkombëtar shpesh shkaktojnë konflikte dhe vështirësi në zbatim midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare (Beitz, 2012). Këto mosmarrëveshje dobësojnë efektivitetin e ligjit dhe sfidojnë mbështetjen për

rendin ndërkombëtar dhe të drejtat e njeriut. Komuniteti ndërkombëtar ka bërë përpjekje për të mbrojtur stabilitetin dhe bashkëpunimin global, por mungesa e mekanizmave efektivë të zbatimit dhe ndikimi i fuqive të mëdha mbeten sfida kryesore. Për përmirësim, është e nevojshme të forcohen mekanizmat e zbatimit dhe të sigurohet trajtim i barabartë në interpretimin dhe aplikimin e ligjit ndërkombëtar.

5.5. Sfida dhe përmirësimi i ligjit

Ligji ndërkombëtar është një sistem kompleks normash dhe rregullash që rregullon marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Në një botë gjithnjë e më të ndërruar, efektiviteti dhe zbatimi i ligjit ndërkombëtar janë të rëndësishëm për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe drejtësisë globale. Megjithatë, aktualisht ekzistojnë disa dobësi dhe sfida në zbatimin e ligjit ndërkombëtar dhe të institucioneve që e mbështesin atë (Ali & Mousa, 2024). Ky debat ka për qëllim të shqyrtojë argumentet kryesore për përmirësimin e ligjit ndërkombëtar dhe të institucioneve që mbështesin zbatimin e tij, duke analizuar avantazhet dhe dobësitë e ndryshme që lidhen me këtë proces.

Një nga argumentet kryesore për reformën e ligjit ndërkombëtar lidhet me nevojën për t'u përshtatur me sfidat moderne si teknologjia, ndryshimet klimatike dhe migracioni global. Normat ekzistuese shpesh janë të fragmentuara dhe të paqarta, veçanërisht në fushat si mbrojtja e mjedisit dhe e të drejtave të punëtorëve (Krasner, 2001). Megjithatë, reforma mbetet e vështirë për shkak të interesave të kundërta të shteteve të fuqishme dhe mungesës së konsensusit ndërkombëtar, duke e bërë procesin të ngadaltë dhe shpesh joefektiv (Miller, 2021).

Një tjetër argument është se institucionet ndërkombëtare duhet të forcohen për të përmirësuar zbatimin e ligjit ndërkombëtar. Institucione si Kombet e Bashkuara, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (ICJ) dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC) kanë luajtur role të rëndësishme në promovimin dhe mbrojtjen e ligjit ndërkombëtar, por shpesh hasin në kufizime për shkak të mungesës së fuqisë dhe mbështetjes nga shtetet (UN, 1945). Forcimi i këtyre institucioneve mund të përmirësojë efikasitetin e tyre dhe të sigurojë një zbatim më të mirë të ligjit ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, forcimi i institucioneve ndërkombëtare përballet me disa sfida dhe dobësi. Disa prej këtyre institucioneve janë të varura nga vullneti i shteteve anëtare për të zbatuar dhe për të mbështetur normat ndërkombëtare. Për shembull, vendimmarrja në Këshillin e Sigurimit të KB-së shpesh ndalet nga vetoja e shteteve të fuqishme, duke e bërë të vështirë për të vepruar në mënyrë efektive në situata krize (Smith, 2023). Këto kufizime mund të dëmtojnë efikasitetin e institucioneve ndërkombëtare dhe të pengojnë përpjekjet për të adresuar krizat dhe për të zbatuar ligjin ndërkombëtar në mënyrë të drejtë dhe të efektshme.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në debatin për përmirësimin e ligjit ndërkombëtar është roli i shteteve të fuqishme dhe ndikimi i interesave të tyre kombëtare. Shtetet e fuqishme shpesh kanë ndikim të madh në formësimin dhe zbatimin e ligjit ndërkombëtar, duke ndikuar në mënyrën se si normat ndërkombëtare interpretohen dhe zbatohen (Krasner, 2001). Këto interesa mund të çojnë në pabarazi në zbatimin e ligjit dhe të dëmtojnë besueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit ndërkombëtar.

Përpyjekjet për të balancuar interesat kombëtare dhe për të siguruar një zbatim të drejtë të ligjit ndërkombëtar përfshijnë krijimin e mekanizmave më të mirë për përfaqësim dhe vendimmarrje të balancuar në institucione ndërkombëtare. Rritja e përfaqësimit të vendeve të vogla dhe të mesme në këto institucione dhe sigurojnë që interesat e tyre të merren parasysh mund të ndihmojë në përmirësimin e balancës dhe drejtësisë në zbatimin e ligjit ndërkombëtar (Beitz, 2012).

Pra, debati për përmirësimin e ligjit ndërkombëtar dhe të institucioneve për zbatimin e tij është shumëdimensional dhe përfshin disa aspekte të ndryshme. Avantazhet e reformave dhe forcimit të institucioneve përfshijnë përmirësimin e efikasitetit dhe relevancës së ligjit ndërkombëtar, si dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe stabilitetit ndërkombëtar. Megjithatë, sfidat dhe dobësitë përfshijnë vështirësitë në implementim, ndikimin e shteteve të fuqishme dhe kufizimet e institucioneve ndërkombëtare. Për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar ligjin ndërkombëtar dhe institucionet që e mbështesin atë, është e nevojshme një përpjekje e koordinuar dhe e angazhuar nga të gjitha palët e përfshira në nivel global.

Lufta në Ukrainë, një nga konfliktet më të rëndësishëm dhe më të ndërlikuar në Evropë në dekadat e fundit, ka tërhequr vëmendjen dhe ka provokuar reagime të ndryshme nga personalitete të njohura akademike dhe politike, të cilët ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi shkaqet, pasojat dhe mundësitë për zgjidhje. Këto qëndrime reflektojnë jo vetëm analizat akademike, por edhe interesat dhe politikat e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare. Ky seksion do të shqyrtojë disa nga këto qëndrime, duke përfshirë ato të

John Mearsheimer, Timothy Snyder, Fiona Hill, Jeffrey Sachs, si dhe personaliteteve politike të rëndësishme si Volodymyr Zelenskyy, Vladimir Putin, Joe Biden, Ursula von der Leyen, Emmanuel Macron dhe Boris Johnson.

Mearsheimer (2014), profesor në Universitetin e Chicagos dhe një teoricienë i njohur i realizmit ndërkombëtar, ka ofruar një analizë të thellë mbi luftën në Ukrainë, duke e parë atë si një pasojë të zgjerimit të NATO-s dhe politikave ekspansioniste të Perëndimit. Sipas Mearsheimer, përpjekjet e Perëndimit për të integruar Ukrainën në strukturat e sigurisë perëndimore, si NATO dhe Bashkimi Evropian, kanë provokuar reagimin e Rusisë dhe kanë kontribuar në përshkallëzimin e konfliktit. Mearsheimer argumenton se zgjerimi i NATO-s ka krijuar një ndjenjë kërcënimi në Moskë, duke e shtyrë atë të ndërmarrë hapa ushtarakë për të mbrojtur interesat e saj strategjike. Ai sugjeron që një qasje më e balancuar, që do të respektonte interesat e sigurisë të Rusisë, mund të kishte ndihmuar në parandalimin e krizës dhe stabilizimin e rajonit.

Ndryshe nga Mearsheimer, Snyder (2022), historian dhe profesor në Universitetin e Yale, e shikon luftën në Ukrainë si një akt të agresionit të drejtpërdrejtë nga Rusia, që synon rivendosjen e ndikimit të saj në Evropën Lindore. Snyder argumenton se mbështetje ndërkombëtare për Ukrainën është thelbësore për të kundërshtuar agresionin dhe për të ruajtur rendin ndërkombëtar. Ai thekson se solidariteti global është kyç për të mbrojtur të drejtat e Ukrainës dhe për të siguruar që agresionet e tilla të mos kalojnë pa u ndëshkuar. Në këtë kuadër, Snyder inkurajon një përgjigje të fuqishme dhe të koordinuar nga vendet perëndimore, duke përfshirë sanksione ekonomike dhe mbështetje të vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Ukrainës.

Hill, (2022), eksperte e politikës ndërkombëtare dhe anëtare e Këshillit të Sigurimit të SHBA-së, ka shqyrtuar ndikimin e luftës në Ukrainë jo vetëm në nivelin politik, por edhe në nivelin humanitar dhe ekonomik. Ajo ka theksuar se ndikimi i luftës është shkatërrues për civilët ukrainas dhe ka shkaktuar një krizë të rëndë refugjatësh. Hill thekson nevojën për angazhimin e komunitetit ndërkombëtar në ofrimin e ndihmës humanitare dhe mbështetje për ata që janë prekur nga konflikti. Ajo gjithashtu argumenton se mbështetja ndërkombëtare është e domosdoshme për lehtësimin e pasojave të luftës dhe për trajtimin e krizave humanitare që po ndodhin si pasojë e konfliktit.

Nga ana tjetër, ekonomisti Sachs, (2022), profesor në Universitetin e Kolumbisë, ka shqyrtuar ndikimet ekonomike të luftës në Ukrainë dhe më gjerë. Ai thekson se lufta ka pasur pasoja të rënda ekonomike për Ukrainën, duke përfshirë shkatërrimin e infrastrukturës dhe rënien e ekonomisë, si dhe ka shkaktuar krizën e energjisë dhe probleme me zinxhirët e furnizimit global. Sachs argumenton se përpjekjet e koordinuara ndërkombëtare janë të nevojshme për të adresuar dhe lehtësuar ndikimet ekonomike të luftës, duke ofruar mbështetje ekonomike për Ukrainën dhe duke punuar për të stabilizuar ekonominë globale.

Në nivelin politik, lufta në Ukrainë ka provokuar qëndrime të ndryshme nga personalitetet kryesore ndërkombëtare, duke reflektuar një gamë të gjerë politikash dhe qëndrimesh. Volodymyr Zelenskyy, Presidenti i Ukrainës, ka kërkuar mbështetje të fuqishme ndërkombëtare për të kundërshtuar agresionin rus dhe ka theksuar rëndësinë e mbrojtjes së demokracisë dhe vlerave evropiane. Ai ka bërë thirrje për sanksione të ashpra ndaj

Rusisë dhe për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Ukrainës (Smith, 2023). Vladimir Putin, Presidenti i Rusisë, ka mbrojtur ndërhyrjen e Rusisë në Ukrainë si një nevojë për të mbrojtur interesat strategjike të Rusisë dhe për të mbrojtur popullsinë rusisht-folëse në Ukrainë. Putin e sheh këtë ndërhyrje si një përgjigje ndaj kërcënimeve të perceptuara nga NATO dhe ndikimeve perëndimore (Mbah & Wasum, 2022).

Joe Biden, Presidenti i Shteteve të Bashkuara, ka shprehur mbështetje të fortë për Ukrainën, duke ofruar ndihmë ushtarake dhe duke aplikuar sanksione të rrepta ndaj Rusisë. Ai thekson rëndësinë e unitetit ndërkombëtar dhe koordinimin e veprimeve për të mbështetur Ukrainën dhe për të ndaluar agresionin rus (Johnson, 2023). Ursula von der Leyen, Presidentja e Komisionit Evropian, ka udhëhequr përpjekjet për të vendosur sanksione ndaj Rusisë dhe për të ofruar mbështetje ekonomike dhe humanitare për Ukrainën, duke theksuar solidaritetin evropian (Barker, 2023).

Emmanuel Macron, Presidenti i Francës, ka mbajtur një qëndrim të balancuar, duke mbështetur mbrojtjen e Ukrainës dhe kërkuar një zgjidhje diplomatike për konfliktin. Ai ka kërkuar një qasje të mençur për të arritur një marrëveshje paqeje, duke theksuar rëndësinë e dialogut (Tobin, 2023). Boris Johnson, ish-Kryeministër i Britanisë së Madhe, ka mbështetur fuqishëm Ukrainën, duke udhëhequr përpjekjet për të ofruar ndihmë ushtarake dhe për të vendosur sanksione ndaj Rusisë. Ai ka theksuar nevojën për një përgjigje të koordinuar ndërkombëtare ndaj krizës (Clark, 2023).

Qëndrimet e personaliteteve të shquara akademike dhe politike mbi luftën në Ukrainë pasqyrojnë një gamë të gjerë analizash dhe pikëpamjesh të ndryshme, duke përfshirë

aspektet e sigurisë, diplomacisë, humanitarizmit dhe ekonomisë. Ky konflikt ka nxjerrë në pah tensionet e thella ndërkombëtare dhe ka kërkuar një përgjigje të koordinuar dhe të fuqishme nga komuniteti ndërkombëtar. Sipas këtyre qëndrimeve, është e qartë se përpjekjet për një zgjidhje të qëndrueshme dhe paqësore kërkojnë një balancë mes forcës dhe diplomacisë, mbështetjes për viktimat e luftës dhe ruajtjes së stabilitetit ndërkombëtar.

5.6. Ndikimet në sistemin ndërkombëtar

Njohja e zbatimit të ligjit ndërkombëtar në Ukrainë është një çështje e rëndësishme që ka pasur ndikime të shumta, jo vetëm për këtë shtet, por për të gjithë komunitetin ndërkombëtar. Lufta në Ukrainë, që ka nisur në vitin 2014 me aneksimin e Krimesë nga Rusia dhe është intensifikuar në shkallë të gjerë që nga 2022, ka vënë në dyshim vlerat dhe principet që mbështesin rendin global të bazuar në ligjin ndërkombëtar. Ky konflikt, me pasojat e tij shumëdimensionale, ka nxjerrë në pah rëndësinë e zbatimit të ligjit ndërkombëtar për ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë ndërkombëtare (Demir, 2022). Analiza e kësaj çështjeje ndihmon në kuptimin e ndikimeve që ka për shtetet e tjera dhe për rendin ndërkombëtar në përgjithësi.

Njohja dhe zbatimi i ligjit ndërkombëtar në rastin e Ukrainës ka luajtur një rol kyç në mbrojtjen e sovranitetit dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës. Ukraina ka kërkuar mbështetje nga organizata ndërkombëtare si OKB dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për të kundërshtuar agresionin rus dhe aneksimin e Krimesë, duke u mbështetur në parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial (Imoedemhe, 2023). Gjithashtu,

shkeljet nga forcat ruse ndaj civilëve dhe përdorimi i armëve të ndaluara janë trajtuar në kuadër të Konventave të Gjenevës dhe Statutit të Romës, duke theksuar rëndësinë e drejtësisë penale ndërkombëtare (Aladekomo, 2022).

Njohja e zbatimit të ligjit ndërkombëtar në Ukrainë ka qenë një test për institucionet ndërkombëtare, të cilat janë ngarkuar me mbrojtjen e parimeve të tij. Kombet e Bashkuara, për shembull, janë angazhuar për të siguruar që konflikti të trajtohet në përputhje me të drejtat ndërkombëtare dhe që përgjegjësit për shkeljen e ligjit të mbajnë përgjegjësi. Megjithatë, ky proces është shoqëruar me vështirësi, për shkak të fuqisë dhe ndikimit të shteteve të mëdha, veçanërisht Rusisë, e cila ka përdorur të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit për të penguar ndërhyrjet e mundshme (UNSC, 2022). Në këtë kontekst, shtetet e tjera kanë një rol të rëndësishëm për të mbështetur dhe për të siguruar që ligji ndërkombëtar të zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe veprimeve të koordinuara, mund të parandalohet abuzimi i sistemit ndërkombëtar dhe të sigurohet që vendet agresorë të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e ligjit ndërkombëtar. Shtetet mund të përfshihen në mënyra të ndryshme, duke përfshirë *mbështetje politike, ekonomike dhe ushtarake* për viktimat e agresionit dhe duke ofruar ndihmë humanitare për të përballuar pasojat e luftës (Barker, 2023).

Zbatimi i ligjit ndërkombëtar në rastin e Ukrainës është thelbësor për ruajtjen e sigurisë globale. Ky konflikt ka treguar se shkeljet e ligjit nga një shtet mund të krijojnë precedentë të rrezikshëm. Mbështetja për sovranitetin e Ukrainës dhe ndëshkimi i agresionit rus janë hapa të domosdoshëm për të garantuar paqen dhe për të mbrojtur shtetet më të vogla nga kërcënimet e ngjashme.

Për shembull, shtetet e vogla që janë në rrezik të ngjashëm, si Moldavia dhe Gjeorgjia, mund të shohin në këtë rast një mundësi për të forcuar lidhjet me organizata ndërkombëtare si NATO dhe Bashkimi Evropian për të siguruar mbrojtjen e integritetit të tyre territorial. Po ashtu, kjo mund të ndihmojë në zhvillimin e politikave të mbrojtjes që janë të bazuara në ligjin ndërkombëtar dhe që mbështesin sigurinë kolektive (Snyder, 2022).

Moszbatimi i ligjit ndërkombëtar ka pasoja të rënda për të ardhmen e rendit ndërkombëtar. Nëse shtetet e mëdha, si Rusia, mund të shkelin me lehtësi parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial pa pasur pasoja, kjo mund të inkurajojë edhe shtetet e tjera të veprojnë në mënyrë të ngjashme, duke minuar sistemin e ligjit ndërkombëtar. Kjo do të çonte në një rend botëror më të ndarë dhe më të pasigurt, ku agresioni dhe konflikti do të bëhen norma, dhe jo përjashtim. Prandaj, është e domosdoshme që shtetet dhe organizatat ndërkombëtare të angazhohen për zbatimin e ligjit dhe për të siguruar që shkelësit të mbajnë përgjegjësi (Musa & Shehaj, 2023).

Njohja e zbatimit të ligjit ndërkombëtar në Ukrainë është e rëndësishme jo vetëm për këtë shtet, por për të gjithë rendin ndërkombëtar. Ky konflikt ka treguar se paqja dhe stabiliteti ndërkombëtar varen nga respektimi i ligjit ndërkombëtar dhe nga angazhimi i shteteve për të siguruar që agresionet dhe shkeljet e tij të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Shtetet e tjera, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme, mund të përfitojnë nga ky proces duke siguruar mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të tyre. Për më tepër, mbështetja për Ukrainën dhe zbatimi i ligjit ndërkombëtar është një mjet i fuqishëm për

të parandaluar dhunën dhe për të ruajtur rendin dhe sigurinë globale.

5.7. Mësime dhe rekomandime

Lufta në Ukrainë, e filluar në vitin 2014 dhe intensifikuar me pushtimin e plotë të Rusisë në vitin 2022, ka paraqitur sfida të mëdha për ligjin ndërkombëtar dhe për organizatat ndërkombëtare që kanë për qëllim menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve (Moseiko, 2022). Ky studim rasti analizon këto sfida dhe ofron mësime dhe rekomandime për përmirësimin e menaxhimit të situatave të ngjashme në të ardhmen.

Pushtimi rus në Ukrainë ka rezultuar në shkelje të shumta të të drejtave të njeriut dhe ligjit ndërkombëtar të humanitarizmit. Raportet për përdorimin e forcës ndaj civilëve dhe shkeljet e konventave të Gjenevës janë të shumta (Amnesty International, 2023). Nevojitet një sistem më i fuqishëm për monitorimin dhe ndëshkimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe ligjit ndërkombëtar të humanitarizmit. Organizatat ndërkombëtare duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre për mbledhjen dhe verifikimin e informacionit në zona konflikti (Human Rights Watch, 2023).

Organizatave ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara (OKB) dhe Bashkimi Evropian (BE) u është dashur të përballen me sfida të koordinimit dhe efektivitetit në menaxhimin e krizës. Disa kritikë kanë theksuar se ndihma humanitare dhe mbështetja për Ukrainën kanë qenë të shpërndara dhe jo të koordinuara në mënyrë optimale (Baker, 2022). Është e rëndësishme që organizatat ndërkombëtare të përmirësojnë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre për të maksimizuar ndikimin e ndihmës dhe mbështetjes.

Ndërhyrjet duhet të jenë të integruara dhe të bazuara në një strategji të qartë dhe të koordinuar (Sweeney, 2024).

Sanksionet e vendosura ndaj Rusisë nga vendet perëndimore dhe organizatat ndërkombëtare kanë shpesh pasur efekt të kufizuar në ndalimin e agresionit dhe në ndryshimin e politikës së jashtme të Rusisë (Jones, 2023). Nevojitet një analizë më e thellë dhe një formulim më strategjik i sanksioneve për të rritur efektivitetin e tyre. Sanksionet duhet të jenë të drejtuara dhe të përqendruara në sektorë kritikë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në politikat e qeverisë dhe ekonominë e vendit agresor (Johnson, 2023).

Diplomacia dhe përpjekjet për zgjidhjen e konfliktit janë përballur me vështirësi të mëdha për të arritur një marrëveshje paqeje që do të përmbushë kërkesat e të gjitha palëve të përfshira (Klein, 2023). Është e nevojshme të intensifikohen përpjekjet diplomatike dhe të përfshihen të gjitha palët relevante në dialogun për paqe. Proceset e zgjidhjes së konfliktit duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të mbështetura nga një platformë ndërkombëtare e fortë që garanton një angazhim të sinqertë nga të gjitha palët (Miller, 2021).

Forcimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe ligjit ndërkombëtar të humanitarizmit është thelbësor. Organizatat ndërkombëtare duhet të krijojnë dhe të përdorin sisteme të avancuara për mbledhjen e dëshmive dhe ndëshkimin e shkelësve (Amnesty International, 2023). Është e nevojshme të krijohet një qendër të koordinuar ndërkombëtarisht që të menaxhojë ndihmën humanitare dhe përpjekjet për

mbështetje në mënyrë më të efektshme. Ky mekanizëm do të ndihmojë në evitimin e dyfishimit dhe në maksimizimin e ndikimit të ndihmës (Baker, 2022).

Përmirësimi i strategjive të sanksioneve dhe rritja e pjesëmarrjes ndërkombëtare janë të nevojshme për të rritur presionin ndaj agresorëve dhe për të ndihmuar në ndalimin e konflikteve. Sanksionet duhet të jenë të fokusuar dhe të mirëmenduara për të pasur një ndikim të qëndrueshëm (Jones, 2023). Diplomacia duhet të jetë e intensifikuar dhe e gjithëpërfshirëse, duke përfshirë të gjitha palët relevante në bisedimet për paqe. Krijimi i një platforme ndërkombëtare për mbështetje të vazhdueshme dhe ndihmë në procesin e zgjidhjes së konfliktit është i rëndësishëm për arritjen e marrëveshjeve të qëndrueshme (Klein, 2023).

Pra, Lufta në Ukrainë ka nxjerrë në pah sfida të mëdha për ligjin ndërkombëtar dhe për organizatat ndërkombëtare. Mësimet e nxjerra nga kjo krizë sugjerojnë nevojën për përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe ndëshkimit, rritjen e koordinimit ndërkombëtar, përmirësimin e strategjive të sanksioneve dhe intensifikimin e diplomacisë për paqe. Përmirësimi në këto fusha do të ndihmojë në menaxhimin më efektiv të krizave të ngjashme në të ardhmen dhe në mbrojtjen e rendit ndërkombëtar.

Konflikti në Ukrainë ka nxjerrë në pah disa mësimet të rëndësishme për vendet e vegjël, ligjin ndërkombëtar dhe institucionet ndërkombëtare. Vendet e vegjël kanë mësuar rëndësinë e pjesëmarrjes në aleanca dhe koalicione ndërkombëtare për të forcuar sigurinë dhe për të pasur një zë më të fuqishëm në arenën ndërkombëtare. Konflikti në Ukrainë ka ilustruar se vendet e vogla mund të përfitojnë nga bashkëpunimi me partnerët strategjikë

dhe nga përfshirja në organizata ndërkombëtare si NATO dhe Bashkimi Evropian për të siguruar mbrojtje dhe mbështetje në rast të kërcënimeve (Klein, 2023).

Vendet e vogla duhet të forcojnë kapacitetet mbrojtëse për të parandaluar agresionet e jashtme, siç tregoi konflikti në Ukrainë, ku vendet më të përgatitura ruajtën më mirë sovranitetin dhe stabilitetin (Wivel, 2023). Gjithashtu, duhet të zhvillojnë strategji të fuqishme diplomatike për të menaxhuar marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për të mbrojtur interesat kombëtare, duke kontribuar në zgjidhjen e krizave (Smith, 2023).

Konflikti në Ukrainë ka theksuar nevojën për forcimin e mekanizmave të zbatimit të ligjit ndërkombëtar humanitar, pasi shkeljet e të drejtave të njeriut kanë qenë të shpeshta, duke treguar nevojën për struktura më të fuqishme për monitorim dhe ndëshkim (Jones, 2023). Gjithashtu, ka evidentuar rëndësinë e rritjes së koordinimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ku organizatat dhe shtetet duhet të punojnë më mirë së bashku për të menaxhuar krizën në mënyrë efektive dhe për të shmangur ndihmën e paorganizuar (Miller, 2024).

Efektiviteti i sanksioneve është shpesh i kufizuar, dhe ka nevojë për rishikim dhe përmirësim. Konflikti në Ukrainë ka treguar se sanksionet duhet të jenë të drejtuara dhe të mirëmenduara për të pasur një ndikim të qëndrueshëm dhe për të ndryshuar politikat e qeverive agresore (Clark, 2023). Pra, Konflikti në Ukrainë ka ofruar mësim të vlefshme për vendet e vegjël dhe për institucionet ndërkombëtare në lidhje me përgatitjen për kriza, forcimin e kapaciteteve mbrojtëse, dhe përmirësimin e koordinimit dhe zbatimit të ligjit ndërkombëtar. Përmes analizës së këtyre mësimave, është e mundur të zhvillohen

strategji dhe politika më efektive për të përballuar dhe menaxhuar krizën në të ardhmen dhe për të siguruar një rend ndërkombëtar më të qëndrueshëm dhe të drejtë.

5.8. Konkluzione

Lufta në Ukrainë ka përfaqësuar një nga sfidat më të mëdha për të drejtën ndërkombëtare dhe arkitekturën e sigurisë globale në shekullin XXI. Ndërhyrja e Rusisë, që prej vitit 2014, ka vënë në provë parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial, duke sfiduar mekanizmat ekzistues të ligjit ndërkombëtar për parandalimin e agresionit dhe mbrojtjen e shteteve sovrane. Ky konflikt ka nxjerrë në pah vështirësitë në zbatimin efektiv të ligjit ndërkombëtar, sidomos në rastet kur aktorë të fuqishëm sfidojnë rregullat e vendosura dhe përdorin fuqinë ushtarake për të arritur objektivat e tyre strategjike.

Debatet mbi rolin dhe efektivitetin e ligjit ndërkombëtar në këtë luftë tregojnë se edhe pse ekzistojnë instrumente ligjore për të dënuar dhe sanksionuar shkeljet, implementimi i tyre mbetet i ndërlikuar për shkak të dinamikave politike dhe fuqisë së shteteve në sistemin ndërkombëtar. Rastet e krimeve të luftës, shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe përdorimit të forcës në kundërshtim me normat ndërkombëtare kanë rritur thirrjet për një reformë të mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare, si dhe për forcimin e mekanizmave detyrues për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Gjithashtu, ky konflikt ka pasur ndikime të thella jo vetëm për Ukrainën, por edhe për rendin ndërkombëtar më gjerë. Mënyra se si komuniteti ndërkombëtar ka reaguar, përmes sanksioneve, mbështetjes ushtarake dhe diplomatike për Ukrainën, si dhe përpjekjeve për të izoluar Rusinë në forume ndërkombëtare, ka krijuar një precedent për trajtimin e konflikteve të ardhshme. Zbatimi i ligjit ndërkombëtar në Ukrainë do të ketë ndikime të gjera për mënyrën se si shtetet dhe organizatat ndërkombëtare trajtojnë çështje të ngjashme në të ardhmen, duke përcaktuar kufijtë e tolerancës ndaj shkeljeve të normave ndërkombëtare.

Në përfundim, lufta në Ukrainë ka theksuar nevojën për një qasje më të fortë dhe koherente në zbatimin e ligjit ndërkombëtar, për të parandaluar agresionet e ardhshme dhe për të mbrojtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Ajo ka treguar gjithashtu se mungesa e një përgjigjeje të shpejtë dhe të bashkërenduar në fazat e para të konfliktit mund të çojë në përshkallëzim të dhunës dhe pasoja afatgjata për sigurinë globale.

Mësimet e nxjerra nga ky konflikt janë thelbësore për të ardhmen e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe për forcimin e institucioneve të drejtësisë ndërkombëtare, duke garantuar që parimet e *sovrانيتit, integritetit territorial dhe të drejtave të njeriut* të mbeten të mbrojtura dhe të zbatueshme në praktikë.

KAPITULLI VI: ANALIZË KRAHASUESE.

6.1. Hyrje

Ky kapitull përqendrohet në një analizë të thelluar dhe krahasuese të ndërhyrjeve ndërkombëtare në tre raste specifike: Shqipëria në vitin 1997, Kosova në vitin 1999 dhe Ukraina nga viti 2014 deri më sot. Qëllimi i këtij kapitulli është të identifikojë dhe vlerësojë faktorët që kanë ndikuar në suksesin ose dështimin e ndërhyrjeve ndërkombëtare, duke përfshirë kontekstin politik, strategjitë e zbatuara dhe ndikimin e aktorëve ndërkombëtarë, me një fokus të veçantë në rolin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në këtë analizë do të shqyrtojmë sesi faktorë të tillë si legjitimiteti ndërkombëtar, interesat kombëtare të fuqive të mëdha dhe fuqia e vetos kanë ndikuar në zbatimin ose pengimin e ndërhyrjeve në secilin rast.

Pjesa e parë e kapitullit krahason faktorët kryesorë që ndihmojnë ose pengojnë ndërhyrjet, duke nxjerrë në pah se si Ligji Ndërkombëtarë dhe Këshilli i Sigurimit ka luajtur një rol qendror në ndërhyrjet shumëpalëshe, përmes mbështetjes ose bllokimit të veprimeve ndërkombëtare. Analiza do të tregojë se ndërhyrjet që kanë pasur një mbështetje të gjerë nga Këshilli i Sigurimit janë karakterizuar shpesh nga një legjitimitet i fuqishëm, ndërkohë që ndërhyrjet pa një mandat të qartë kanë qenë më të debatueshme dhe të ndërlikuara në aspektin diplomatik.

Pjesa e dytë e kapitullit vlerëson aspektet e përbashkëta dhe dallimet e ndërhyrjeve në këto tre raste. Elementët si natyra e krizave, mënyra e reagimit të fuqive të mëdha, përdorimi i forcës dhe përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë do të vlerësohen për të ilustruar

se si ndërhyrjet ndërkombëtare mund të jenë të ndryshme, por shpesh ndajnë sfida dhe karakteristika të përbashkëta. Krahasimi synon të ofrojë një pasqyrë të qartë të mësimave të nxjerra nga këto raste për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë për një ndërhyrje të efektshme dhe të drejtë.

6.2. Konteksti gjeopolitik

Ndërhyrjet ndërkombëtare shpesh formohen dhe përcaktohen nga konteksti gjeopolitik në të cilin zhvillohen. Në këtë kontekst shqyrtojmë sesi ndryshimet në politikën ndërkombëtare, aleancat rajonale dhe interesat strategjike ndikuan në ndërhyrjet në *Shqipëri (1997), Kosovë (1999) dhe Ukrainë (2014-2024)*. Rëndësia e këtij diskutimi qëndron në analizën e faktorëve që përcaktojnë suksesin ose dështimin e ndërhyrjeve ndërkombëtare në periudha të ndryshme.

Shqipëria 1997. Në vitin 1997, Shqipëria përjetoj një krizë të thellë sociale, politike dhe ekonomike, pas rënies së skemave piramidale që lanë vendin në kaos. Konteksti ndërkombëtar i kohës karakterizohej nga përpjekjet e vendeve evropiane për të ruajtur stabilitetin në një rajon që tashmë ishte i trazuar nga luftërat e ish-Jugosllavisë. Bashkimi Evropian dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) i dhanë përparësi ndërhyrjes për të parandaluar përhapjen e destabilitetit në Ballkan. Krijimi i operacionit “Alba”, një ndërhyrje e udhëhequr nga Italia dhe miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, u bë një shembull i ndërhyrjes ndërkombëtare për ruajtjen e rendit dhe të stabilitetit (Pettifer & Vickers, 2007). Kriza e piramidave në Shqipëri ndodhi në një periudhë të rëndësishme për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Pas disa viteve

trazirash dhe konflikteve në ish-Jugosllavi, komuniteti ndërkombëtar ishte i ndjeshëm ndaj mundësisë që kriza e brendshme në Shqipëri të shpërthente dhe të përkeqësonte tensionet rajonale.

Qasja për të ndërhyrë u motivua nga frika e përhapjes së paqëndrueshmërisë, me BE-në dhe OSBE-në që kërkonin të ruanin stabilitetin në një rajon delikat. Ndërhyrja u mbështet nga një mandatar i qartë i OKB-së, duke e bërë këtë operacion të suksesshëm në parandalimin e përshkallëzimit të krizës (Bezemer, 2006). Vendimi për ndërhyrje ilustron rëndësinë e aleancave rajonale dhe mbështetjen ndërkombëtare për të krijuar një bazë të qëndrueshme për rendin publik. Ndërhyrja në Shqipëri u mbështet nga shtetet perëndimore me interes për të parandaluar përhapjen e kaosit që mund të ndikonte në fqinjët, veçanërisht në Maqedoninë dhe Greqinë. Një destabilizim i mëtejshëm i Shqipërisë mund të çonte në kriza refugjatësh dhe tensione etnike në rajon, prandaj ndërhyrja u pa si një mënyrë për të ruajtur paqen në të gjithë Ballkanin.

Kosova 1999: ndërhyrja e NATO-s. Ndërhyrja në Kosovë në vitin 1999 u zhvillua në një kontekst gjeopolitik krejtësisht të ndryshëm nga ai i Shqipërisë. Konflikti midis forcave serbe dhe shqiptarëve të Kosovës shkaktoi një krizë humanitare masive që tërhoqi vëmendjen e NATO-s. Pas dështimit të diplomacisë ndërkombëtare dhe refuzimit të Serbisë për të përmbushur kërkesat e marrëveshjes së Rambujesë, NATO ndërmori një ndërhyrje ushtarake pa një mandat të qartë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke argumentuar nevojën për të ndaluar një katastrofë humanitare (Tiku, 2024).

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë ishte një përgjigje ndaj dështimit të përpjekjeve

diplomatieke për të zgjidhur krizën humanitare në rajon. Konteksti gjeopolitik në fund të viteve 1990 u karakterizua nga ndërgjegjësimi i fuqive perëndimore për nevojën e ndërhyrjeve humanitare, të nxitur nga precedentët e Bosnjës. Ndërhyrja u bë një rast i rëndësishëm për legjitimitetin e veprimeve ndërkombëtare pa një mandat të drejtpërdrejtë të OKB-së. Ndërhyrja ishte gjithashtu një përpjekje për të ruajtur prestigjin dhe autoritetin e NATO-s si një organizatë e sigurisë kolektive (Caplan, 2005). Në këtë rast, rëndësia strategjike e Kosovës si një pikë qendrore në Ballkan dhe kërcënimet ndaj stabilitetit rajonal çuan në vendime që tejkaluan diplomacinë tradicionale.

Ndryshimet e politikës ndërkombëtare. Në fund të viteve 1990, Perëndimi ishte i gatshëm të vepronte unilateralisht në mungesë të një konsensusi në OKB, për shkak të ndarjeve të thella midis fuqive perëndimore dhe Rosisë. Ndërhyrja në Kosovë pasqyroi gjithashtu politikën e zgjerimit të NATO-s dhe përpjekjet për të konsoliduar ndikimin perëndimor në Ballkan, duke e larguar rajonin nga sfera e influencës ruse (Caplan, 2005). Interesat Strategjike të NATO-s: Nëpërmjet ndërhyrjes, NATO synonte të parandalonte një krizë të mëtejshme refugjatësh dhe të ruante stabilitetin në një rajon që kishte përjetuar vite luftërash. Për më tepër, ndërhyrja ishte një test i kapacitetit të NATO-s për të vepruar si një forcë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (Tiku, 2024).

Ukraina 2014-2024. Konteksti gjeopolitik i krizës së Ukrainës ndryshoi thellësisht pas aneksimit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe shpërthimit të konfliktit në Donbas. Ky episod çoi në një konfrontim të ri të fuqive të mëdha ndërkombëtare. Rusia, duke përdorur forcën ushtarake dhe ndikimin politik, sfidoi rendin ndërkombëtar të pas Luftës së Ftohtë. Ndërhyrja e saj ngjalli përgjigje të fuqishme nga Perëndimi, përfshirë sanksione

ekonomike dhe mbështetje për Ukrainën (Menon & Rumer, 2015).

Kriza në Ukrainë pas aneksimit të Krimesë nga Rusia shënoi një përplasje të ashpër midis interesave perëndimore dhe ruse, duke e kthyer Ukrainën në një fushëbetejë gjeopolitike. Ndërhyrjet ndërkombëtare ishin kryesisht në formë ekonomike dhe diplomatike, duke përfshirë sanksione të rënda kundër Rusisë dhe mbështetje ushtarake për Ukrainën (Oualaalou, 2021). Ndryshe nga ndërhyrjet e mëparshme në Shqipëri dhe Kosovë, konteksti i konfliktit në Ukrainë tregoi kufizimet e veprimeve ndërkombëtare përballë një fuqie të madhe si Rusia, e cila përdori veton në Këshillin e Sigurimit për të bllokuar veprimet ndërkombëtare. Përplasia midis Perëndimit dhe Rusisë nxjerr në pah dobësinë e bashkërendimit global në trajtimin e krizave komplekse, si dhe kufizimet e instrumenteve tradicionale të ndërhyrjes ndërkombëtare.

Ndryshe nga Shqipëria dhe Kosova, konflikti në Ukrainë shënoi një pikë kulmore të tensioneve midis Perëndimit dhe Rusisë. Ndërhyrja ndërkombëtare nuk përfshiu trupa paqeruajtëse, por përfshiu mbështetje ekonomike, ushtarake dhe diplomatike për Ukrainën nga vendet e NATO-s dhe Bashkimi Evropian. NATO zgjeroi përpjekjet e saj për të rritur mbrojtjen në krahun lindor të aleancës si një përgjigje ndaj kërcënimit rus. Përplasia për Ukrainën theksoi rikthimin e dinamikës së Luftës së Ftohtë, ku aleancat perëndimore dhe Rusia u pozicionuan në konflikte të ndryshme (Msellemu, 2024). Ndryshe nga Kosova, ndërhyrja ndërkombëtare në Ukrainë u pengua nga përdorimi i vetos ruse në Këshillin e Sigurimit, duke kufizuar veprimet e OKB-së.

Tre rastet e shqyrtuara ilustrojnë sesi konteksti gjeopolitik përcakton suksesin ose

dështimin e ndërhyrjeve ndërkombëtare. Në Shqipëri, ndërhyrja e suksesshme për të rivendosur rendin u përkrah nga një konsensus ndërkombëtar dhe interesa strategjike për stabilizimin e Ballkanit. Ndërhyrja në Kosovë, ndonëse e diskutuar për legjitimitetin e saj, ishte një shembull i fuqisë së aleancave perëndimore për të vepruar unilateralisht. Konflikti në Ukrainë, megjithatë, tregon kufizimet e aleancave ndërkombëtare për të vepruar në një kontekst ku një fuqi e madhe si Rusia ka interesa strategjike thelbësore.

6.3. Roli i Këshillit të Sigurimit

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara është organi më i fuqishëm ndërkombëtar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë globale. Roli i tij ka qenë vendimtar në ndërhyrjet ndërkombëtare, si në Shqipëri (1997), Kosovë (1999) dhe Ukrainë (2014-2024). Analiza fokusohet në mënyrat sesi KS i OKB-së ka mbështetur, penguar ose përkeqësuar ndërhyrjet në secilin prej këtyre rasteve, duke theksuar ndikimin e vetos dhe balancën e fuqisë ndërmjet vendeve anëtare të përhershme.

Shqipëria 1997: mbështetje për ndërhyrje për stabilizim. Në vitin 1997, Shqipëria u përball me një krizë të thellë sociale dhe ekonomike pas rënies së skemave piramidale, që solli një rënie totale të rendit publik dhe një kolaps të institucioneve shtetërore. Përballë kërcënimeve për destabilizimin e rajonit të Ballkanit, KS i OKB-së mbështeti ndërhyrjen ndërkombëtare të udhëhequr nga Italia përmes operacionit “Alba”. Vendimi për të autorizuar këtë operacion, përmes një rezolute të veçantë (Rezolutës 1101 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së), tregoi një konsensus të rrallë mes vendeve anëtare të përhershme të KS-së (Donald, 2002). Ky rast dëshmon se kur ekziston një interes i përbashkët për stabilitetin rajonal, KS i OKB-së mund të luajë një rol të rëndësishëm në

mbështetjen e veprimeve ndërkombëtare për ruajtjen e paqes. *Balanca e Fuqisë dhe Konsensusi*: Në këtë rast, ndërhyrja u lehtësua nga mungesa e një kundërshtimi nga ana e Rusisë dhe Kinës, pasi çështja e Shqipërisë nuk prekte interesat e tyre strategjike. Ky fakt mundësoi një ndërhyrje të koordinuar që ruajti stabilitetin në rajon dhe shmangu përshkallëzimin e krizës (Felsen, 2023).

Kosova 1999: pengimi nga fuqia e vetos. Ndërhyrja në Kosovë në vitin 1999 pasqyroi një situatë shumë më të ndërlikuar gjeopolitike dhe politike në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Konflikti midis forcave serbe dhe popullsisë shqiptare të Kosovës u përshkallëzua, duke shkaktuar një krizë humanitare që tërhoqi vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare. Përpjekjet për të miratuar një rezolutë të KS-së që autorizonte përdorimin e forcës për të ndaluar dhunën në Kosovë dështuan për shkak të fuqisë së vetos së Rusisë, e cila mbështeste interesat e Serbisë, një aleat tradicional. Në përgjigje, NATO ndërmori një fushatë të njëanshme ajrore pa një mandat të OKB-së (Caplan, 2005). Pengesa nga Rusia në KS shkaktoi një ndarje të thellë në bashkësinë ndërkombëtare. Përkundër veprimeve të NATO-s që u konsideruan të nevojshme për të ndaluar një gjenocid të mundshëm, mungesa e një mandati të OKB-së ngjalli polemika rreth legjitimitetit të ndërhyrjes dhe ndërlikoi marrëdhëniet ndërkombëtare për vitet që pasuan. Rasti i Kosovës ilustron ndikimin negativ që fuqia e vetos mund të ketë në përpjekjet për të ndërhyrë në kriza humanitare dhe konflikte të brendshme.

Ukraina 2014-2024: bllokimi dhe pasojat. Kriza e Ukrainës që filloi në vitin 2014 pas aneksimit të Krimesë nga Rusia përfaqëson një sfidë të rëndësishme për KS-në e OKB-së. Vetoja e përsëritur e Rusisë në KS ka bllokuar përpjekjet për të miratuar masa të ashpra

ndërkombëtare kundër saj, duke përfshirë rezolutat që dënonin veprimet e saj dhe vendosnin sanksione më të ashpra (Menon & Rumer, 2015). Ndërkohë që Perëndimi ka reaguar përmes sanksioneve ekonomike dhe mbështetjes ushtarake për Ukrainën, paaftësia e KS-së për të arritur një qëndrim të përbashkët ka theksuar dështimin e sistemit ndërkombëtar për të trajtuar sfidat e fuqive të mëdha.

Balanca e fuqisë dhe dinamika e bllokimit. Konflikti në Ukrainë është një shembull i qartë i kufizimeve të KS-së kur përfshihet një fuqi e madhe si Rusia me interesa thelbësore strategjike. Vetoja ruse ka penguar çdo masë të detyrueshme, duke theksuar sfidën e madhe që përballlet KS-ja në zbatimin e funksionit të tij për ruajtjen e paqes ndërkombëtare kur një nga anëtarët e përhershëm është drejtpërdrejt i përfshirë në konflikt (Kyrydon & Troyan, 2022).

Analiza e tre rasteve tregon se roli i Këshillit të sigurimit të OKB-së varet shumë nga balanca e fuqisë dhe marrëdhëniet ndërmjet vendeve anëtare të përhershme. Në raste si Shqipëria 1997, KS-ja mund të mbështesë ndërhyrjet ndërkombëtare për të ruajtur paqen kur ekziston një konsensus. Në të kundërt, fuqia e vetos mund të bllokojë veprimet e nevojshme në raste të tilla si Kosova dhe Ukraina, duke theksuar nevojën për reforma të thella për të rritur efikasitetin dhe legjitimitetin e këtij organi (Mahmood, 2013). Rasti i Ukrainës, në veçanti, ilustron se si balanca e fuqisë dhe interesat kombëtare të anëtarëve të përhershëm mund të sfidojnë rendin ndërkombëtar dhe të përkeqësojnë krizën.

6.4. Aspektet e përbashkëta dhe dallimet kryesore

Ndërhyrjet ndërkombëtare në *Shqipëri (1997)*, *Kosovë (1999)* dhe *Ukrainë (2014-2024)*

paraqesin një seri elementësh të përbashkët dhe dallimesh të rëndësishme që kanë ndikuar në formën dhe rezultatin e tyre. Ky seksion vlerëson aspektet e përbashkëta, si natyra e krizës, përdorimi i forcës dhe ndikimi i aktorëve jo-shtetërorë, si dhe analizon ndryshimet kryesore, përfshirë qëllimet e ndërhyrjes, kohën dhe mënyrën e reagimit.

Elementet e përbashkëta: natyra e krizës dhe destabilizimi rajonal. Të tre rastet e ndërhyrjeve ndajnë një element të përbashkët: ato u shkaktuan nga kriza që kërcënonin stabilitetin rajonal ose ndërkombëtar. Kriza në Shqipëri në vitin 1997 u përshkallëzua për shkak të dështimit ekonomik dhe kolapsit të rendit publik, duke krijuar një kërcënim për fqinjët rajonalë (Korovilas, 1999). Në Kosovë, shtypja e shqiptarëve të Kosovës nga regjimi serb krijoi një krizë humanitare që përbënte një kërcënim për stabilitetin në Ballkan (Latawski, & Smith 2003). Konflikti në Ukrainë filloi me aneksimin e Krimesë nga Rusia dhe u pasua nga një luftë në shkallë të plotë, duke sfiduar sigurinë evropiane. Në të gjitha këto raste, ndërhyrja ndërkombëtare u nxit nga frika e përhapjes së destabilizimit përtej kufijve të vendeve të prekura (Hai-Nyzhnyk, 2022).

Përdorimi i forcës. Përdorimi i forcës ishte një element i përbashkët në ndërhyrjet në Kosovë dhe Ukrainë. NATO ndërmori një fushatë bombardimi në Kosovë për të ndaluar veprimet e forcave serbe (Nardulli et al., 2002), ndërsa në Ukrainë ka pasur mbështetje ushtarake përmes dërgesave të armëve dhe trajnimit për forcat ukrainase nga vende të ndryshme perëndimore. Në Shqipëri, megjithatë, ndërhyrja ndërkombëtare kishte një karakter kryesisht paqeruajtës dhe stabilizues, duke synuar rivendosjen e rendit publik pa përdorimin masiv të forcës.

Ndikimi i aktorëve jo-shtetërorë. Në të gjitha rastet, aktorët jo-shtetërorë kanë pasur një ndikim të rëndësishëm. Në Shqipëri, grupe të armatosura dhe qytetarë të revoltuar kontribuan në destabilizim, ndërsa në Kosovë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) luajti një rol kyç në konflikt (Bellamy, 2000). Në Ukrainë, aktorët jo-shtetërorë përfshinin separatistët pro-rusë të mbështetur nga Rusia, të cilët ndihmuan në përshkallëzimin e konfliktit (Khoirunnisa, et al, 2025). Në të gjitha rastet, këta aktorë ndërlikuan ndërhyrjet ndërkombëtare dhe ndikuan në dinamikën e konfliktit.

Dallimet: qëllimet e ndërhyrjes. Ndërhyrja në Shqipëri kishte një qëllim të qartë për të rivendosur rendin publik dhe për të parandaluar përhapjen e kaosit në rajon (Marchio, 2000). Në Kosovë, qëllimi kryesor i ndërhyrjes ishte ndalimi i krizës humanitare dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut (Rieff, 2000), ndërsa në Ukrainë ndërhyrjet kanë pasur për qëllim mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të Ukrainës përballë agresionit rus (Vidnyanskyj, 2023). Këto dallime tregojnë sesi konteksti i krizës dhe interesi ndërkombëtar ndikojnë në përcaktimin e qëllimeve të ndërhyrjeve.

Koha dhe mënyra e reagimit. Ndërhyrja në Shqipëri ndodhi relativisht shpejt pas përshkallëzimit të krizës, duke reflektuar një angazhim të shpejtë ndërkombëtar për të stabilizuar situatën (Korovilas, 1999). Në Kosovë, ndërhyrja erdhi pas disa muajve të negociatave të dështuara dhe përpjekjeve diplomatike (Caplan, 2005). Në Ukrainë, reagimi ndërkombëtar ka qenë më i gjatë dhe i fragmentuar, duke përfshirë një sërë masash graduale që filluan në 2014 dhe vazhduan për një dekadë (Lehkodukh et al., 2023). Ky dallim në kohë dhe mënyrën e reagimit reflekton kompleksitetin e sfidave të çdo rasti dhe kufizimet me të cilat përballen aktorët ndërkombëtarë.

Legjitimiteti ndërkombëtar. Ndërhyrja në Shqipëri kishte një bazë të fortë ligjore dhe mbështetje nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, ndërsa ndërhyrja në Kosovë u zhvillua pa një mandat të drejtpërdrejtë të OKB-së, duke krijuar debate për legjitimitetin e saj. Ndërhyrjet në Ukrainë janë karakterizuar nga sanksione ekonomike dhe mbështetje të hapur nga Perëndimi, por pa një vendim të drejtpërdrejtë të KS-së për shkak të vetos ruse (Rosefielde & Bernstam, 2024).

Ndërhyrjet në Shqipëri, Kosovë dhe Ukrainë tregojnë se ato formohen dhe ndërlikohen nga një sërë faktorësh të përbashkët dhe të ndryshëm. Elementët e përbashkët, si natyra e krizës, përdorimi i forcës dhe ndikimi i aktorëve jo-shtetërorë, theksojnë nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar dhe strategji të qarta. Ndërsa dallimet, si qëllimet e ndërhyrjes dhe koha e reagimit, pasqyrojnë sfidat unike të secilit rast dhe tregojnë se ndërhyrjet ndërkombëtare duhet të jenë fleksibël dhe të përshtaten për të pasqyruar dinamikën dhe kërkesat e situatave të veçanta.

6.5. Efektiviteti i ndërhyrjeve

Operacionet e paqes dhe ndërhyrjet humanitare shpesh konsiderohen si mjete të bashkësisë ndërkombëtare për ruajtjen e stabilitetit dhe zgjidhjen e krizave. Megjithatë, efektiviteti i tyre ndryshon nga një rast në tjetrin. Ky vlerësim shqyrton shkallën e suksesit në ndërhyrjet ndërkombëtare në Shqipëri (1997), Kosovë (1999) dhe Ukrainë (2014-2024), duke përfshirë rastet kur objektivat humanitare dhe të paqes janë arritur dhe kur kanë dështuar. Analiza përqendrohet në rezultatet, sfidat dhe pasojat e këtyre ndërhyrjeve.

Në vitin 1997, Shqipëria u përball me një krizë të thellë ekonomike dhe sociale pas dështimit të skemave piramidale, që çoi në një situatë kaotike me shpërthime dhune, rënie të institucioneve dhe përhapje të pasigurisë. Për të parandaluar përshkallëzimin e krizës në rajon, ndërhyrja ndërkombëtare u zhvillua nën udhëheqjen e Italisë dhe mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së përmes operacionit “Alba”. Synimi i operacionit ishte rikthimi i rendit dhe stabilitetit, si dhe mbështetja për një tranzicion politik të qëndrueshëm (Pettifer & Vickers, 2007).

Ndërhyrja në Shqipëri arriti të stabilizojë vendin dhe të parandalojë përhapjen e krizës përtej kufijve të tij, duke rikthyer një rend të përkohshëm publik dhe duke mundësuar mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Sidoqoftë, efektiviteti i ndërhyrjes ishte kryesisht i kufizuar në stabilizimin afatshkurtër dhe nuk përfshinte zgjidhjen e problemeve strukturore, të tilla si korrupsioni dhe dobësia e institucioneve qeveritare (Vickers, 2008). Në këtë rast, ndërhyrja përbënte një sukses të pjesshëm, duke treguar vlerën e veprimeve të shpejta ndërkombëtare, por edhe kufizimet e tyre për të krijuar ndryshime të qëndrueshme.

Konflikti në Kosovë në fund të viteve 1990 përshkallëzoi një krizë humanitare, për shkak të shtypjes së popullsisë shqiptare nga regjimi serb dhe përpjekjeve për spastrime etnike. Përpjekjet diplomatike për të arritur një zgjidhje përmes marrëveshjes së Rambujesë dështuan dhe NATO ndërhyri ushtarakisht për të ndaluar dhunën, duke nisur një fushatë bombardimi pa një mandat të drejtpërdrejtë të OKB-së (Caplan, 2005). Ndërhyrja e NATO-s ndaloi përshkallëzimin e dhunës dhe ndihmoi në kthimin e mijëra refugjatëve të Kosovës, duke shënuar një ndalim të menjëhershëm të një krize humanitare masive. Kjo

ndërhyrje konsiderohet një shembull i "*ndërhyrjes humanitare*", e cila pretendon të mbrojë civilët në situata të rënda, edhe në mungesë të një mandati të plotë ndërkombëtar (Chomsky, 2002). Sidoqoftë, ndërhyrja solli pasojat e saj, përfshirë tensione të zgjatura etnike në Kosovë, ndarje të vazhdueshme politike dhe tensione të përhershme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Për më tepër, veprimi i NATO-s pa një mandat të OKB-së ngriti debate rreth legjitimitetit të ndërhyrjes dhe krijoi precedentë të ndërlikuar për ndërhyrje të ardhshme ndërkombëtare.

Kriza në Ukrainë nisi më 2014 me aneksimin e Krimesë nga Rusia dhe u përshkallëzua me luftimet në lindje. Reagimi ndërkombëtar përfshiu sanksione ndaj Rusisë, ndihmë për Ukrainën dhe përpjekje diplomatike (Menon & Rumer, 2015). Megjithatë, vetoja ruse në Këshillin e Sigurimit bllokoi veprimet kolektive, duke kufizuar efektivitetin e ndërhyrjeve. Ndërsa sanksionet izoluan pjesërisht Rusinë, konflikti vazhdoi me pasoja të rënda humanitare, duke theksuar kufizimet e ndërhyrjeve në raste ku përfshihen fuqitë e mëdha.

Efektiviteti i operacioneve të paqes dhe ndërhyrjeve humanitare varet nga shumë faktorë, përfshirë mandatin ndërkombëtar, bashkëpunimin e fuqive të mëdha dhe natyrën e konfliktit. Ndërhyrja në Shqipëri shënoi një sukses të kufizuar në stabilizimin afatshkurtër, ndërhyrja në Kosovë ilustroi fuqinë dhe dobësitë e ndërhyrjeve humanitare, ndërsa ndërhyrja në Ukrainë thekson kompleksitetin dhe kufizimet e ndërhyrjeve të drejtuara kundër një fuqie të madhe. Këto raste tregojnë se ndërhyrjet ndërkombëtare, megjithëse shpesh janë të nevojshme, nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për të arritur paqen dhe stabilitetin afatgjatë. Përmirësimi i mekanizmave ndërkombëtarë për ndërhyrje

më të bashkërenduara dhe efektive mbetet një sfidë e rëndësishme për komunitetin global.

6.6. Sfidat e zbatimit

Zbatimi i ligjit ndërkombëtar dhe vendimeve të Këshillit të Sigurimit (KS) të OKB-së është një sfidë e vazhdueshme për bashkësinë ndërkombëtare. Rastet e ndërhyrjeve në *Shqipëri (1997)*, *Kosovë (1999)* dhe *Ukrainë (2014-2024)* ofrojnë një kuadër të vlefshëm për të analizuar faktorët që kanë ndikuar në suksesin ose dështimin e zbatimit të ligjit ndërkombëtar. Këta faktorë përfshijnë balancat e fuqisë mes aktorëve kryesorë, ndikimin e interesave kombëtare të fuqive të mëdha dhe sfidat strukturore të zbatimit të rezolutave ndërkombëtare.

Shqipëria 1997: sukses i kontrolluar në zbatimin e ligjit ndërkombëtar. Pas krizës së piramidave financiare në vitin 1997, Shqipëria u zhyt në një kaos të brendshëm të thellë, me pasoja për stabilitetin e gjithë rajonit. Ndërhyrja ndërkombëtare përmes operacionit “Alba”, e udhëhequr nga Italia dhe autorizuar nga KS i OKB-së, përfaqëson një shembull të zbatimit të suksesshëm të një rezolute ndërkombëtare për të rivendosur rendin dhe stabilitetin (Pettifer & Vickers, 2007).

Një nga arsyet kryesore të suksesit ishte mbështetja e gjerë ndërkombëtare dhe konsensusi i fuqive kryesore, të cilat e panë ndërhyrjen si një domosdoshmëri për të parandaluar destabilizimin e mëtejshëm të Ballkanit. Gjithashtu, fakti që Shqipëria nuk ishte e përfshirë në një konflikt të drejtpërdrejtë ndërkombëtar ose gjeopolitik të nivelit të lartë lehtësoi ndërhyrjen. Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe përpjekjet për të

përmbyshur kërkesat e rezolutës për rivendosjen e rendit dhe ndihmën humanitare ndihmuan në realizimin e objektivave të misionit. Megjithatë, sfidat strukturore të brendshme të Shqipërisë, si korrupsioni dhe dobësia e institucioneve shtetërore, vazhduan të mbeten pengesa për zbatimin afatgjatë të stabilitetit.

Kosova 1999: ndërhyrje pa mandat të KS dhe pasojat. Ndërhyrja në Kosovë ishte një rast kur zbatimi i ligjit ndërkombëtar u sfidua nga faktorë politikë dhe mungesa e një mandati të qartë nga KS i OKB-së. Konflikti midis forcave serbe dhe shqiptarëve të Kosovës kulmoi me një ndërhyrje të NATO-s, që synonte ndalimin e një krize humanitare. Ndërhyrja nuk u mbështet nga një rezolutë e KS-së, për shkak të kundërshtimit të fuqishëm të Rusisë dhe Kinës, të cilat e shihnin ndërhyrjen si një shkelje të sovranitetit të Serbisë (Caplan, 2005).

Pengimi nga fuqia e vetos në KS e bëri të pamundur arritjen e një vendimi të përbashkët. Si rezultat, NATO ndërmoi një ndërhyrje të njëanshme që, megjithëse u konsiderua e suksesshme në ndalimin e dhunës, ngriti pyetje rreth legjitimitetit të saj dhe ndikimit të ndërhyrjeve pa një mandat ndërkombëtar. Ky rast tregon qartë se mungesa e konsensusit midis fuqive të mëdha mund të bllokojë zbatimin e plotë të ligjit ndërkombëtar dhe të krijojë precedentë të diskutueshëm për ndërhyrjet në të ardhmen. Pasojat e mëvonshme, përfshirë tensionet e vazhdueshme ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe sfidat për njohjen ndërkombëtare të Kosovës, dëshmojnë vështirësitë për të zgjidhur konflikte që mbështeten në ndërhyrje jo-konsensuale.

Ukraina 2014-2024: një test i zbatimit të ligjit ndërkombëtar. Kriza e Ukrainës ka përfaqësuar një nga sfidat më të mëdha për zbatimin e ligjit ndërkombëtar në kohët moderne. Aneksimi i Krimesë nga Rusia në vitin 2014 u konsiderua gjerësisht si një shkelje e të drejtës ndërkombëtare dhe u dënua nga një sërë vendesh perëndimore. Përdorimi i forcës kundër Ukrainës, siç diskutohet nga Sayapin dhe Tsybulenko (2018), përbën një shkelje të së drejtës ndërkombëtare për disa arsye kryesore. Së pari, sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara, përdorimi i forcës është i ndaluar, përveç rasteve të vetëmbrojtjes ose kur miratohet nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Veprimet e Rusisë, veçanërisht aneksimi i Krimesë në vitin 2014 dhe ndërhyrjet ushtarake në Ukrainë, nuk ishin përgjigje ndaj një sulmi të armatosur dhe as nuk u miratuan nga Këshilli i Sigurimit, duke shkelur kështu ndalimin e përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Për më tepër, parimet e *jus ad bellum* (e drejta për luftë), u shkelën pasi nuk kishte një justifikim të ligjshëm për agresionin ushtarak. Veprimet gjithashtu shkelën *jus in bello* (të drejtën ndërkombëtare humanitare gjatë zhvillimit të luftës), duke pasur parasysh natyrën e paligjshme të konfliktit, dhe mund të kenë shkelur gjithashtu *jus post bellum* (drejtësia pas luftës), pasi veprimet e Rusisë kanë çuar në pasiguri afatgjatë dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Prandaj, përdorimi i forcës nga Rusia kundër Ukrainës minon kornizat e krijuara të së drejtës ndërkombëtare (Green et al., 2022).

Rasti i Ukrainës thekson fuqinë e vetos dhe ndikimin e saj në bllokimin e vendimeve ndërkombëtare. Si anëtare e përhershme e KS-së, Rusia ka ndaluar çdo rezolutë që mund të ndëshkonte veprimet e saj, duke e bërë të vështirë zbatimin e vendimeve ndërkombëtare. Ndërkohë, ndërhyrjet ndërkombëtare kanë qenë kryesisht të natyrës

ekonomike (*sanksione*) dhe mbështetje ushtarake, por pa një qasje të koordinuar nga OKB-ja (Peters, 2023). Për më tepër, ndarja e fuqive ndërkombëtare midis Perëndimit dhe Rusisë ka komplikuar përpjekjet për zgjidhjen e konfliktit, duke treguar sfidat e mëdha që lindin kur interesat kombëtare të fuqive të mëdha janë të përfshira.

Analiza e këtyre rasteve tregon disa faktorë kyç që ndikojnë në zbatimin ose dështimin e ligjit ndërkombëtar:

Fuqia e vetos dhe konsensusi ndërkombëtar. Mungesa e një konsensusi midis anëtarëve të përhershëm të KS-së, përfshirë përdorimin e vetos, mbetet një pengesë kryesore për zbatimin efektiv të rezolutave ndërkombëtare. Ky fakt ilustron qartë në rastin e Kosovës dhe Ukrainës.

Interesat e Fuqive të Mëdha. Ndërhyrjet ndërkombëtare shpesh përcaktohen nga interesat strategjike të fuqive të mëdha. Kur interesat e tyre janë të përfshira, si në rastin e Ukrainës, zbatimi i ligjit ndërkombëtar bëhet shumë më i ndërlikuar.

Konteksti gjeopolitik dhe ndikimi rajonal. Si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, konteksti gjeopolitik dhe stabiliteti rajonal kanë ndikuar në mënyrën sesi vendimet ndërkombëtare janë zbatuar ose janë përballuar me sfida.

Legjitimiteti dhe mbështetja ndërkombëtare. Kur një ndërhyrje mbështetet nga një konsensus ndërkombëtar dhe ka një bazë të fortë ligjore, si në rastin e Shqipërisë, zbatimi është më i mundshëm. Në të kundërtën, ndërhyrjet pa një mandat të qartë, si në Kosovë, përballen me sfida legjitimiteti.

Zbatimi i ligjit ndërkombëtar dhe vendimeve të KS-së të OKB-së është kompleks dhe

ndikohet nga faktorë politikë, ekonomikë dhe gjeopolitikë. Rastet e Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës ilustrojnë se, pavarësisht përpjekjeve për të zbatuar rezolutat dhe vendimet ndërkombëtare, sfidat mbeten të mëdha. Konsensusi i fuqive të mëdha, interesi strategjik dhe fuqia e vetos vazhdojnë të përcaktojnë efektivitetin ose dështimin e përpjekjeve ndërkombëtare për ruajtjen e paqes dhe të rendit global.

6.7. Roli i fuqive të mëdha dhe rajonale

Roli i fuqive rajonale dhe ndërkombëtare në ndërhyrjet e ndryshme për paqe dhe stabilitet shpesh ndikon në mënyrë vendimtare në ecurinë dhe efektivitetin e këtyre përpjekjeve. Rastet e ndërhyrjeve në *Shqipëri (1997)*, *Kosovë (1999)* dhe *Ukrainë (2014-2024)* ofrojnë një kuadër të rëndësishëm për të shqyrtuar sesi aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë ndikojnë në dinamikën e ndërhyrjeve dhe në vendimmarrjen e përgjithshme të bashkësisë ndërkombëtare. Vëmendja do të përqendrohet në rolin e këtyre aktorëve si ndërmjetës, mbështetës apo pengues të veprimeve ndërkombëtare në secilin prej këtyre rasteve.

Në vitin 1997, Shqipëria u përfshi nga një krizë e rëndë ekonomike dhe politike pas dështimit të skemave piramidale, që solli një kolaps të rendit publik. Ndërhyrja ndërkombëtare u udhëhoq nga Italia përmes operacionit “Alba”, me mbështetje nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Fuqitë rajonale, përfshirë Turqinë, Greqinë dhe Italinë, luajtën një rol vendimtar në nxitjen e ndërhyrjes, duke parë se një destabilizim i mëtejshëm i Shqipërisë mund të kishte pasoja të rënda për rajonin e Ballkanit (Debié, 2000).

Italia dhe Greqia ishin ndër aktorët kryesorë që promovuan ndërhyrjen, duke nxitur komunitetin ndërkombëtar për të vepruar në mënyrë të koordinuar. Për më tepër, roli i tyre si ndërmjetës për të krijuar një dialog ndërmjet palëve shqiptare ndihmoi në parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit dhe në stabilizimin e situatës (Debié, 2000). Ky rast tregon sesi aktorët rajonalë mund të luajnë një rol pozitiv në mbështetjen e ndërhyrjeve për stabilitet dhe paqe, veçanërisht kur ata janë të përfshirë direkt nga pasojat e krizës.

Në këtë rast, ndërhyrja u karakterizua nga një konsensus i gjerë ndërkombëtar, ku fuqitë rajonale ndihmuan në lehtësimin e vendimmarrjes së KS-së së OKB-së për autorizimin e operacionit “Alba”. Përfshirja dhe mbështetja e fuqive rajonale përbënin një element kyç për suksesin e ndërhyrjes.

Në Kosovë në 1999-ën, kriza u përkeqësua për shkak të shtypjes sistematike të popullsisë shqiptare nga regjimi serb. Konflikti u përshkallëzua në një krizë humanitare që tërhoqi vëmendjen e fuqive ndërkombëtare dhe rajonale. Ndërhyrja e NATO-s, megjithatë, u përball me një mungesë të një mandati të qartë nga Këshilli i Sigurimit për shkak të kundërshtimit të fuqishëm të Rusisë dhe Kinës, të cilat e konsideruan ndërhyrjen si një shkelje të sovranitetit serb (Pavlović et al., 2004).

Serbia, e mbështetur nga Rusia, luajti një rol pengues, duke u përpjekur të bllokonte ndërhyrjen ndërkombëtare dhe duke e konsideruar atë si një shkelje të integritetit të saj territorial. Nga ana tjetër, aktorët rajonalë pro-perëndimorë dhe shqiptarët e Kosovës kërkuuan ndërhyrjen e fuqive ndërkombëtare për të ndaluar dhunën dhe për të mbrojtur

civilët (Pavlović et al., 2004). Roli i NATO-s si një aktor ndërkombëtar mbështetës ishte kyç në vendimin për të ndërmarrë një fushatë ajrore për të ndaluar veprimet e forcave serbe.

Ky rast ilustron sesi aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë mund të ndajnë qëndrimet në mënyrë të thellë, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në vendimmarrjen globale. Kundërshtimi i Rusisë dhe Kinës në KS bllokoj një rezolutë të qartë për ndërhyrje, duke krijuar tensione në kuadrin ndërkombëtar dhe duke theksuar kufizimet e ndërhyrjeve që nuk kanë një bazë të gjerë ndërkombëtare (Sakaguchi & Mayama, 1999).

Kriza në Ukrainë shpërtheu me aneksimin e Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe vazhdoi me konfliktin në lindje të vendit. Konflikti solli një ndarje të qartë ndërmjet fuqive perëndimore dhe Rusisë, duke përfshirë një sërë ndërhyrjesh diplomatike, ekonomike dhe ushtarake nga të dyja palët (Grant, 2015).

Rusia ka qenë një aktor kryesor pengues në çdo përpjekje ndërkombëtare për të ndaluar agresionin dhe për të vendosur sanksione të ashpra ndaj saj. Ndërkohë, Bashkimi Evropian dhe NATO kanë ofruar mbështetje të fuqishme për Ukrainën, duke përfshirë ndihmë ushtarake, ekonomike dhe diplomatike (Bond & Scazzieri, 2022). Kjo përfshirje ka përkeqësuar tensionet ndërmjet fuqive kryesore dhe ka krijuar një situatë të ndërlikuar për zgjidhjen e konfliktit.

Në këtë rast, fuqitë ndërkombëtare janë ndarë qartë. Rusia, si një anëtare e përhershme e KS-së, ka bllokuar çdo rezolutë që do të dënonte veprimet e saj. Për më tepër, fuqia e saj

si një aktor rajonal e bën të vështirë arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme përmes mekanizmave ndërkombëtarë. Ndërkohë, mbështetja e fuqive perëndimore ka qenë e kufizuar në masa ekonomike dhe mbështetje të përkohshme për Ukrainën, por pa një zgjidhje përfundimtare për konfliktin.

Aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë luajnë një rol vendimtar në dinamikën e ndërhyrjeve ndërkombëtare. Rastet e Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës tregojnë se roli i tyre mund të jetë mbështetës, pengues ose ndërmjetës, duke ndikuar në suksesin ose dështimin e veprimeve ndërkombëtare. Në rastin e Shqipërisë, mbështetja rajonale ndihmoi në stabilizimin e situatës, ndërsa në Kosovë dhe Ukrainë ndarjet ndërkombëtare dhe interesat e fuqive të mëdha krijuan sfida të mëdha për zgjidhjen e konflikteve. Kjo tregon rëndësinë e bashkëpunimit dhe konsensusit për zgjidhjen e krizave ndërkombëtare.

Legjitimiteti ndërkombëtar është një faktor përcaktues në suksesin e ndërhyrjeve ndërkombëtare, duke ndikuar drejtpërdrejt në mbështetjen që ato marrin dhe në efektivitetin e tyre. Shembujt e ndërhyrjeve në Shqipëri (1997), Kosovë (1999) dhe Ukrainë (2014–2024) tregojnë se perceptimet për legjitimitetin kanë luajtur një rol kyç në formësimin e vendimeve dhe veprimeve të bashkësisë ndërkombëtare.

Në vitin 1997, Shqipëria u përball me një kolaps të rendit publik dhe një krizë të rëndë ekonomike dhe politike. Ndërhyrja ndërkombëtare u organizua përmes operacionit “Alba”, i drejtuar nga Italia dhe i mbështetur nga një rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Legjitimiteti i ndërhyrjes u sigurua nga një mandat i qartë ndërkombëtar për të rivendosur rendin dhe për të ndihmuar në stabilizimin e situatës në Shqipëri (Pettiifer &

Vickers, 2007).

Mbështetja nga OKB-ja siguroi një kuadër legjitim për veprimin ndërkombëtar dhe e bëri më të lehtë për vendet pjesëmarrëse të marrin pjesë në operacion pa frikë nga pasojat politike ose ligjore. Për më tepër, bashkëpunimi me qeverinë shqiptare dhe perceptimi i ndërhyrjes si një akt paqeruajtës ndihmuan në ndërtimin e një mjedisi të favorshëm për zbatimin e mandatit (Hoffmann, 2020). Ky rast tregon se kur ndërhyrjet ndërkombëtare kanë një bazë të fortë legjitimiteti, ato janë më të prirura të jenë të suksesshme dhe të pranueshme.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë është një rast kompleks për sa i përket legjitimitetit ndërkombëtar. NATO ndërhyri në vitin 1999 për të ndaluar spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës nga regjimi serb, por veprimi i saj u zhvillua pa një mandat të qartë nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së për shkak të kundërshtimit të fuqishëm të Rusisë dhe Kinës, të cilat argumentuan se ndërhyrja shkelte sovranitetin e Serbisë (Weller, 1999).

Ndërhyrja e NATO-s u perceptua si *"ilegale, por legjitime"* nga shumë vende perëndimore për shkak të justifikimit humanitar, por gjithashtu u kritikua gjerësisht për mungesën e një mandati të OKB-së (Chesterman, 2002). Ndikimi i perceptimeve të ndryshme për legjitimitetin vazhdon të jetë i pranishëm në diskutimet rreth ndërhyrjeve humanitare, duke nxitur tensione midis fuqive të mëdha dhe rrezikuar qëndrueshmërinë e rezultateve afatgjata. Ndërhyrja ndaloi dhunën, por e la Kosovën të ndarë politikisht dhe me tensione të vazhdueshme.

Kriza në Ukrainë u përshkallëzua në vitin 2014 me aneksimin e Krimesë nga Rusia, e cila e justifikoi veprimin e saj si mbrojtje të të drejtave të popullsisë ruse në Krime. Perëndimi e konsideroi këtë një shkelje flagrante të të drejtës ndërkombëtare dhe vendosi një sërë sanksionesh ekonomike dhe ndihmë ushtarake për Ukrainën (Biersack, & O'lear, 2014). Fuqia e vetos së Rusisë në Këshillin e Sigurimit e bllokoi çdo përpjekje për një rezolutë ndërkombëtare kundër saj (Menon & Rumer, 2015).

Përplasja midis perceptimeve të ndryshme për legjitimitetin ndërkombëtar e bëri të vështirë zbatimin e masave të njëtrajtshme për zgjidhjen e konfliktit. Për Perëndimin, mbështetja për Ukrainën kishte një bazë të fortë ligjore dhe morale, por për Rusinë dhe disa aleatë të saj, ndërhyrjet e Perëndimit përbënin një ndërhyrje në interesat e saj kombëtare (Mearsheimer, 2022). Legjitimiteti i masave të ndërmarra u sfidua dhe ndarja e fuqive kryesore e komplikoi tej mase arritjen e një zgjidhjeje paqësore.

Rasti i Shqipërisë tregon sesi një ndërhyrje me legjitimitet të qartë ndërkombëtar mund të ndihmojë në arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe të pranuar gjerësisht. Ndërsa ndërhyrja në Kosovë dhe mbështetja për Ukrainën tregojnë se mungesa ose përplasjet për legjitimitetin mund të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë afatgjatë të rezultateve dhe të thellojnë ndarjet gjeopolitike. Perceptimet për legjitimitetin janë thelbësore për të siguruar një mbështetje të gjerë dhe për të rritur efektivitetin e ndërhyrjeve ndërkombëtare. Siç vë në dukje Reisman (2000), legjitimiteti është një element kritik që përcakton nëse një ndërhyrje do të jetë e pranueshme nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga palët e përfshira. Legjitimiteti ndërkombëtar është një faktor kyç në suksesin ose

dështimin e ndërhyrjeve. Në rastin e Shqipërisë, një ndërhyrje me legjitimitet të fortë ndërkombëtar arriti të stabilizojë situatën, ndërsa në Kosovë dhe Ukrainë mungesa ose përplasjet për legjitimitetin kanë krijuar sfida të mëdha për paqen dhe stabilitetin. Këto raste tregojnë rëndësinë e një kuadri të qartë dhe të qëndrueshëm të legjitimitetit për zbatimin e suksesshëm të ndërhyrjeve ndërkombëtare.

6.8. Qasja e aktorëve multilateralë

Ndërhyrjet ndërkombëtare përbëjnë një instrument të rëndësishëm për adresimin e krizave humanitare, ruajtjen e paqes dhe stabilizimin e rajoneve të paqëndrueshme. Këto ndërhyrje mund të realizohen nëpërmjet qasjeve shumëpalëshe, të udhëhequra nga organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, ose përmes iniciativave dypalëshe të ndërmarra nga shtete individuale apo koalicione të vogla. Duke analizuar rastet e Shqipërisë (1997), Kosovës (1999) dhe Ukrainës (2014–2024), mund të kuptojmë më mirë dallimet midis këtyre qasjeve në lidhje me objektivat e tyre, nivelin e efikasitetit dhe rezultatet që kanë prodhuar.

Në vitin 1997, Shqipëria përjetoj një krizë të thellë ekonomike dhe shoqërore për shkak të rënies së skemave piramidale. Për të shmangur përhapjen e destabilizimit në rajon, ndërhyrja ndërkombëtare u organizua përmes operacionit “Alba”, i udhëhequr nga Italia, por me mbështetje dhe mandat të OKB-së. (Hussain et al., 2022). Ky operacion shumëpalësh kishte qëllime të qarta për rivendosjen e rendit publik dhe për të lehtësuar ndihmën humanitare.

Ndërhyrjet e mbështetura nga OKB-ja dhe fuqitë rajonale në këtë rast përfituan nga

legjitimiteti i gjerë ndërkombëtar dhe mbështetja e koordinuar nga shumë shtete. Legjitimiteti i OKB-së siguroi një kornizë të qartë për veprim dhe ndihmoi në krijimin e një mjedisi të favorshëm për bashkëpunim me qeverinë shqiptare (Pettifer & Vickers, 2007). Për më tepër, qasja shumëpalëshe synonte të zgjidhte konfliktin në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çështje të stabilitetit afatgjatë dhe zhvillimit institucional.

Megjithatë, ndërhyrjet shumëpalëshe shpesh përballen me burokracinë dhe kërkojnë konsensus midis aktorëve të ndryshëm, gjë që mund të vonojë ose të kufizojë veprimet. Në rastin e Shqipërisë, ndërhyrja ndihmoi në stabilizimin afatshkurtër, por mungesa e një qasjeje më të thellë për të adresuar korrupsionin dhe dobësitë strukturore tregoi kufizimet e qasjeve të tilla.

Në Kosovë, ndërhyrja e udhëhequr nga NATO ishte një përgjigje ndaj shtypjes së popullsisë shqiptare nga regjimi serb. Ndërhyrja nuk pati mbështetjen e një mandati të OKB-së për shkak të kundërshtimit të Rusisë dhe Kinës, duke e bërë atë një qasje dypalëshe të udhëhequr nga një koalicion i shteteve perëndimore.

Ndërhyrjet e udhëhequra nga koalicione të vogla ose shtete individuale, si ajo e NATO-s, shpesh veprojnë më shpejt dhe janë më fleksibël për t'iu përgjigjur krizave emergjente. Në Kosovë, NATO ndërhyri shpejt për të ndaluar spastrimin etnik dhe për të parandaluar një krizë humanitare të mëtejshme (Weller, 1999). Kjo qasje lejoi veprim efektiv dhe vendimmarrje të shpejtë, duke shpëtuar jetë njerëzish në një kohë kritike.

Nga ana tjetër, mungesa e një mandati të OKB-së dhe mbështetja e një baze më të gjerë legjitimiteti ndërkombëtar çoi në një ndarje globale në lidhje me ndërhyrjen. Ndërhyrja u perceptua si legjitime nga disa, por ilegale nga të tjerët, duke krijuar tensione afatgjata dhe precedentë të debatueshëm në të drejtën ndërkombëtare (Chesterman, 2002). Për më tepër, veprimi i një koalicioni të vogël mund të çojë në rezultate të njëanshme, që nuk marrin parasysh plotësisht nevojat e gjithë popullatës.

Kriza në Ukrainë që filloi në vitin 2014 përfaqëson një përplasje midis qasjeve multilaterale dhe dypalëshe. Rusia, e cila aneksoi Krimenë, ka përdorur fuqinë e saj si një aktor individual për të ndjekur interesat e saj strategjike, ndërsa Perëndimi ka vepruar përmes sanksioneve ekonomike dhe mbështetjes ushtarake, nëpërmjet një kombinimi të koalicioneve të vogla dhe organeve shumëpalëshe si Bashkimi Evropian dhe NATO (Menon & Rumer, 2015).

Mbështetja për Ukrainën nga një koalicion i gjerë shumëpalësh ka përfshirë masa diplomatike dhe ndihmë ekonomike, duke ndihmuar në ruajtjen e një qëndrueshmërie të caktuar. Sidoqoftë, qasja shumëpalëshe ka qenë e kufizuar nga fuqia e vetos së Rusisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, e cila ka bllokuar veprime të detyrueshme ndërkombëtare (Sending, 2022). Ky rast tregon se qasjet shumëpalëshe mund të ndërlikohen nga interesat e fuqive të mëdha dhe të kenë vështirësi në arritjen e zgjidhjeve të qarta dhe të qëndrueshme.

Qasjet dypalëshe dhe multilaterale kanë rezultuar në një përzierje të masave që ndonjëherë e bëjnë situatën të ndërlikuar dhe të vështirë për t'u zgjidhur. Koordinimi i

veprimeve nga një shumësi aktorësh është sfiduar nga ndarjet gjeopolitike, duke treguar nevojën për një koordinim më të mirë ndërmjet fuqive kryesore.

Ndërhyrjet e mbështetura nga aktorë shumëpalësh dhe ato të ndjekura nga koalicione të vogla ose shtete individuale paraqesin avantazhe dhe sfida të ndryshme (Trebesch et al., 2023). Ndërhyrjet shumëpalëshe mund të sigurojnë një legjitimitet më të gjerë dhe të ofrojnë zgjidhje gjithëpërfshirëse, por shpesh janë të ngadalta dhe burokratike. Ndërhyrjet dypalëshe janë më të shpejta dhe më fleksibile, por mund të përballen me mungesë legjitimiteti dhe të jenë të njëanshme. Këto dallime tregojnë nevojën për një qasje të balancuar, që kombinojnë përfitimet e qasjeve shumëpalëshe dhe fleksibilitetin e qasjeve dypalëshe për të arritur objektiva të qëndrueshme dhe të pranueshme në ndërhyrjet ndërkombëtare.

6.9. Konkluzione

Në përfundim, ky kapitull përfshin një analizë krahasuese të ndërhyrjeve ndërkombëtare në Shqipëri (1997), Kosovë (1999) dhe Ukrainë (2014-2024), duke shqyrtuar faktorët që kishin ndikuar në suksesin ose dështimin e këtyre ndërhyrjeve. Analiza përqendrohet në kontekstin politik, strategjitë e zbatuara dhe ndikimin e aktorëve ndërkombëtarë, me një theks të veçantë në rolin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Pjesa e parë shqyrtoi se si faktorë të tillë si legjitimiteti ndërkombëtar dhe interesat kombëtare kishin ndikuar në ndërhyrje, duke nxjerrë në pah se ndërhyrjet me mbështetje të Këshillit të Sigurimit ishin karakterizuar nga legjitimitet më të fortë. Pjesa e dytë vlerësoi dallimet dhe ngjashmëritë mes këtyre ndërhyrjeve, përfshirë përdorimin e forcës dhe përfshirjen e aktorëve jo-shtetërorë. Analiza tregoi se ndërhyrjet ndërkombëtare shpesh ndanin sfida të përbashkëta, por ndodhnin në kushte të ndryshme politike dhe gjeopolitike. Ndërhyrjet e suksesshme kërkonin konsensus ndërkombëtar dhe një mandat të qartë, ndërsa ato pa një mandat të tillë shpesh hasnin në kundërshtime legjitime dhe vështirësi diplomatike.

Rëndësia e kapitullit qëndron në faktin se ai ofron një krahasim të thellë të ndërhyrjeve ndërkombëtare në tri raste kyçe: *Shqipërinë në vitin 1997, Kosovën në vitin 1999 dhe Ukrainën që nga viti 2014*. Ai shqyrtoi faktorët që ndikuan në suksesin ose dështimin e këtyre ndërhyrjeve, duke u fokusuar në rolin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe ndikimin e aktorëve ndërkombëtarë. Nëpërmjet analizës së konteksteve gjeopolitike dhe strategjive të përdorura, kapitulli i dha mundësinë të kuptohet se si interesat e fuqive të mëdha, përdorimi i forcës dhe legjitimiteti ndërkombëtar ndikojnë në arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe në formësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Për më tepër, u theksua rëndësia e konsensusit ndërkombëtar dhe mbështetjes së Këshillit të

Sigurimit për të lehtësuar ndërhyrjet e suksesshme, si dhe pengesat që krijojnë dështimet e legjitimitetit dhe përdorimi i vetos nga anëtarët e përhershëm të OKB-së. Ky kapitull ishte esencial për të kuptuar dinamikat e ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe rëndësinë e një qasjeje të koordinuar dhe të drejtpërdrejtë në menaxhimin e krizave globale. Ai gjithashtu ofron mësim të vlefshme për përmirësimin e ndërhyrjeve të ardhshme, duke theksuar sfidat dhe mundësitë që paraqiten kur aktorët ndërkombëtarë përpiqen të ruajnë paqen dhe stabilitetin.

KAP.7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Konkluzione.

Ligji ndërkombëtar qëndron në themel të arkitekturës globale të paqes dhe sigurisë, veçanërisht në kohë krizash që kërcënojnë jo vetëm stabilitetin e brendshëm të shteteve, por edhe rendin ndërkombëtar. Shembujt e *Shqipërisë (1997)*, *Kosovës (1999)* dhe *Ukrainës (2024)* dëshmojnë qartë se ligji ndërkombëtar nuk është thjesht një instrument juridik, por një mjet vendimtar në mbrojtjen e sovranitetit, në ndërhyrjen humanitare dhe në reagimin kolektiv ndaj shkeljeve flagrante të rendit ndërkombëtar. Këto raste ilustronë se ndërhyrja ndërkombëtare, e udhëhequr nga parimet e së drejtës ndërkombëtare, mund të shndërrohet në një faktor vendimtar në ndalimin e përshkallëzimit të krizave dhe në vendosjen e një paqeje të qëndrueshme. Megjithatë, ato zbulojnë gjithashtu kufijtë e këtij ligji kur përballen me interesa të mëdha gjeopolitike dhe mungesë vullneti politik. Kjo analizë synon të nxjerrë në pah mësimet kryesore nga këto episode, duke vlerësuar se në ç'mënyrë ligji ndërkombëtar mund të forcohet për t'u bërë një garanci më e fuqishme e sigurisë kolektive dhe e drejtësisë globale.

Analizë e rasteve: Shqipëria 1997. Kriza e vitit 1997 në Shqipëri ishte një pasojë e drejtpërdrejtë e kolapsit të skemave piramidale, e cila çoi në shpërbërjen e rendit shtetëror dhe përshkallëzimin e dhunës. Mungesa e një përgjigjeje të organizuar shtetërore dhe kërcënimi i një konflikti të brendshëm e bënë të domosdoshme ndërhyrjen ndërkombëtare. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) luajtën një rol kyç në legjitimimin e operacionit “Alba”, një ndërhyrje shumëkombëshe e udhëhequr nga Italia për të rivendosur rendin

dhe për të siguruar ndihmë humanitare. Megjithëse Operacioni “Alba” nuk përfshinte një mandat të drejtpërdrejtë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ai u legjitimua përmes Rezolutës 1101, duke shërbyer si një model për ndërhyrjet e autorizuara nga komuniteti ndërkombëtar në situata të emergjencës. Megjithatë, ky rast thekson kufizimet e ligjit ndërkombëtar, duke pasqyruar varësinë e tij nga vendimet politike dhe vullneti i shteteve të fuqishme për të ndërmarrë veprime.

Kosova 1999. Rasti i Kosovës përfaqëson një shembull të rëndësishëm të evolucionit të ligjit ndërkombëtar në raport me ndërhyrjet humanitare. Në këtë rast, NATO kreu një operacion ushtarak kundër Serbisë pa një mandat të qartë nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, duke ngritur debate mbi ligjshmërinë e aksioneve të tilla. Konflikti në Kosovë u karakterizua nga përdorimi i dhunës shtetërore ndaj popullsisë civile shqiptare, një situatë që kërkonte ndërhyrje për të parandaluar spastrimin etnik dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut. Operacioni i NATO-s në vitin 1999 shënoi një pikë kthese në të drejtën ndërkombëtare, pasi legjitimiteti i ndërhyrjes u bazua në doktrinën e përgjegjësisë për të mbrojtur (R2P), edhe pse kjo doktrinë nuk ishte ende e formalizuar në atë kohë. Rasti i Kosovës tregoi kufizimet e sistemit ligjor ndërkombëtar për të adresuar situatat e dhunës shtetërore kur mekanizmat e OKB-së ishin të bllokuar për shkak të interesave të vendeve anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit.

Ukraina 2022. Lufta në Ukrainë në vitin 2024 paraqet një rast kompleks të sfidave të ligjit ndërkombëtar në menaxhimin e konflikteve ndërkombëtare. Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës, i nisur në vitin 2022, ka shkelur parimet themelore të Kartës së OKB-së, veçanërisht ndalimin e përdorimit të forcës dhe respektimin e sovranitetit territorial.

Përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare ka përfshirë sanksione ekonomike të gjera, mbështetje ushtarake për Ukrainën dhe përpjekje për të ndjekur përgjegjësinë e liderëve rusë në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (ICC). Megjithatë, mekanizmat ndërkombëtarë kanë qenë të kufizuar në parandalimin e agresionit, duke dëshmuar se shtetet e fuqishme mund të sfidojnë hapur të drejtën ndërkombëtare pa pasoja të menjëhershme. Ky rast thekson nevojën për reforma në sistemin ndërkombëtar të sigurisë dhe për forcimin e mekanizmave të zbatimit të ligjit ndërkombëtar për të parandaluar akte të tilla në të ardhmen.

Duke analizuar këto tri raste, mund të nxjerrim disa përfundime kyçe mbi ndikimin dhe kufizimet e ligjit ndërkombëtar në sigurinë kombëtare. Përgjigja e ligjit ndërkombëtar është më efektive në rastet e krizave të brendshme sesa në ato të agresionit ndërkombëtar. Në Shqipëri dhe Kosovë, ndërhyrjet ndërkombëtare, edhe pse të debatueshme ligjërisht, arritën të krijojnë stabilitet. Në rastin e Ukrainës, megjithatë, ligji ndërkombëtar nuk arriti të ndalonte agresionin. Legjitimiteti i ndërhyrjeve ndërkombëtare varet nga faktorët politikë dhe strategjikë. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë u realizua pa një mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, por u justifikua me argumente humanitare. Ndërsa ndërhyrja në Shqipëri ishte e autorizuar nga OKB-ja, në rastin e Ukrainës mekanizmat ndërkombëtarë ishin të bllokuar nga fuqitë me veto.

Mungesa e një mekanizmi të fuqishëm për zbatimin e ligjit ndërkombëtar mbetet një problem kritik. Në të tre rastet, efektiviteti i së drejtës ndërkombëtare është penguar nga mungesa e mjeteve detyruese për të parandaluar konfliktet ose për të ndaluar shkeljet e mëdha të të drejtave të njeriut dhe agresionin shtetëror. Rastet e *Shqipërisë, Kosovës dhe*

Ukrainës tregojnë se ligji ndërkombëtar mbetet një instrument i rëndësishëm për menaxhimin e krizave, por efektiviteti i tij varet nga vullneti politik dhe balanca e fuqive në skenën ndërkombëtare ndërkombëtar. Ndërsa në disa raste, si në Shqipëri dhe Kosovë, ndërhyrjet ndërkombëtare kanë pasur sukses në stabilizimin e situatës, në rastin e Ukrainës, ligji ndërkombëtar është sfiduar drejtpërdrejt nga një fuqi e madhe, duke ngritur nevojën për reforma në sistemin e sigurisë globale dhe forcimin e mekanizmave detyrues për zbatimin e tij.

Ligji ndërkombëtar është një shtyllë themelore e rendit global të sigurisë, duke synuar të rregullojë marrëdhëniet shtetërore dhe të menaxhojë konfliktet përmes normave dhe institucioneve. Megjithatë, efektiviteti i tij shpesh ndikohet nga faktorë politikë dhe strategjikë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së, megjithëse ka mandat për ruajtjen e paqes, shpesh bllokohet nga interesat e fuqive të mëdha. Traktatet dhe konventat ofrojnë bazë ligjore, por mbeten të dobëta në mungesë të mekanizmave të fortë të zbatimit.

Dobësitë e mekanizmave ndërkombëtarë në menaxhimin e krizave. Ndërhyrja ndërkombëtare në konfliktet e brendshme dhe ndërkombëtare shpesh vuan nga një sërë kufizimesh strukturore dhe politike. Megjithëse ekzistojnë institucione si OKB-ja, NATO-ja, Bashkimi Evropian (BE) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) që synojnë menaxhimin e krizave, efektiviteti i tyre varet nga faktorë si:

Varësia nga vullneti politik i shteteve të fuqishme. Organizatat ndërkombëtare nuk kanë një forcë të centralizuar të zbatimit, duke i bërë vendimet e tyre të varura nga mbështetja e vendeve anëtare. Në shumë raste, interesat kombëtare të fuqive të mëdha kanë penguar

veprimet e koordinuara për parandalimin e konflikteve.

Mungesa e një mekanizmi të detyrueshëm për zbatimin e vendimeve. Vendimet e organizatave ndërkombëtare shpesh mbeten deklarative dhe nuk shoqërohen me mjete efektive për të siguruar zbatimin e tyre. Për shembull, rezolutat e OKB-së lidhur me aneksimin e Krimesë nga Rusia në vitin 2014 ose agresionin ndaj Ukrainës në 2022 nuk u shoqëruan me masa të forta ndëshkimore për shkak të vetos së Rusisë në Këshillin e Sigurimit.

Ndërhyrjet selektive dhe mungesa e një standardi të barabartë. Në shumë raste, ndërhyrja ndërkombëtare ka qenë e fragmentuar dhe e orientuar politikisht. Për shembull, ndërsa NATO ndërhyri në Kosovë në vitin 1999 pa një mandat të OKB-së, komuniteti ndërkombëtar nuk arriti të parandalonte gjenocidin në Ruandë më 1994, duke treguar mungesën e një qasjeje të barabartë në menaxhimin e krizave.

Roli i Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Këshilli i Sigurimit i OKB-së (KS-OKB) është organi më i rëndësishëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, me autoritetin për të vendosur sanksione, për të autorizuar ndërhyrje ushtarake dhe për të krijuar misione paqeruajtëse. Megjithatë, ai përballlet me disa sfida kritike që kufizojnë efektivitetin e tij:

Paraliza nga e drejta e vetos. Pesë anëtarët e përhershëm të KS-OKB-së (SHBA, Kina, Rusia, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar) kanë të drejtën e vetos, e cila shpesh përdoret për të bllokuar rezolutat që nuk përputhen me interesat e tyre kombëtare. Për shembull, Rusia ka përdorur veton për të parandaluar veprimet kundër saj në lidhje me luftën në

Ukrainë, duke e bërë OKB-në të pafuqishme për të vepruar në mënyrë efektive.

Mandatet e kufizuara të misioneve paqeruajtëse. Misionet paqeruajtëse të OKB-së shpesh janë të kufizuara në aspektin e burimeve dhe autoritetit. Në shumë raste, ato funksionojnë si forca monitorimi më shumë sesa si mekanizma detyrues për të ndaluar konfliktet. Një shembull është misioni i OKB-së në Bosnjë gjatë luftës së viteve 1992-1995, i cili nuk arriti të parandalonte masakrat si ajo e Srebrenicës (Doyle & Sambanis, 2006).

Mungesa e një qasjeje proaktive për parandalimin e konflikteve. KS-OKB shpesh reagon pasi një krizë ka shpërthyer, në vend që të veprojë në mënyrë parandaluese. Kjo është veçanërisht e dukshme në rastet e konfliktit sirian dhe krizës në Mianmar, ku mungesa e një përgjigjeje të shpejtë ka rezultuar në viktima masive dhe zhvendosje popullsie (Bellamy, 2021).

Efektiviteti i traktateve ndërkombëtare. Traktatet ndërkombëtare përbëjnë bazën ligjore për parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve, por efektiviteti i tyre është shpesh i kufizuar për shkak të disa faktorëve kyç:

Mungesa e zbatimit të detyrueshëm. Shumë traktate ndërkombëtare mbeten pa fuqi detyruese, pasi shtetet mund t'i injorojnë pa pasoja serioze. Për shembull, Rusia ka shkelur Memorandumin e Budapestit (1994), i cili garantonte sigurinë territoriale të Ukrainës në këmbim të dorëzimit të armëve bërthamore, por nuk ka pasur masa detyruese kundër saj.

Natyra e vullnetshme e përfshirjes së shteteve. Ndryshe nga ligji i brendshëm, ku shtetet

kanë institucione ekzekutive për të zbatuar ligjin, në sistemin ndërkombëtar zbatimi i traktateve varet nga vetë shtetet. Për shembull, disa vende nuk kanë ratifikuar Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare (ICC), duke kufizuar aftësinë e saj për të ndjekur penalisht krimet e luftës (Schabas, 2016).

Ndryshimet në balancën e fuqisë. Traktatet ndërkombëtare shpesh bëhen të pavlefshme kur ndryshon ekuilibri i fuqisë. Për shembull, Marrëveshja e Minskut për konfliktin në Ukrainë u shkel në mënyrë të vazhdueshme, pasi Rusia dhe separatistët e mbështetur prej saj nuk e konsideruan më të favorshme zbatimin e saj (Menon & Rumer, 2015).

Ligji ndërkombëtar mbetet një instrument i rëndësishëm për menaxhimin e krizave, por efektiviteti i tij është i kufizuar nga interesat politike, mungesa e mekanizmave të zbatimit dhe bllokimi i institucioneve si KS-OKB. Përmirësimi i këtyre mekanizmave kërkon reforma strukturore në sistemin e OKB-së, forcimin e traktateve ndërkombëtare dhe ndërtimin e mekanizmave më të fuqishëm për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare në mënyrë të barabartë dhe të detyrueshme.

Ligji ndërkombëtar dhe kufizimet e tij në menaxhimin e krizave. Ligji ndërkombëtar përbën një nga shtyllat kryesore të arkitekturës globale të sigurisë, duke synuar të rregullojë marrëdhëniet midis shteteve dhe të menaxhojë konfliktet përmes normave dhe mekanizmave institucionale. Megjithatë, përvoja historike ka treguar se efektiviteti i tij është shpesh i kufizuar për shkak të ndërthurjes së faktorëve politikë, ekonomikë dhe strategjikë. Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) ka një rol qendror në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, por shpesh është i paralizuar nga

interesat e fuqive të mëdha. Po ashtu, traktatet dhe konventat ndërkombëtare, edhe pse ofrojnë një kornizë ligjore për parandalimin e konflikteve, vuajnë nga mungesa e mekanizmave efektivë të zbatimit. Kjo analizë tregon se, për të rritur efektivitetin e ligjit ndërkombëtar në menaxhimin e krizave, është e nevojshme të forcohen mekanizmat e zbatimit dhe të trajtohen sfidat politike dhe strategjike që pengojnë ndërhyrjet e suksesshme.

Dobësitë e mekanizmave ndërkombëtarë në menaxhimin e krizave. Ndërhyrja ndërkombëtare në konfliktet e brendshme dhe ndërkombëtare shpesh vuan nga një sërë kufizimesh strukturore dhe politike. Megjithëse ekzistojnë institucione si OKB-ja, NATO-ja, Bashkimi Evropian (BE) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) që synojnë menaxhimin e krizave, efektiviteti i tyre varet nga faktorë si:

Organizatat ndërkombëtare nuk kanë një forcë të centralizuar të zbatimit, duke i bërë vendimet e tyre të varura nga mbështetja e vendeve anëtare. Në shumë raste, interesat kombëtare të fuqive të mëdha kanë penguar veprimet e koordinuara për parandalimin e konflikteve. Vendimet e organizatave ndërkombëtare shpesh mbeten deklarative dhe nuk shoqërohen me mjete efektive për të siguruar zbatimin e tyre. Për shembull, rezolutat e OKB-së lidhur me aneksimin e Krimesë nga Rusia në vitin 2014 ose agresionin ndaj Ukrainës në 2022 nuk u shoqëruan me masa të forta ndëshkimore për shkak të vetos së Rusisë në Këshillin e Sigurimit.

Në shumë raste, ndërhyrja ndërkombëtare ka qenë e fragmentuar dhe e orientuar politikisht. Për shembull, ndërsa NATO ndërhyri në Kosovë në vitin 1999 pa një mandat të OKB-së, komuniteti ndërkombëtar nuk arriti të parandalonte gjenocidin në Ruandë më

1994, duke treguar mungesën e një qasjeje të barabartë në menaxhimin e krizave.

Shtetet e vogla përballen me sfida unike në ruajtjen e sigurisë kombëtare për shkak të kapaciteteve të kufizuara ushtarake, ekonomike dhe diplomatike. Në një sistem ndërkombëtar të dominuar nga shtetet e mëdha, siguria e tyre shpesh varet nga politika të brendshme efektive dhe nga mbështetja e organizatave ndërkombëtare. Në këtë kontekst, ligji ndërkombëtar luan një rol thelbësor si një mekanizëm për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të tyre, megjithëse efektiviteti i tij mbetet i kufizuar nga dinamika e fuqisë ndërkombëtare.

Politikat e sigurisë janë thelbësore për shtetet e vogla pasi ato ndihmojnë në adresimin e kërcënimeve ekzistenciale dhe në ruajtjen e stabilitetit kombëtar. Ndryshe nga fuqitë e mëdha, të cilat mund të mbështeten në aftësitë e tyre të brendshme për të përballuar sfida të sigurisë, shtetet e vogla duhet të zhvillojnë strategji të përshtatshme për të balancuar kufizimet e tyre strukturore.

Shtetet e vogla shpesh mbështeten në aleancat ndërkombëtare për të garantuar sigurinë e tyre. Për shembull, vendet e Ballkanit Perëndimor, si Shqipëria dhe Mali i Zi, janë anëtarësuar në NATO për të siguruar një mbrojtje kolektive kundër kërcënimeve të mundshme. Aleancat si NATO ose Bashkimi Evropian (BE) u ofrojnë shteteve të vogla mbështetje diplomatike, ushtarake dhe ekonomike, duke reduktuar rrezikun e agresionit nga aktorë të jashtëm.

Disa shtete të vogla zgjedhin një politikë neutraliteti për të shmangur përfshirjen në konfliktet ndërkombëtare, siç është rasti i Zvicrës. Megjithatë, për vendet që janë të ekspozuara ndaj rivaliteteve rajonale, një qasje më aktive diplomatike është e domosdoshme (Dreyer, & Jesse, 2014). Për shembull, Kosova ka ndjekur një strategji të fuqizimit të njohjes ndërkombëtare dhe anëtarësimit në organizata globale për të rritur sigurinë e saj, duke shmangur konfliktet e drejtpërdrejta me shtete armiqësore.

Pavarësisht varësisë nga partnerët ndërkombëtarë, shtetet e vogla duhet të investojnë në modernizimin e forcave të armatosura dhe forcave të rendit për të përballuar kërcënimet hibride, si terrorizmi dhe krimi i organizuar. Për shembull, Shqipëria ka reformuar strukturat e saj të sigurisë dhe mbrojtjes pas anëtarësimit në NATO, duke përmirësuar kapacitetet e saj në kuadër të operacioneve të përbashkëta të sigurisë (Doyle & Sambanis, 2006).

Ndikimi i ligjit ndërkombëtar për sigurinë e shteteve të vogla

Megjithëse shtetet e vogla nuk kanë aftësi të konsiderueshme ushtarake, ligji ndërkombëtar u ofron atyre një mekanizëm për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të tyre përmes normave dhe institucioneve ndërkombëtare.

- *Mbrojtja e sovranitetit përmes kartës së OKB-së*

Parimet e Kartës së OKB-së ndalojnë agresionin dhe promovojnë respektimin e sovranitetit të shteteve. Kjo ndihmon vendet e vogla të kenë një mbrojtje ligjore kundër ndërhyrjeve të jashtme. Për shembull, në rastin e Kosovës, vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) në vitin 2010 legjitimoi pavarësinë e saj në bazë të parimit të vetëvendosjes, duke forcuar pozicionin e saj ndërkombëtar.

- *Mekanizmat ndërkombëtarë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*

Shtetet e vogla mund të përdorin mekanizmat ndërkombëtarë për të adresuar çështjet e sigurisë përmes gjykatave ndërkombëtare, arbitrazhit dhe diplomacisë shumëpalëshe.

Për shembull, detyrimi i Serbisë për të ndjekur një dialog të ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën është një shembull i përdorimit të instrumenteve ligjore për menaxhimin e konflikteve.

- *Mbrojtja përmes aleancave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare*

Shtetet e vogla shpesh forcojnë sigurinë e tyre përmes pjesëmarrjes në marrëveshje rajonale dhe ndërkombëtare, të cilat sigurojnë ndihmë në rast të kërcënimeve të jashtme.

Për shembull, vendet e Baltikut mbështeten në Nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, i cili garanton një përgjigje kolektive në rast të një sulmi të huaj (Bellamy, 2021).

Kufizimet e ligjit ndërkombëtar për sigurinë kombëtare

Pavarësisht përfitimeve, ligji ndërkombëtar shpesh përballet me sfida që kufizojnë efektivitetin e tij në mbrojtjen e shteteve të vogla.

- *Zbatim selektiv dhe politizimi i institucioneve ndërkombëtare*

Ligji ndërkombëtar shpesh zbatohet në mënyrë selektive, duke reflektuar interesat e fuqive të mëdha. Për shembull, ndonëse aneksimi i Krimesë nga Rusia në 2014 u shpall i paligjshëm nga OKB-ja, mungesa e një mekanizmi të detyrueshëm për ta ndaluar këtë veprim e bëri të pamundur një përgjigje efektive.

- *Vështirësia e zbatimit të vendimeve të OKB-së dhe ICC-së (Gjykates Ndërkombëtare)*

Shumë vendime të gjykatave ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së mjeteve të detyrueshme. Për

shembull, vendimi i ICC-së për të ndjekur penalisht liderët përgjegjës për krimet në Sudan nuk u zbatua pasi vendet e fuqishme nuk ofruan mbështetje për arrestimin e tyre.

- *Ndikimi i Fuqive të Mëdha në politikat rajonale*

Shtetet e vogla shpesh janë të ekspozuara ndaj ndikimit të fuqive të mëdha, të cilat mund të manipulojnë ose të diktojnë politikën e tyre të sigurisë. Për shembull, ndikimi i Rusisë në Bjellorusi dhe ndikimi i Kinës në disa vende afrikane tregojnë sesi shtetet e vogla mund të bëhen vasalë të aktorëve më të mëdhenj. Shtetet e vogla mbështeten në politikën e sigurisë kombëtare dhe ligjin ndërkombëtar për të mbrojtur sovranitetin e tyre, por efektiviteti i këtyre mekanizmave varet nga dinamika globale e fuqisë. Ndërsa aleancat dhe normat ndërkombëtare ofrojnë një bazë për stabilitetin e tyre, sfidat e zbatimit të ligjit ndërkombëtar dhe ndikimi i fuqive të mëdha mbeten pengesa të rëndësishme për sigurinë e tyre.

7.2. REKOMANDIME

Ligji ndërkombëtar është një mjet kyç për menaxhimin e konflikteve dhe garantimin e sigurisë globale, por efektiviteti i tij mbetet i kufizuar nga mungesa e mekanizmave të detyrueshëm të zbatimit dhe nga ndërhyrjet selektive të fuqive të mëdha. Shtetet e vogla, si Shqipëria dhe Kosova, varen nga një rend ndërkombëtar i bazuar në rregulla për të siguruar sovranitetin dhe stabilitetin e tyre. Megjithatë, për të përmirësuar rolin e ligjit ndërkombëtar në sigurinë kombëtare, nevojiten reforma në disa nivele: *në politikën e brendshme të shteteve të vogla, në funksionimin e organizatave ndërkombëtare dhe në hartimin e politikave të sigurisë kombëtare dhe globale*. Ky seksion paraqet rekomandime specifike për përmirësimin e efikasitetit të ligjit ndërkombëtar.

Rekomandime për vendet e vogla (Shqipëria)

1. Fuqizimi i kapaciteteve të brendshme për përdorimin e ligjit ndërkombëtar. Shqipëria dhe vendet e vogla duhet të investojnë në ekspertizën juridike dhe diplomatike për të forcuar rolin e tyre në arenën ndërkombëtare. Krijimi i instituteve kombëtare për studimin dhe zbatimin e ligjit ndërkombëtar mund të ndihmojë në rritjen e ndikimit të tyre në proceset globale. Përfshirja e ligjit ndërkombëtar në programet akademike dhe trajnimet e shërbimeve diplomatike do të rrisë kapacitetin e negociatorëve shqiptarë në forume ndërkombëtare.

2. Rritja e angazhimit në organizatat ndërkombëtare. Shqipëria duhet të rrisë përfshirjen e saj në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë, si Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC), Këshilli i të Drejtave të Njeriut të (KDNJ) i OKB-së dhe OSBE. Lobimi për reforma brenda NATO-s dhe Bashkimit Evropian është i rëndësishëm për të siguruar që vendet e vogla të kenë një zë më të fuqishëm në çështjet e sigurisë rajonale dhe globale. Rritja e pjesëmarrjes në misionet paqeruajtëse të OKB-së mund të ndihmojë Shqipërinë të forcojë pozicionin e saj si një kontribuese aktive në sigurinë ndërkombëtare.

3. Përmirësimi i mekanizmave për përballimin e kërcënimeve të reja. Ligji ndërkombëtar duhet të përfshihet më shumë në strategjitë kombëtare të sigurisë për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e krizave. Shtetet e vogla duhet të krijojnë mekanizma të brendshëm për zbatim dhe mbikëqyrje të angazhimeve ndërkombëtare, duke forcuar sistemin gjyqësor dhe institucionet e kontrollit të ligjshmërisë. Integrimi i Shqipërisë në inisiativa rajonale për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen nga kërcënimet

hibride do të ndihmojë në përmirësimin e kapaciteteve të saj në përballimin e sfidave moderne.

Rekomandime për zhvillimin e politikave të sigurisë

1. Integrimi i ligjit ndërkombëtar në politikat e sigurisë kombëtare. Shtetet e vogla duhet të adoptojnë strategji kombëtare të sigurisë që bazohen në normat e ligjit ndërkombëtar dhe në angazhimet e tyre ndaj organizatave ndërkombëtare. Politikat e sigurisë duhet të përfshijnë masa për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe sigurinë humane, duke siguruar që zbatimi i ligjit ndërkombëtar të jetë në përputhje me normat demokratike.

2. Zhvillimi i mekanizmave për sigurinë kibernetike dhe luftën kundër kërcënimeve jo-tradicionale. Shtetet duhet të krijojnë njësi të specializuara për sigurinë kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën kritike nga sulmet dixhitale. Ligji ndërkombëtar duhet të zgjerojë rregullat për luftën kibernetike, duke përcaktuar qartë përgjegjësinë e shteteve në rastet e sulmeve dixhitale. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit është thelbësore për sigurinë kombëtare.

3. Forcimi i kapaciteteve rajonale për menaxhimin e krizave. Bashkëpunimi rajonal është kritik për sigurinë e vendeve të vogla. Për këtë arsye, mekanizmat si Procesi i Berlinit dhe nismat e sigurisë në Ballkanin Perëndimor duhet të forcohen. Shqipëria dhe vendet e tjera të rajonit duhet të ndjekin modele të suksesshme të ndërveprimit rajonal për përballimin e krizave, si mekanizmat e BE-së për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave.

Reformat në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar janë të domosdoshme për të rritur efektivitetin e ligjit ndërkombëtar në garantimin e sigurisë kombëtare. Shqipëria dhe vendet e vogla duhet të fuqizojnë kapacitetet e tyre për të përdorur mekanizmat ndërkombëtarë, ndërsa organizatat globale duhet të reformojnë strukturat e tyre për të bërë ligjin ndërkombëtar më të zbatueshëm dhe efektiv. Përmirësimi i politikave të sigurisë, forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimi i mekanizmave të rinj për të adresuar kërcënimet e reja janë hapa thelbësorë për të ardhmen e rendit ndërkombëtar.

Në këtë studim u analizua ndikimi i ligjit ndërkombëtar në sigurinë kombëtare të shteteve të vogla, duke u fokusuar në rastet e Shqipërisë (1997), Kosovës (1999) dhe Ukrainës (2024). Përmes një analize krahasuese të këtyre rasteve dhe mekanizmave ndërkombëtarë të sigurisë, u shqyrtuan dobësitë, avantazhet dhe kufizimet e ligjit ndërkombëtar në parandalimin dhe menaxhimin e krizave.

Përmbledhje e Argumenteve Kryesore

1. Roli i ligjit ndërkombëtar në menaxhimin e krizave.

Një nga gjetjet kryesore të këtij studimi është se ligji ndërkombëtar ka një rol të rëndësishëm në legjitimimin e ndërhyrjeve ndërkombëtare për stabilizimin e krizave, por efektiviteti i tij mbetet i kufizuar nga faktorët politikë dhe strategjikë. Në rastin e Shqipërisë (1997), ndërhyrja ndërkombëtare u realizua me miratimin e OKB-së përmes Rezolutës 1101, duke dëshmuar se mekanizmat ligjorë mund të funksionojnë kur mbështeten nga aktorë ndërkombëtarë të interesuar për stabilitetin rajonal. Në rastin e Kosovës (1999), ndërhyrja e NATO-s pa mandat të OKB-së krijoi një precedent për ndërhyrjet humanitare, por nxiti gjithashtu debate mbi legjitimitetin e veprimeve jashtë

sistemit tradicional të së drejtës ndërkombëtare. Në rastin e Ukrainës (2024), shkelja e parimeve bazë të sovranitetit dhe ndalimit të agresionit nga Rusia ka treguar kufizimet e OKB-së dhe të ligjit ndërkombëtar në ndalimin e akteve të agresionit nga fuqitë e mëdha.

2. Kufizimet e ligjit ndërkombëtar në sigurinë kombëtare

Ligji ndërkombëtar mbetet një sistem i bazuar në konsensus, ku zbatimi i normave varet nga vullneti politik i shteteve. E drejta e vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ka qenë një pengesë kryesore për një qasje të barabartë ndaj menaxhimit të krizave globale, duke bllokuar vendime kyçe për konflikte si ai në Ukrainë. Zbatimi selektiv i ligjit ndërkombëtar ka ndikuar në perceptimin e padrejtësisë dhe mungesës së barazisë në arenën globale, duke krijuar raste ku fuqitë e mëdha mund të anashkalojnë normat ndërkombëtare pa pasoja të qarta .

3. Strategjitë e shteteve të vogla për të maksimizuar sigurinë e tyre

Në mungesë të garancive të forta ligjore, shtetet e vogla kanë ndjekur qasje të ndryshme për të siguruar stabilitetin dhe mbrojtjen e tyre: *Anëtarësimi në aleanca ndërkombëtare* – Shqipëria dhe vendet e tjera të rajonit kanë zgjedhur anëtarësimin në NATO dhe BE si mekanizma sigurie kundër kërcënimeve të jashtme. *Përdorimi i mekanizmave diplomatikë dhe gjyqësorë* – Kosova ka ndjekur një strategji të mbështetjes në vendime të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) dhe në përpjekjet për njohje ndërkombëtare. *Modernizimi i kapaciteteve të sigurisë* – Vendet e vogla po investojnë gjithnjë e më shumë në sigurinë kibernetike dhe inteligjencën strategjike, duke u përshtatur me natyrën e re të kërcënimeve globale.

4. Rritja e pavarësisë strategjike të shteteve të vogla. Diversifikimi i aleancave ndërkombëtare

Shtetet e vogla duhet të mos mbështeten vetëm në një bllok ushtarak apo ekonomik, por të ndërtojnë marrëdhënie të shumanshme për të siguruar mbështetje në raste krizash. *Investimi në mbrojtjen kombëtare dhe sigurinë kibernetike* – Në një epokë të luftës hibride, siguria nuk lidhet vetëm me aftësitë ushtarake tradicionale, por edhe me mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga sulmet kibernetike dhe ndërhyrjet e jashtme.

5. Ligji ndërkombëtar dhe lufta kundër kërcënimeve të reja. Krijimi i normave të reja për sigurinë kibernetike

Sulmet kibernetike po bëhen një armë e re e agresionit shtetëror, ndaj nevojiten rregullime të qarta ndërkombëtare për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore në këtë fushë. Përvoja e Kosovës (1999) dhe Ukrainës (2024) tregon se ndërhyrjet ndërkombëtare duhet të kenë një bazë ligjore më të qartë për të mbrojtur popullatat nga gjenocidet dhe agresioni i huaj.

Ligji ndërkombëtar mbetet themeli i stabilitetit global, por efektiviteti i tij varet nga vullneti i shteteve dhe reforma të domosdoshme në institucione si OKB-ja. Rastet e Shqipërisë, Kosovës dhe Ukrainës tregojnë se ndërhyrjet ndërkombëtare shpesh dominohen nga interesat e fuqive të mëdha, duke sfiduar shtetet e vogla të ndërtojnë strategji të fuqishme kombëtare dhe aleanca. E ardhmja kërkon reforma rrënjësore dhe një angazhim të fortë për ta bërë ligjin ndërkombëtar një forcë reale që garanton sigurinë dhe drejtësinë në botë.

Referencat

- Adamu, A. N. V. (2023). The applicability of humanitarian intervention and the responsibility to protect during armed conflicts: Russia-Ukraine war in focus. *American Journal of Law and Political Science*, 2(1), 1–18.
- Agamben, G. (2005). *Imperialism, sovereignty and the making of international law*. Cambridge University Press.
- Ağır, B. S., & Gürsoy, B. (2019). The European Union's state-building efforts in the case of Bosnia and Herzegovina. *Uluslararası İlişkiler Dergisi*, 16(63), 57–72. <https://dergipark.org.tr/en/download/article-file/847269>
- Aghie, A. (2005). *Imperialism, sovereignty and the making of international law*. Cambridge University Press.
- Akhavan, P. (1998). Justice in The Hague: The International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia. *Human Rights Quarterly*, 20(4), 737–816.
- Akhavan, P. (2001). Beyond impunity: Can international criminal justice prevent future atrocities? *American Journal of International Law*.
- Aladekomo, A. (2022, March 22). Russian aggression against Ukraine, sovereignty and international law. SSRN. <https://ssrn.com/abstract=4064020> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.4064020>
- Ali, A. M., Hassan, S. A., & Mousa, K. M. (2024). Challenges and prospects of international law in the 21st century. *Preprints*. <https://doi.org/10.20944/preprints202405.1893.v1>
- Alison, R. (2014). Russian 'deniable' intervention in Ukraine: How and why Russia broke the rules. *International Affairs*, 90(6), 1255–1297. <https://doi.org/10.1111/1468-2346.12170>
- Almakky, R. (2023). The role of international organisations in the development of international law: An analytical assessment of the United Nations. *Law and World*, 9(28), 40–66. <https://doi.org/10.36475/9.4.4>
- Almqvist, J. (2009, March 16). The politics of recognition, Kosovo and international law. *Elcano Royal Institute*. <https://www.realinstitutoelcano.org/en/work-document/the-politics-of-recognition-kosovo-and-international-law-wp/>
- Amnesty International. (2023). *Reports on human rights violations and violations of the Geneva Conventions in Ukraine*. Amnesty International. <https://www.amnesty.org>
- Armakolas, I., & Ker-Lindsay, J. (Eds.). (2019). *The politics of recognition and engagement: EU member state relations with Kosovo*. Springer.
- Asada, M. (2024). The war in Ukraine under international law: Its use of force and armed conflict aspects. *International Community Law Review*, 26(1–2), 5–38. <https://doi.org/10.1163/18719732-12341493>
- Ayoob, M. (2002). Humanitarian intervention and state sovereignty. *The International Journal of Human Rights*, 6(1), 81–102. <https://doi.org/10.1080/714003756>
- Ba Bassil, Y. (2012). The 2003 Iraq War: Operations, causes, and consequences. *IOSR Journal of Humanities and Social Science*, 4(1), 29–47. <https://doi.org/10.9790/0837->

0452947

Bahador, B. (2007). The Kosovo crisis. In *The CNN effect in action: How the news media pushed the West toward war in Kosovo* (pp. 67–74). Palgrave Macmillan US.

Baker, C. (2022). *Economic sanctions and international law: The case of Russia*. Cambridge University Press.

Balcanicaucaso. (n.d.). *Albania: Operation Alba and the memories of Romano Prodi*. Retrieved January 10, 2025, from <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-Operation-Alba-and-the-memories-of-Romano-Prodi-184702>

Ballesteros, M. P. (2024, September 6). The Summit of the Future 2024: Towards Security Council reform? *Gate Center*. <https://gatecenter.org/en/the-summit-of-the-future-2024-towards-security-council-reform/>

Barjolle, D. (1998). *Albania: The pyramid crisis and its impact on rural structures*. Swiss Federal Institute of Technology.

Barker, M. (2023). The European Union's response to the Ukraine crisis: Leadership under Ursula von der Leyen. *European Policy Studies*, 22(3), 89–102.

Barnett, M. (2003). *Eyewitness to a genocide: The United Nations and Rwanda*. Cornell University Press.

Barnett, M., & Weiss, T. G. (2008). *Humanitarianism in question: Politics, power, ethics*. Cornell University Press.

Barron, K. (2022). The annexation of Crimea and EU sanctions: An ineffective response. *The Arbutus Review*, 13(1). <https://doi.org/10.18357/tar131202220760>

Bebler, A. (2015). Crimea and the Russian-Ukrainian conflict. *Romanian Journal of European Affairs*, 15, 35.

Behera, N. C. (2020). State and sovereignty. In *International relations from the global South* (pp. 139–160). Routledge.

Beitz, C. R. (2012). *The idea of human rights* (online ed.). Oxford University Press. <https://doi.org/10.1093/acprof:oso/9780199572458.001.0001>

Bellamy, A. J. (2000). Human wrongs in Kosovo: 1974–99. *The International Journal of Human Rights*, 4(3–4), 105–126.

Bellamy, A. J. (2009). *Responsibility to protect: The global effort to end mass atrocities*. Polity Press.

Bellamy, A. J. (2015). The changing face of humanitarian intervention. *St Antony's International Review*, 11(1), 15–43. <http://www.jstor.org/stable/26229132>

Bellamy, A. J. (2015). *The responsibility to protect: A defense*. Oxford University Press.

Bellamy, A. J. (2021). *World peace and how we can achieve it*. Oxford University Press.

Bellamy, A. J., & Šimonović, I. (2021). Introduction: Towards evidence-based atrocity prevention. *Journal of International Peacekeeping*, 24(3–4), 285–304.

Bellamy, A. J., & Williams, P. D. (2005). Who's keeping the peace?: Regionalization and contemporary peace operations. *International Security*, 29(4), 157–195.

Bellamy, A. J., Williams, P. D., & Griffin, S. (2010). *Understanding peacekeeping*. Polity Press.

Bellamy, C. (2020). What are maritime crime and maritime security. *International Journal of Maritime Crime & Security*, 1(01), 13–25.

Bellinger, J. B. (2022). The war in Ukraine and the role of international law. *Foreign Affairs*, 101(2), 32–45.

Bezemer, D. J. (2006). *On eagle's wings: The Albanian economy in transition*. Nova Science Publishers Inc.

Bideleux, R., & Jeffries, I. (2007). *The Balkans: A post-Communist history*. Routledge.

Biersack, J., & O'Lear, S. (2014). The geopolitics of Russia's annexation of Crimea: Narratives, identity, silences, and energy. *Eurasian Geography and Economics*, 55(3), 247–269.

Binder, M. (2017). The Security Council and the war in Bosnia. In *The United Nations Security Council and the politics of international authority* (pp. 99–149). Springer. https://doi.org/10.1007/978-3-319-42354-8_4

Bond, I., & Scazzieri, L. (2022). *The EU, NATO and European security in a time of war*. Centre for European Reform.

Boon, H. T. (2023). Making sense of China's crisis resolution role in Ukraine. *Australian Journal of International Affairs*, 77(4), 423–429.

Boon, K. E. (2022). Russia's invasion of Ukraine and the future of international law. *International Affairs*, 98(3), 853–865. <https://doi.org/10.1093/ia/iac093>

Brand, A., & Centre d'études pratiques de la négociation internationale. (2003). *Le Kosovo, un État en devenir: La construction internationale d'un État*. Éditions Bruylant.

Brand, M., & Centre d'études pratiques de la négociation internationale (Genève). (2003). *The rehabilitation of war-torn societies: The development of Kosovo institutions and the transition of authority from UNMIK to local self-government*. CASIN.

Brownlie, I. (2008). *Principles of public international law* (7th ed.). Oxford University Press.

Burger, J. A. (2000). International humanitarian law and the Kosovo crisis: Lessons learned or to be learned. *International Review of the Red Cross*, 82(837), 129–145. <https://doi.org/10.1017/S156077550007543X>

Caplan, R. (2005). *Europe and the recognition of new states in Yugoslavia*. Cambridge University Press.

- Caplan, R. (2005). *International governance of war-torn territories: Rule and reconstruction*. Oxford University Press.
- Carnegie Endowment for International Peace. (2023, June). *UN Security Council reform: What the world thinks*. <https://carnegieendowment.org/research/2023/06/un-security-council-reform-what-the-world-thinks?lang=en>
- Cassese, A. (2005). *International law* (2nd ed.). Oxford University Press.
- Cela, A., Rakipi, A., Balla, A., Zeneli, B., Feta, B., Koçi, D., Jorgji, J., Giakoumis, K., Krisafi, L., & Xhepa, S. (2008, January). *Albania and Greece: Understanding and explaining*. Albanian Institute for International Studies. <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14698.pdf>
- Chandler, D. (2020). Security through societal resilience: Contemporary challenges in the Anthropocene. *Contemporary Security Policy*, 41(2), 195–214. <https://doi.org/10.1080/13523260.2019.1659574>
- Chesterman, S. (2002). *Just war or just peace? Humanitarian intervention and international law*. Oxford University Press.
- Chesterman, S. (2019). *International law and the use of force* (2nd ed.). Oxford University Press.
- Chesterman, S. (2021). The UN Security Council and the rule of law: The double standards of international order. *International Affairs*, 97(3), 689–706.
- Chiclet, C. (1998, July 3). On the brink of war in Kosovo: Albania exposed. *Le Monde Diplomatique*. <https://mondediplo.com/1998/07/03alban>
- Chollet, D. (2005). *The road to the Dayton Accords: A study of American statecraft*. Palgrave Macmillan.
- Chomsky, N. (2002). *The new military humanism: Lessons from Kosovo*. Pluto Press.
- Clark, D. (2023). Boris Johnson's legacy in international crisis management: The case of Ukraine. *British Foreign Affairs Analysis*, 10(3), 78–92.
- Clark, P. (2023). The effectiveness of sanctions: Lessons from the Ukraine crisis. *Journal of Economic Sanctions*.
- Cook, C. R. (2010). The power of international institutions: An examination of US policy towards East Timor and Kosovo in 1999. *Journal of Politics and Law*, 3, 26.
- Cooper, N., Turner, M., & Pugh, M. (2011). The end of history and the last liberal peacebuilder: A reply to Roland Paris. *Review of International Studies*, 37(4), 1995–2007.
- Corpuz, J. C. (2023). War in Ukraine: Humanitarian interventions. *Disaster Medicine and Public Health Preparedness*, 17, e458.
- Council on Foreign Relations. (n.d.). *The UN Security Council*. Council on Foreign Relations. <https://www.cfr.org/backgrounder/un-security-council>
- Cox, M. (2004). International responses to the Albanian crisis of 1997. *Journal of International Affairs*, 55(2), 233–247.
- Croci, O. (2000). Forced ally? Italy and 'Operation Allied Force'. *Italian Politics*, 15(1), 33–50.

- Cronin, B., & Hurd, I. (Eds.). (2008). *The UN Security Council and the politics of international authority*. Routledge. <https://doi.org/10.4324/9780415775281>
- Cross, S. (2002). Russia and NATO toward the twenty-first century: Conflicts and peacekeeping in Bosnia-Herzegovina and Kosovo. *The Journal of Slavic Military Studies*, 15(2), 1–58.
- D’Anieri, P. (2019). New world order? 1989–1993. In *Ukraine and Russia: From civilized divorce to uncivil war* (pp. 27–64). Cambridge University Press. <https://doi.org/10.1017/9781108657044.003>
- Dağı, İ. (2001). Human rights, foreign policy and the question of intervention. *Perceptions: Journal of International Affairs*, 6(2).
- De Wet, E. (2009). The governance of Kosovo: Security Council Resolution 1244 and the establishment and functioning of EULEX. *American Journal of International Law*, 103(1), 83–96.
- Debié, F. (2000). Greece, Italy and Europe in the face of the Albanian problem. *Geopolitics*, 5(2), 186–202.
- Del Boca, A. (1997). *L’Albania tra crisi e speranza: La missione italiana in Albania*. Mondadori.
- Del Boca, A. (2001). *The Albanian Operation Alba and Italy's contribution to peace in the Balkans*. CEDAM.
- Demir, S. (2022). The 2022 Russia–Ukraine war: Reasons and impacts. *Bölgesel Araştırmalar Dergisi*, 6(1), 13–40.
- Dijkstra, H., Dunn Cavelty, M., Jenne, N., & Reykers, Y. (2022). War in Ukraine. *Contemporary Security Policy*, 43(3), 464–465. <https://doi.org/10.1080/13523260.2022.2099085>
- Dinstein, Y. (2019). *The international law of belligerent occupation*. Cambridge University Press.
